RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Tiranë, gusht 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit 4
2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. 4
3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: 4
4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhenave 4
5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve 5
6. Paraqitja e gjetjeve kryesore 5-6
7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore 7-8
8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit 8-9

II. HYRJA 9

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit 9
2. Identifikimi i çështjes 10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 10
4. Përgjegjësia e audituesve 11
5. Kriteret e vlerësimit: 11-12
6. Standardet e auditimit 12-13
7. Metodat e auditimit 13
8. Dokumentimi i auditimit 14

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT 14

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 14-15
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit 15

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik……. 15-25

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. 25-33

2.2.6 Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara… 33-48

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025. 47-62

2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditim e mëparshëm. 62-128

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 128-145

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Bashkia Konispol kufizohet në veri dhe lindje me shtetin e Grek, në jug me bashkinë Finiq dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Konispoli. Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një popullsi prej 4,898 banorësh.. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 221.88 km^2 me një densitet prej 22.48 banorë/km^2 (disafish më e ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore). Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 15 fshatra. Bashkia Konispol ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Konispol, ose për transportin ndërkufitar, ndërsa një pjesë e popullsisë është punësuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi. Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat, ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audites të tjerë ligjore".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Konispol si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe aktet ligjore dhe nënligjore për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejtë në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.
4. Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.
5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, kryer në Bashkinë Konispol.

4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha

zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 10,148 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 1,015 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren

5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 19 rekomandime, nga ku masa organizative me 16 gjetje dhe 17 rekomandime, dhe 2 gjetje-rekomandime në fushën e të ardhurave.

6. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve familjarë që kanë ndaj Bashkisë Konispol konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 46,916 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët familjarë detyrime të prapambetura në vlerën 7,966 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 11,565 mijë lekë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **50,217 mijë lekë**.
Detyrimet e tatimpaguesve privatë ndaj Bashkisë Konispol, të akumuluara deri më datë 31.12.2024, rezultojnë në vlerën 5,382 mijë lekë. Gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 31.12.2025 është krijuar detyrim tatimor shtesë në vlerën 684 mijë lekë. Si rezultat, detyrimi tatimor progresiv i tatimpaguesve privatë deri më datë 31.12.2025 rezulton në vlerën **6,067 mijë lekë** dhe i përket 73 subjekteve biznesi.
- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Sarandë, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Gjendja debitorë në datën 31.12.2024 është në vlerën 246 mijë lekë. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 362 mijë lekë për 7 persona i cili është arkëtuar brenda vitit 2025. Më datë 31.12.2025 gjendja debitorë totale është 246 mijë lekë për 7 persona, shumë e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për Bashkinë Konispol. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Konispol për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gjirokastër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak *"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*" për miratim.
Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak.
Tavanet Buxhetore për PBA 2024-2026 nuk janë paraqitur dhe miratuar në Këshillin Bashkiak.
Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.
Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë.
PBA 2025-2027 faza e parë nuk është dërguar në MF.
Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 nuk janë miratuar me VKB.
Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

- Nga auditimi i realizimit të shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Konispol së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, u konstatuan devijime me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën ka vlerën 283,700 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 254,194 mijë lekë ose në masën 89.5%.
Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 71,640 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 63,475 mijë lekë ose në masën 89%.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve.
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 60,332 mijë lekë dhe realizuar 46,227 mijë lekë ose në masën 76%. Mosrealizimit i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Konispol në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore.

- Nga auditimi rezultoi se totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 38,865 mijë lekë, nga të cilat për investime janë në vlerën 1,638 mijë lekë, për mallra dhe shërbime janë në vlerën 37,227 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 18,616 mijë lekë dhe në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura janë në vlerën 20,249 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura përbëhet nga 54 fatura nga të cilat para vitit 2023 i përkasin 5 fatura me vlerë detyrimi 1,086 mijë lekë, vitit 2023 i përkasin 8 fatura me vlerë detyrimi 2,058 mijë lekë, vitit 2024 i përkasin 6 fatura me vlerë detyrimi 4,544 mijë lekë dhe vitit 2025 i përkasin 35 fatura me vlerë detyrimi 12,560 mijë lekë. Pavarësisht uljes së stokut të detyrimeve gjatë vitit 2025, njësia nuk ka siguruar planifikimin dhe administrimin e fondeve në mënyrë që të garantojë shlyerjen në afat të detyrimeve të krijuara, duke sjellë mbartjen e tyre nga një vit buxhetor në tjetrin dhe rrezik për menaxhimin efektiv të fondeve publike.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

- Nga auditimi rezulton se për vitin 2025, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Konispol nr. 70, datë 31.12.2025, "*Për ngritjen e komisioneve që do të bëjnë inventarizimin vjetor të vlerave materiale të pasurisë së Bashkisë Konispol*", me përbërje nga tre punonjës. Nga auditimi i procedurave të inventarizimit nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2025, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre.

Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2025, rezulton se:

- Llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene" është paraqitur në bilanc në vlerën 20,011 mijë lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari ka pasur shtesa gjatë vitit 2025 vlerën 2,921 mijë dhe është kontabilizuar në datën 31.12.2025 për vlerën 26,933 mijë lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.
- Llogaria 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2025 nuk disponon një regjistër të përditësuar.
- Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konstatohet se, ndër vite janë transferuar inventarë në vlerën kontabël (kosto historike) 502,851,347 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Konispol (aktualisht pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë) por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Konispol dhe UKK Sh.a**.** Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet.

7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

- ***Planifikimin dhe realizimit i të ardhurave***

- Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 56,284 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 246 mijë lekë.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Kryetari i Bashkisë Konispol, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjithë fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Konispol, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale.
- Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.
- Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

- Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* dhe llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.
- Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë, 210 *"Toka, Troje, Terrene"*, dhe 212 *'Ndërtesa dhe Konstruksione"*.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në zbatim të procedurave të inventarizimit, të marrë masa për analizimin e dokumentacionit financiar dhe ligjor të aktiveve, me qëllim evidentimin e plotë të hyrjeve dhe lëvizjeve të tyre ndër vite, verifikimin dhe saktësimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare. Në rast konstatimi të pasaktësive, të kryhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik të aktiveve.
- Nga Bashkia Konispol të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vlerën kontabël 502,851,347 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për kryerjen e një analize të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor për aktivet e regjistruara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore",* me qëllim verifikimin e saktësisë së vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare. Aktivet të kontabilizohen me vlerën e plotë të kontratës së realizuar dhe të marrë në dorëzim, dhe jo vetëm me vlerën e likuiduar të kontratës.

8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2025:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Konispol për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2025 - 31.12.2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e "Bazës për opinion e kualifikuar", pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Konispol më 31 dhjetor 2025, referuar Udhëzimit e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar,*

Baza për opinionin e kualifikuar[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të).

[1] *Një "Opinion i kualifikuar", jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Në dhënien e opinionit kemi marrë në konsideratë materialitetin në vlerën 5,077 mijë lekë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Konispol. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 231 *"Investime"* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 7,200 mijë lekë.

-Llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin*" është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 10,343 mijë lekë.

-Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 53,981mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 382/1 prot, datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 09.04.2026 deri më datë 29.05.2026 në subjektin Bashkia Konispol për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, u krye *auditimi "Mbi auditimin financiar"* nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K. H., Përgjegjës Grupi
2. I. U., Auditues
3. V. K., Auditues

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar i subjektit, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kritereve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 "Kriteret e vlerësimit". Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre. Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar

parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Konispol, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Konispol.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë Konispol në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Konispol, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve

të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësia e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Konispol është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*; Ligji nr. 114/2015, datë

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm publik";* Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;* Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes Vendore"*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues";* Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *"Për miratimin e manualit të MFK";* Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".*

-Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e qeverisjes vendore";* Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar*; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* etj.; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;* Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar*; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore".*

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 *"Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;*

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar";* Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 *"Për sistemin e taksave lokale"*, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *"Për taksat kombëtare", i ndryshuar;* VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave " i ndryshuar*; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022 dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[3]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

[3] *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të auditimit financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në Bashkinë Konispol u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Konispol kufizohet në veri dhe lindje me shtetin e Greqisë, në jug me Bashkinë Finiq dhe në perëndim me Bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Konispoli.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një popullsi prej 4,898 banorësh.. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 221.88 km^2 me një densitet prej 22.48 banorë/km^2.

Historik i zhvillimit ekonomik: Bashkia Konispol ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Konispol, ose për transportin ndërkufitar, ndërsa një pjesë e popullsisë është punësuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi. Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat, ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integrimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të programit të auditimit nr.382/1 prot, datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Bashkinë Konispol u ushtrua auditimi financiar për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, sipas drejtimeve:

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit ;
2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025;
2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve ;
2.5 Të ndryshme të dala gjatë auditimit ;

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Konispol si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

<u>Komponenti "Mjedisi i kontrollit"</u>

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit" përfshin: integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

<u>Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:</u>

Parimi 1 – Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;
Parimi 2 – Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;
Parimi 3 – Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 – Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;
Parimi 5 – Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Konispol në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit evidentojmë se, institucioni vepron mbi bazën e Rregullores e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 8, datë 19.09.2025. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
Bashkia Konispol ka miratuar kodin etik me Vendimin nr.9, datë 19.09.2025.
Me urdhrin nr.1/2 datë 06.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar plani vjetor i trajnimeve për punonjësit e Bashkisë.
Nuk ka rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Konispol në kundërshtim me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*, i ndryshuar.
Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit). Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Për vitin 2025, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.
Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE. Nuk është hartuar Plani i Veprimit për KB për vitin 2025.
Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Nëpërmjet shkresës nr.322/1 prot., datë 28.02.2026 është dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit *"Pyetësori e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"*
Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të

përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Dokumenti i parë i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 nuk është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak në kundërshtim me Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"*.
Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.52 datë 23.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 64/1 prot., datë 17.01.2025, është miratuar dokumenti përfundimtar i Programi buxhetor afatmesëm 2025-2027, si dhe buxhetit vjetor i vitit 2025. Në MFE është dërguar elektronikisht. Për vitin 2025 janë 3 raporte monitorimi, përkatësisht për 4 mujorin e I-rë, 4 mujorin e dytë (progresivi) dhe vjetori, të cilat janë dërguar elektronikisht në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Struktura e Bashkisë Konispol ka në përbërjen e saj Administratën e Bashkisë, Njësitë Administrative Xarrë dhe Markatë si dhe funksionet e deleguara. Bashkia Konispol ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësinë e vetëqeverisjes vendore.
Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, si dhe janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjesave me publikun.
Institucioni vepron mbi bazën e Rregullores e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 8, datë 19.09.2025 ku është bërë përshkrimi i vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Bashkia Konispol për vitin 2025 ka pasur në strukturë 151 punonjës. Përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 10 punonjës të rinj dhe te larguar. Në Rregulloren e Brendshme janë për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist.
Problematikë paraqet mungesa e planit strategjik me objektiva dhe tregues performancë të përcaktuar duke kufizuar në këtë mënyrë matjen e progresit dhe realizimin e qëllimit final të Bashkisë Konispol. Gjithashtu, në Bashkinë Konispol, vërehet një mungesë e planeve të veprimit për arritjen e objektivave strategjikë.
Me urdhër nr.350, datë 03.07.2025 "Për krijimin e komitetit të përhershëm të pranimit në nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues". Komiteti përbëhet nga z. E. H., z. A. B. dhe znj. M. B.

Struktura organizative e bashkisë.

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:
***Funksionet politike*:** Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratorët; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.
***Nëpunësit civil*:** Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a. *Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.*
b. *Nëpunës të nivelit te mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie*
c. *Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori*
d. *Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.*

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Tabela nr.1: Miratimet e strukturës organizative të Bashkisë:

Viti	VKB/Vendim Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2025	VKB nr. 44 date 27.11.2024 ,Urdhër kryetari nr.1 date 06.01.2025	2	5	9	151

Burimi: *Drejtoria e Burimeve Njerëzore përpunuar nga grupi KLSH*

Tabela nr.2: Struktura organizative e Bashkisë Konispol 2025:

Nr.	Viti	Numri i drejtorive	Numri i sektorëve	Numri i punonjësve
1	2025	5	9	151 (te miratuar)

Burimi: *Drejtoria e Burimeve Njerëzore përpunuar nga grupi KLSH*

Tabela Nr.3: Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2025:

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil 2025	Kodi i Punës 2025
Kategori e lartë	1	
E mesme drejtuese	5	
E ulët drejtuese	9	
Ekzekutive	23	
Totali	**38**	**106**

Burimi: *Drejtoria e Burimeve Njerëzore përpunuar nga grupi KLSH*

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Çdo nëpunës i Bashkisë Konispol ka përshkrimin e punës në përputhje me strukturën aktuale ndërkohë që vlerësimet e performancës realizohen në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 *'Për nëpunësin civil'*. Bashkia Konispol, kryen procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nëpunësit civilë.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Konispol nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga Bashkia Konispol është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Nga auditimi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Konispol, konstatohet se kjo njësi vendore nuk ka parashikuar në strukturën e saj organizative shërbimin e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimi në lidhje me kryerjen e shërbimit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Konispol, për periudhën në auditim, konstatohet se nuk është kryer asnjë shërbim auditimi dhe nuk është marr asnjë masë për kryerjen e shërbimit të auditimit. Gjithashtu nuk është lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi.

Veprimet më sipër janë në kundërshtim me kërkesat e; Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", të ndryshuar, neni 10 dhe neni 12/a; VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik*", të ndryshuar

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13 *"Komitetit të Auditimit të Brendshëm" i cili përcakton se "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.*

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Nga analiza e këtij parimi, rezulton se Bashkia Konispol, kryesisht, ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme.

Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar një plan strategjik dhe plane operacionale pune, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2025, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 2 datë 05.01.2025 *"Për ngritjen grupit për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Konispol"*.

GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Konispol zhvillon takimet e GMS, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.

Me shkresën nr. 322/1 prot., datë 28.02.2026 i është dërguar Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave "*Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Konispol dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"* për vitin 2025. Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë. Referuar kësaj deklarate, Bashkia Konispol, ka parashikuar të marrë këto masa për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit:

1. Rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit, në lidhje me rolin dhe përgjegjësinë për ngritjen dhe zbatimin me sukses të sistemeve të MFK dhe rolin e AB;
2. Zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut;
3. Monitorimin e vazhdueshëm të planeve strategjike dhe operacionale të njësisë. Etj.

Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 21 "Menaxhimi i riskut" përfshin: identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 – Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.

Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.

Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.

Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga analiza e të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia Konispol duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Bashkia Konispol në dokumentet e PBA ka paraqitur disa tregues përformance, por ato nuk janë për çdo program buxhetor.

Bashkia Konispol ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkrete përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga analiza e këtij parimi rezulton se përgjithësisht institucioni nuk ka përcaktuar mekanizma të mire organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Bashkia Konispol nuk ka hartuar regjistrin e riskut dhe strategjinë e riskut në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 10.

Kordinator i riskut është nëpunësi autorizues Kryetari i Bashkisë Konispol.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Konispol nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga vlerësimi i këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Konispol në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale

duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 22 "Veprimtaritë e Kontrollit" përfshijnë: procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10 – Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 – Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të analizës së kryer, mund të themi se ende ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori Ekonomik (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Kontabilitetit/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

Bashkia Konispol i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, regjistër prokurimesh. Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike"* i ndryshuar.

Bashkia Konispol nuk disponon një regjistër të azhornuar për aktivet në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike"* i ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit,

mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
Bashkia Konispol nuk përdor sisteme të teknologjisë së informacionit përveç atyre fikse përdorimi i të cilëve është mundësuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
Përsa i përket ndarjes së detyrave për funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, ato janë kryesisht të evidentuara në rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës.
Sektori i informatikës, teknologjisë së shërbimit ndjek procesin e informatizimit dhe kompjuterizimit në Bashki, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK dhe ofron asistencë teknike ndaj punonjësve të Bashkisë për mire përdorimin dhe shfrytëzimin sa më të efektshëm të teknologjisë në dispozicion.
Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
Bashkia Konispol nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.
Bashkia Konispol nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"
Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 23 "Informimi dhe komunikimi" përfshin: Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 13 – Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.
Parimi 14 – Komunikimi i brendshëm
Parimi 15 – Komunikimi i jashtëm

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të analizës së kryer, rezulton se Bashkia Konispol i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Ajo ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
Drejtoria e Financës në Bashkinë Konispol për mbajtjen e kontabilitetit nuk operon me program por të dhënat mbahen në formate exeli. Sistemi i pagesave kryhet në programin në niveli qendror programin SIFQ.
Bashkia Konispol nuk disponon program për monitorimin e të ardhurat nga taksat, të dhënat mbahen në formate Excel e cila sjell risk të shtuar për sigurinë e të dhënave.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.
Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, Bashkia Konispol sqaron se parimet bazë dhe procedurat e komunikimit janë përcaktuar në dokumentin e rregullores së brendshme të institucionit. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e Bashkisë Konispol. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.
Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Bashkia Konispol është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.
Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Komponenti: "Monitorimi"
Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 24 "Monitorimi" përcakton se monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 16 – Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta;
Parimi 17 – Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
Nga analiza e kryer, vlerësohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Raportohet mbi baza periodike pranë Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë dhe GMS për veprimtarinë financiar referuar parashikimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
Bashkia Konispol monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave për vitin 2025 me shkresën nr. 322/1 prot, datë 28.02.2026.
Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm por Bashkia Konispol nuk konstatohet se kjo njësi vendore nuk ka parashikuar në strukturën e saj organizative shërbimin e Auditit të Brendshëm.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të analizës dhe vlerësimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. z. E. D. në funksionin e Kryetarit të Bashkisë.
2. znj. O.E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Bashkia Konispol është paraqitur observacioni me shkresën nr. 438/1 prot., datë 18.06.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 382/3 prot., datë 24.06.2025, nga z. E. H. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Bashkia Konispol e ka miratuar Kodin etik me vendimin nr.9, datë 19.09.2025 nga Kryetari i Bashkisë Konispol.

- Me urdhrin nr.1/2, datë 06.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar plani vjetor i trajnimeve për punonjësit e Bashkisë Konispol.

- Në dosjet e punonjësve janë të dokumentuara përshkrimet e pozicionit të punës dhe objektivat për secilin punonjës, arsimi i punonjësve, vlerësimet e punës, kualifikimet.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana juaj, ju bëjmë me dije se, grupi i auditimit ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur dhe ka marrë në konsideratë këtë dokumentacion në hartimin e raportit përfundimtar të auditimit.
Për sa trajtuar më sipër **observacioni merret në konsideratë.**

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm

Nga auditimi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Konispol, konstatohet se kjo njësi vendore nuk ka parashikuar në strukturën e saj organizative shërbimin e Auditit të Brendshëm.
Nga auditimi në lidhje me kryerjen e shërbimit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Konispol, për periudhën në auditim, konstatohet se nuk është kryer asnjë shërbim auditimi dhe nuk është marr asnjë masë për kryerjen e shërbimit të auditimit. Gjithashtu nuk është lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi.
Veprimet më sipër janë në kundërshtim me kërkesat e; Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", të ndryshuar, neni 10 dhe neni 12/a; VKM-së nr. 83,

datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik*", të ndryshuar.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. z. E. D., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Konispol

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;
2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progressive dhe për vitin buxhetor.

2.1.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së 2025-2027 dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:
-Bashkia Konispol nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak ***"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"*** në kundërshtim me nenin 17 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 02 datë 05/01/2025.
-**Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2025-2027 nuk janë paraqitur në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar në kundërshtim me pikën nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.
Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm:
- PBA 2025-2027 faza e parë nuk është dërguar në MF në kundërshtim me pikën nr. 74 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë në kundërshtim me pikën 76 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 nuk janë miratuar me VKB në kundërshtim me pikën të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik".*

- Faza e dytë e PBA 2025-2027

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në kundërshtim me udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 82 " *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, behën pjesë e dokumentit të projektit të PBA".*

Pika 84 "Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë".

PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 52, datë 23.12.2024 dhe buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Konispo është miratuar me VKB nr.52, datë 23.12.2024. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela 4: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Konispol dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	80,924	84,023	84,333
2	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	20,646	21,646	23,153
3	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)	18,048	19,322	20,988
4	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave (04260)	2,135	2,262	2,375
5	Rrjeti rrugor rural (04520)	48,796	17,356	17,474
6	Menaxhimi i mbetjeve (05100)	-	-	-
7	Shërbimet Publike vendore (06260)	55,756	68,156	67,801
8	Trashëgimia kulturore,monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)	5,000	3,308	3,473
9	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë (09120)	19,275	17,206	18,492
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)	-	-	-
11	Përkujdesje Sociale fëmijët (10430)	-	-	-
12	Fonde Rezervë	1,000	1,000	1,050
13	Fond Kontigjencës	7,000	6,312	6,627
14	Policia(03140)	-	-	-
15	Bujqesia(04220)	-	-	-
16	Sporti (08130)	-	-	-
17	Strehim social (10661)	-	-	-
	Totali	**258,580**	**240,591**	**245,766**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 5: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve parqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Shpenzime personeli (600-601)	128,603	49.7	128,639	53.4	133,068	54.1
2	Shpenzime korente të tjera (602-609-651)	69,645	26.9	72,831	30	76,536	31.1
3	Shpenzime kapitale (230-231)	60,332	23.3	39,120	16.2	36,162	14.7
	Totali	**258,580**		**240,591**		**245,766**	

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 6: Sipas PBA 2025-2027 Bashkia Konispol tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara	8,000	-	-
2	Grante të brendshme	20,000	-	-
I	**Totali**	**28,000**	**0**	**0**
1	Nga taksat	61,226	66,267	66,267
2	Të ardhura të ndara	1,800	1,800	1,800
II	**Totali**	**63,026**	**68,067**	**68,067**
1	Transferta e pakushtëzuar	112,746	117,679	122,815
2	Transfertë specifike	54,808	54,846	54,884
III	**Shuma e transfertave**	**167,554**	**172,525**	**177,699**
	Totali I burimeve të veta (I +II+III)	**258,580**	**240,591**	**245,766**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.

Për vitin 2025, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 52, datë 23.12.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 64/1 datë 17.01.2025.

Sipas VKB nr. 52 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025" rezulton se të ardhurat nga burimet e vete të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën **91,026 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **112,746 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **54,808 mijë lekë.**

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2025 paraqitet në vijim:

Tabela 7: Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2025	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor 2025	63,026	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	112,746	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	54,808	
4	Të ardhura të tjera	28,000	
5	Paga (600)		110,200
6	Sigurime shoqërore (601)		18,403
7	Shpenzime operative (602)		56,135
8	Transferta (604-606)		13,510
9	Investime (230-231)		60,332
Totali i buxhetit		258,580	258,580

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **258,580 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon:

Gjatë vitit 2025 sipas VKB nr.52, datë 23.12.2024 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 60,332 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.

-Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 21,592 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2025 janë në vlerën 38,739 mijë lekë.

Tabela 8: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhures	Fondi limit	2025	2026	2027
1	Investime për shërbimet publike	Tr.pak + Te ardhura	22,660	5,740	10,120	6,800
2	Investime për PMZH	Tr.pak + Te ardhura	6,000	-	1,500	2,000
3	Investime për ujitje kullimin	Tr.pak + Te ardhura	18,000	-	6,000	7,000
4	Blerje beton asfaltobeton	Tr.pak + Te ardhura	30,000	15,000	-	-
5	Investime për rrugë	Tr.pak + Te ardhura	61,592	31,592	15,000	15,000
6	Investime për arsimin parashkollor	Tr.pak + Te ardhura	5,500	2,000	1,500	2,000
7	Qendra Komunitare Mursi	Tr.pak + Te ardhura	3,000	3,000	-	-
8	Investime 2024-2027	Tr.pak + Te ardhura	14,362	3,000	5,000	3,362
Total Investime				**60,332**	**39,120**	**36,162**

Burimi: Bashkia Konispol

Tabela 9: Investimet e parashikuara sipas buxhetit të vitit 2025 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhures	Fondi limit	2025		2026	
				Të ardhur	Grant	Të ardhur	Grant
1	Projekte dhe bashkëfinancime	Tr.pak + Te ardhura	4,000	3,000	-	1,000	-
2	Zgjerimi i varrezave fshati Xarrë	Tr.pak + Te ardhura	1,740	740	1,000	-	-
3	Blerje kosha për mbetje urbane	Tr.pak + Te ardhura	1,000	1,000	-	-	-
4	Kënde lojërash për fëmijë në fshatrat Xarrë dhe Shalës	Tr.pak + Te ardhura	3,000	1,500	1,500	-	-
5	Rikonstruksion salla e aktiviteteve shkolla Mehmet Xhaferri Xarrë	Tr.pak + Te ardhura	2,000	2,000	-	-	-
6	Blerje beton asfaltobeton	Tr.pak + Te ardhura	21,592	11,592	10,000	-	-
7	Shtresë asfaltike në rrugët e brendshme Konispol	Tr.pak + Te ardhura	5,000	-	5,000	-	-
8	Investim Këshilli i Qarkut Vlorë, rruga Ninat-Janjar	Tr.pak + Te ardhura	20,000	20,000	-	-	-
9	Rikonstruksion qendra komunitare Mursi		7,000	1,500	1,500	2,000	2,000
Total Investime			**65,332**	**41,332**	**19,000**	**3,000**	**2,000**

Burimi: Bashkia Konispol

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për
funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë

evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.
Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë.
Në aneksin 2/1/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB-ve.
Në aneksin 2/1/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2025 dhe ndryshimet sipas VKB-ve.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarandë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Sarandë, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Për vitin 2025 realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet **në tabelën nr.10** si mëposhtme:

000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		603-609(transf indivi)		230-231(investime)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	113,176	113,160	18,404	18,392	78,278	76,313	13,510	102	60,332	46,227	283,700	254,194
Fonde të kushtezuara	-	3,680	-	517	-	1,127	-	44,914	-	50,384	-	100,622
Total	-	116,840	-	18,909	-	77,440	-	45,016	-	96,611	-	354,816
Perqindja e realizimit pa fonde të kushtezuara	**99%**		**99%**		**97.5%**		**1%**		**76%**		**89.5%**	

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:
Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 254,194 mijë lekë nga 283,700 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 89.5 %. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
Shpenzimet për investime llog. 230-231 nga buxheti i Bashkisë janë realizuar ne masën 76%.

-Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime nga të ardhurat e Bashkisë Konispol në shumën ***60,332 mijë lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura) dhe janë ***realizuar në vlerën 46,227 lekë, ose në masën 76%***.

Tabela realizimit te Investimeve 2025:

Tabela nr. 11: Investimet e realizuara me fonde të Bashkisë Konispol dhe fonde të buxhetit të shtetit për vitin 2025

Objekti	1	5	Fondi i kushtëzuar	Kodi i Ministrise	Vlera e likuiduar
Materiale (Beton asfaltobeton)	5,374,200	-	-	-	5,374,200
Materiale (Beton asfaltobeton)	25,080	11,589,000	-	-	11,614,080
Linja celikut Markat	0		13,000,000	5	13,000,000
Kanali i Manastirit	0		3,556,400	5	3,556,400
Shtrese asfalistike Konispol	4,086,288		-		4,086,288
Mbrojtje lumore			20,145,741	17	20,145,741
Mobilim shkolla	0	250,000	-		250,000
Ndricim publik		1,197,800	-		1,197,800
Kazane metalik	0	921,600	-		921,600
Materiale (Beton asfaltobeton)	4,597,248		-		4,597,248
Shkolla Konispol	0	0	9,993,681	11	9,993,681
Varreza Xarre	659,988		-		659,988
Ruga Ninat Janjar	0	15,977,640	-	Qarku Vlore	15,977,640
Perroi i Barcit	0		3,660,000	17	3,660,000
Ndricim publik	0	802,200	-		802,200
Mobilim shkolla	0	277,000	-		277,000
Mobilim shkolla		37,990	-		37,990
Mobilim shkolla		435,000	-		435,000
Total	**14,742,804**	**31,488,230**	**50,355,822**		**96,586,856**

Burimi: Bashkia Konispol

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Konispol së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2024 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 283,700 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 254,194 mijë lekë, ose në masën 89.5 %.

Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 60,332 mijë lekë, realizuar 46,227 mijë lekë, ose në masën 76%

Bashkia Konispol në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku thuhet:

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 3,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 52 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxheti

vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 i Bashkisë Konispol, dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 64/1 datë 17.01.2025.

b. Fondet e emergjencës.

Në bazë të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 65, nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) Bashkia Konispol ka përfituar fonde. Bazuar në VKM nr. 414, datë 08.07.2021 *"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"* dhe me VKB përkatëse është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira, duke i detajuar ato, sipas zërave të shpenzimeve dhe më pas është kryer prokurimi i tyre, sipas të cilave janë kryer shpenzimet.

Për vitin 2025 me shkresën nr.492/1 datë 25.02.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" Bashkisë i është akorduar *fondi në vlerën **1,928,000 lekë.*** me VKB nr. 46 datë 30.10.2025 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.12: Për vitin 2025 përdorimi i fondeve të AKMC

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për karburant për rehabilitimin e rrugës së malit Xarrë	1,928,000	1,928,000	0
	Total	**1,928,000**	**1,928,000**	**0**

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, përpunuar nga grupi i auditimit

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Për vitin 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me e-mail datë 26.05.2025.

"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me e-mail datë 24.09.2025.

"Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2025" me e-mail datë 23.02.2026.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Bashkia Konispol në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 38,865,000 lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura nuk është planifikuar për likuidim në buxhetin e vitin 2025.

Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2025 është në vlerën 20,249,368 lekë. Nga auditimi konstatohet se, në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë marrë masat për të mbuluar më parë detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe më pas fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 153-162, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 52, UMF nr. 5, datë 27.12.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82-91.

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2025 janë të pa likuiduara gjithsej 55 fatura me vlerë 20,249,368 lekë**.**

Në aneksin 2/1/3 në anekset e projekt raportit të auditimit janë paraqitur detyrimet e prapambetura.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr.286 prot., datë 23/02/2026 jepen në tabelën si më poshtë:

Tabela Nr. 13: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

Në lekë

		Viti 2025		
NR	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë ne fund te vitit 2025**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**20,249,368**		**7.97%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	3,661,600		
4864201	D.P.Eneri Elektirke	3,732,511		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	3,001,312		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	9,853,945		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**20,249,368**	**253,935,910**	**7.97%**

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela Nr. 14: Projektet e investime të financuara nga Ministritë e Linjës viti 2025:

Investimi	**Kontrata**	**Vlera e Kontratës me TVSH**	**Plan 2025**	**Fakt 2025**	**% realizimit**	**Statusi**
Sistemi i ngrohjes, rritje e eficencës energjitike dhe terrene sportive në shkollën "Bido Sejko", Konispol	15.08.2025	57,385,458	10,592,774	9,993,681	18	Proces
Ndërhyrje emergjente në përroin e "Barçit", Shalës	01.09.2025	15,681,204	3,660,000	3,660,000	100	Përfunduar

Burimi: Bashkia Konispol

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. znj. O. E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik
2. z. D. Ll. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit.

2.6. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progressive dhe për vitin buxhetor.

Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e Bashkisë Konispol e zbatuar për vitin 2025 është miratuar me Urdhrin nr.4, datë 06.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë me objekt *"Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Konispol për vitin 2025"*, në të cilën përfshihet edhe Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve si pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik e përbërë nga 5 pozicione pune konkretisht: 1 Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve (në vijim SSHT), 3 Specialist për Tatimet dhe Taksat dhe 1 Punonjës për Tatimet dhe Taksat.

Plotësimi i strukturës të SST-së paraqitet me 4 vende të plotësuara ose në masën 80 %, që në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë **në tabelën nr.15:**

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i shkollës	I lartë ose i mesëm	Urdhri i emërit nr. datë	Pozioni i punës
1	**D. K.**	Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Taksapaguesve	Kontabilitet-Financë	I lartë	01.06.2018	Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Taksapaguesve
2	**S. S.**	Punonjës për Tatimet dhe Taksat	-	I mesëm	01.03.2024	Punonjës për Tatimet dhe Taksat
3	**D. S.**	Specialist Tatim Taksash	-	I lartë	01.03.2024	Specialist Tatim Taksash
4	**L.M.**	Specialist Tatim Taksash	-	-	-	-
5	Vakant	Specialist Tatim Taksash	-	-	-	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Konispol

Për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, në lidhje me planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se është hartuar dhe zbatuar ***Paketa Fiskale*** e miratuar me VKB nr.43, datë 27.11.2024, me objekt *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"*, për të cilën është marrë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë me nr. 1102/1 prot., datë 20.12.2024. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2025, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se:

- Bashkia Konispol nuk ka një sektor për regjistrim të përgjithshëm të të ardhurave për të gjithë taksat dhe tarifat vendore sipas strukturës së miratuar në paketën fiskale dhe për të gjithë territorin që ka në administrim, por organizimin e veprimtarisë së saj sa i përket menaxhimit të të dhënave pra planifikimin, njoftimin e detyrimit, regjistrimin, ç'regjistrimin dhe arkëtimin e kryen vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik në formatin Excel (veçmas për çdo njësi administrative dhe vetëm për taksat/tarifat për të cilat SSHT-ja ngarkohet për vjeljen sipas paketës fiskale pra jo për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së miratuar në paketë fiskale për vjeljen e të cilave ngarkohen sektorët e tjerë).
- SSHT-ja përllogaritjen e njoftim detyrimeve e bën brenda afateve të përcaktuara në paketë fiskale, por nuk realizohet në kohë njoftimi i të gjitha subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe Biznes.
- Në Bashkinë Konispol bëhet publikimi i VKB-ve në platformën online "Vendime.al".

Nga ana e Bashkisë Konsipol janë reflektuar ndryshimet e statusit të biznesit, këto janë pasqyruar në shkresat bashkëpunuese me QKB për subjektet me status pasiv/mbyllur gjatë vitit, si vijon:

Tabela Nr. 16: Ndryshimet e statusit të biznesit gjatë vitit 2025.

Nr.	Subjekti	Inspektor	Datë shkrese QKB	Nr.Prot Bashkia	Mbyllur/Pezullim /Riaktivizim	Janar-Dhjetor 2025
1	Fermer **K. Sh.**	**D.K.**	29.01.2025		Mbyllur	PO
2	Fermer **H. J.**	**D.K.**	09.05.2025	623	Mbyllur	PO
3	Fermeri **Th. K.**	**D.K.**	03.04.2025	402/1	Mbyllur	PO

4	Fermeri **M.D.**	**D.K.**	03.04.2025	402	Mbyllur	PO
5	Fermeri **T. Xh.**	**D.K.**	29.01.2025	136	Mbyllur	PO
6	Fermeri **I. Z.**	**D.K.**	03.02.2025	164	Mbyllur	PO
7	Fermeri **H. I.**	**D.K.**	21.11.2025	1763	Mbyllur	PO

Burimi: Bashkia Konispol

- Procesi për planifikimin, përllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore nuk është i saktë pasi planifikimi për taksa dhe tarifa vendore nuk është kryer bazuar në rakordimin midis SSHT-së, Drejtorisë Rajonale të Tatime Sarandë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Konispol, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive/sektorëve që mbulojnë realizimin e tyre. Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e parealizuara për vitin 2025, ka sjellë mangësi në planifikimin e tyre ose në planifikimin në vlera jo reale të pa studiuara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

Auditimi i "Regjistrit Elektronik" të Tatimeve dhe Taksave Vendore ndaj subjekteve tatim paguese, që ngarkohen dhe shlyhen nga subjektet;

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj., në regjistrin elektronik të SSHT-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues.
- SSHT-ja çdo fillim viti krijon një regjistër të në format excel për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që këto njësi administrojnë (veçmas për çdo njësi administrative) SSHT në Zyrat e Taksave pranë NjA Konispol dhe Zyrat e Taksave pranë NjA Xarrë dhe Markat, të cilat bëjnë menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit/ç'regjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.

- SSHT-ja për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe arkivim të kopjes së printuar dhe elektronike (CD) përpara krijimit të regjistrit elektronik të ri vjetor.

Të dhënat që administrohen në regjistrin elektronik (informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullon regjistrin elektronik), shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat e nivelit të dytë apo QKB) realizimi në drejtimin e Bashkisë Konispol dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

- Auditimi i "Regjistrin Elektronik" për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky regjistër administron të dhëna për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", në nivel lokal. Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.

Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe

njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar për sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: *"Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria".*

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që i shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, proçesi, apo aktiviteti.

Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë kuadrin rregullator që shërben për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësive publike, janë të përshtatshme dhe efektive, për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri. Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat;
- Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme dhe të plota;
- Mbron informacionin dhe aktivet e saj.

- SSHT-ja nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar apo përshkrim të proceseve të punës së personelit që operon në "Regjistrin elektronik", ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar.

Bashkia Konispol organizimin e veprimtarisë së SSHT-së e bën duke u mbështetur vetëm në "Regjistrin Elektronik" (veçmas për çdo njësi administrative). Për çdo njësi administrative ky regjistër bën menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit/ç'regjistrimit, planifikimin, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve dhe administrimin e debitoreve për abonentët familjarë, personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.

- Struktura e kategorizimit të regjistrit për bizneset dhe popullatën është e ndërtuar bazuar në paketën fiskale të miratuar. SSHT-ja çdo fillim viti krijon një regjistër të ri për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në SSHT dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues.

Raportet të cilat prodhohen nga informacioni që popullon regjistrin elektronik (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat enivelit të dytë apo QKB etj.,) shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim në drejtimin e Bashkisë Konispol dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për manaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron (Sipas strukturës së Paketës Fiskale). Këto drejtori nuk rakordojnë me SSHT-në lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 43, datë 27.11.2024, "*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"* dhe kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Konispol për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit.

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore përdor për veprimtarinë e tij evidencën e vënë në dispozicion nga SSHT-ja e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin Excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin) si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur efiçencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.

-Raportet e monitorimit dhe raportet vjetore të hartuara nga ana SSHT-së nuk kanë bashkëlidhur gjurmë dokumentare justifikuese të raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit.

- Nuk administrojnë regjistër për të gjitha taksat/tarifat vendore (Sipas strukturës së paketës fiskale) dhe për gjithë territorin që ka nën administrim qoftë dhe në formatin Excel për të parandaluar për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikime të paautorizuara të të dhënave.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të ndryshimeve sipas natyrës së veprimit).
- Nuk administrohen në dosjet e subjekteve proces-verbale sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat/pagesat e detyrimeve mbi taksat dhe tarifat vendore (Credit Note).

Nuk ka bashkëveprim me burimet njerëzore për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë punësuar rishtaz, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave personale për regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, *"Për bazat e të dhënave shtetërore"* nenin 3; Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, *"Për sigurinë kibernetike"* neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 *"Për bazat e të dhënave shtetërore"* Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* të ndryshuar" nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27, 28; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, *"Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore"* i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit",* (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, *"Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"*, (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4,

"Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, gërma "a", të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT);

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Bashkia Konispol është paraqitur observacioni me shkresën nr. 438/1 prot., datë 18.06.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 382/3 prot., datë 24.06.2025, nga z. **D. K.** ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Konispol administron një regjistër për të gjitha llojet e taksave dhe ka monitorim dhe dokumentacion përkatës nëqoftëse ka ndryshime mbi taksat dhe tarifat vendore.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana juaj ju bëjmë me dije se, Bashkia Konispol nuk administron një sistem të çertifikuar për regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit për abonentët familjarë dhe privatë për Bashkinë Konispol.

Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve me shkresën nr.357, datë 06.03.2026 ka përcjell për kontabilizim debitorët biznes dhe familjar. Sa më sipër struktura për administrimin e dhe mbledhjen e të ardhurave ka dhënë informacion me shkresë përcjellëse dhe analitik për debitorët në datën 31.12.2025

Për sa trajtuar më sipër ***observacioni merret pjesërisht në konsideratë.***

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Konispol për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin nr. 43, datë 27.11.2024, të Këshillit Bashkiak me objekt *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025"* për të cilën është marrë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1102/1 prot., datë 20.12.2024. Në këtë dokument nuk janë përcaktuar saktë afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për tatimpaguesit privat dhe familjarë. Afati i pagesës është pjesë integrale e paketës fiskale, si një element i rëndësishëm taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet ti nënshtrohet gjykimit të këshillit bashkiak.

Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Sa më sipër, në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 5, gërma "c", ku përcaktohet që: "Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

Tabela Nr. 17: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Konispol për vitin 2025 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Lloji I Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	Te ardhura nga Tatimet						
1	Te ardhura shitje trualli (troje te papaguara)	10,840,000		0%	10,840,000		0%
2	Takse vendore biznesi i vogel						
3	Tatim fitimi biznesi i vogel	600,000	44,000	7%	600,000	101,446	17%
II	Te ardhura nga Taksat						
4	Taksa mbi token Bujqesore	14,312,000	8,139,000	57%	14,312,000	7,095,249	50%

5	Taksa e Pasurisë, ndertese	4,288,000	2,913,000	68%	4,288,000	2,285,041	53%
6	Takse mbi rregj e Automjete	1,800,000	3,268,000	182%	1,800,000	4,243,998	236%
7	Taksa zenie e hapesires publike	260,000	16,000	6%	260,000	50,000	19%
8	Takse trualli ndertese	498,000	232,000	47%	498,000	302,844	61%
9	Takse ndikimi ne infrastrukture	4,340,000	1,192,000	27%	4,340,000	3,094,703	71%
10	Takse fjetje ne hotel	40,000	23,000	58%	40,000	13,000	33%
11	Takse tabele	20,000	26,000	130%	20,000	9,240	46%
12	Takse parkimi	743,000	15,000	2%	743,000	3,000	0%
I	Rregjister biznesi i ri	20,000		0%			
III	Te ardhura nga Tarifat						
12	Tarife Pastrimi	4,825,000	3,135,000	65%	4,825,000	2,964,750	61%
13	Te ardhura qera troje	1,300,000	713,000	55%	1,300,000	200,000	15%
14	Tarife qera kullote	5,400,000	2,670,000	49%	5,400,000	827,700	15%
15	Qera toke bujqesore	1,900,000	559,000	29%	1,900,000	533,062	28%
16	Tarife leje certifikate transporti	406,000	155,000	38%	406,000	1,198,250	295%
IV	Te tjera tarifa administrative	7,268,000	5,087,000	70%	8,614,000	6,106,472	71%
21	Tarife sherbimi	51,000		0%	518,000		0%
22	Tarife vorreza publike	2,490,000		0%	2,490,000		0%
23	Tarife ndricimi publik	4,145,000		0%	5,491,000		0%
24	Tarife ujra te zeza	110,000		0%	110,000		0%
25	Leje certifikate veterinare	5,000		0%	5,000		0%
26	Te tjera gjoba ndalesa	200,000	10,000	5%	200,000		0%
27	Te ardhura sekondare / Tarife Vaditje + mirmbajtje	2,380,000	5,328,000	224%	2,380,000	10,426,281	438%
28	Te ardhura ZVRPP Sarande	260,000		0%	260,000		0%
29	Sponsor nga Individe	2,500,000	1,605,000	64%			
30	Te ardhura Qarku Vlore						
31	Grand Tap					4,062,305	
32	Grand Qarku					19,958,500	
	Totali	**71,001,000**	**35,130,000**	**49%**	**71,640,000**	**63,475,841**	**89%**

Burimi: Bashkia Konispol

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **71,640,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **63,475,841 lekë** ose në masën **88.6%** me diferencë nga plani vjetor në vlerën 8,164,159 lekë. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara vitit kanë ndodhur për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t'u arkëtuar.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Taksa mbi regjistrimin e automjeteve" është planifikuar në vlerën 1,800 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,243 mijë lekë ose realizuar në masën 235.7%.
b. "Tarife leje certifikate transporti" është planifikuar në vlerën 406 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,198 mijë lekë ose realizuar në masën 295.1%
c. "Të ardhura sekondare/Tarifë vaditje + mirëmbajtje" është planifikuar në vlerën 2,380 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,426 mijë lekë ose realizuar në masën 438%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Taksa mbi tokën bujqësore" është planifikuar në vlerën 14,312 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,095 mijë lekë ose realizuar në masën 49.5%.
b. "Taksa e pasurisë, ndërtesë" është planifikuar në vlerën 4,288 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,285 mijë lekë ose realizuar në masën 53.2%.
c. "Taksë ndikimi në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 4,340 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,094 mijë lekë ose realizuar në masën 71.3%.

d. “Tarifë pastrimi” është planifikuar në vlerën 4,825 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,964 mijë lekë ose realizuar në masën 61.4%.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Bashkia Konispol është paraqitur observacioni me shkresën nr. 438/1 prot., datë 18.06.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 382/3 prot., datë 24.06.2025, nga z. **D. K.** ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me parashikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve afati i pagesës për mbledhjen e taksave dhe tarifave është 1 vjeçar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana juaj ju bëjmë me dije se referuar planit të buxhetit për vitit 2025 është planifikuar të realizohen të ardhura në vlerën 71,000 mijë lekë. Në bazë të arkëtimit të të ardhurave mund të realizojmë buxhetin e planifikuar por gjithashtu është e rëndësishme është edhe periudha kur realizohen të ardhurat sepse nqoftëse vendosim si afat për pagesën e taksave dhe tarifave vendore datën 31.12.2025 atëherë të ardhurat të cilat do ti mbledhin edhe pse mund të arrihet planifikimi këto të ardhura nuk janë pjese e vitit fiskal por do të transferohen në vitin e ardhshëm. Bashkia Konispol duhet të përcaktoj një afat për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore pa cënuar realizimin e buxhetit të vitit.

Për sa trajtuar më sipër ***observacioni nuk merret në konsideratë.***

Analiza e dinamikës së të ardhurave vendore 2025 krahasuar me vitin 2024:

I. Të ardhura nga tatimet

Të ardhurat nga tatimet për vitin 2025 janë planifikuar kryesisht nga të ardhurat nga shitja e truallit dhe tatim fitimi i biznesit të vogël. Në total, kjo kategori paraqet nivel realizimi më të ulët krahasuar me pritshmëritë, duke reflektuar vështirësi në arkëtimin e disa zërave kryesorë.

Treguesit kryesorë:

Të ardhura nga shitja e truallit (troje të papaguara): për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 10,840 mijë lekë, ndërsa nuk rezulton realizim gjatë periudhës raportuese. Ky zë mbetet me nivel realizimi 0% të planit, duke ndikuar negativisht në totalin e të ardhurave nga tatimet.

Tatim fitimi i biznesit të vogël: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 600 mijë lekë dhe është realizuar 101 mijë lekë ose 16.9% e planit. Krahasuar me vitin 2024, ku realizimi ishte 44 mijë lekë, konstatohet një rritje prej 130.5% ose (+) 57 mijë lekë më shumë. Megjithëse niveli i realizimit ndaj planit mbetet i ulët, ky tregues paraqet përmirësim krahasuar me vitin paraardhës.

Taksa vendore e biznesit të vogël: për vitin 2025 nuk rezulton planifikim dhe realizim i veçantë në tabelën raportuese.

II. Të ardhura nga taksat dhe tarifat

Të ardhurat totale për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 71.640 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 63,476 mijë lekë ose 88.6% e planit. Krahasuar me vitin 2024, ku realizimi ishte 35,130 mijë lekë, konstatohet një rritje prej 80.7% ose (+) 28,346 mijë lekë më shumë. Kjo tregon një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave vendore dhe një përmirësim të ndjeshëm të nivelit të arkëtimeve.

Treguesit kryesorë:

Taksa mbi tokën bujqësore: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 14,312 mijë lekë dhe është realizuar 7,095 mijë lekë ose 49.6% e planit. Krahasuar me vitin 2024, ku janë arkëtuar 8,139 mijë lekë, rezulton një ulje prej (-) 12.8% ose 1,044 mijë lekë më pak. Kjo tregon vështirësi në arkëtimin e kësaj takse dhe nevojën për përmirësimin e administrimit fiskal në sektorin bujqësor.

Taksa mbi pasurinë (ndërtesa): për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 4,288 mijë lekë dhe është realizuar 2,285 mijë lekë ose 53.3% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një ulje prej (-) 21.6% ose 628 mijë lekë më pak. Niveli i ulët i realizimit tregon se mbetet e nevojshme rritja e eficiencës në identifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve.
Taksa mbi regjistrimin e automjeteve: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 1,800 mijë lekë dhe është realizuar 4,244 mijë lekë ose 235.8% e planit. Krahasuar me vitin 2024 rezulton një rritje prej 29.9% ose (+) 976 mijë lekë më shumë. Kjo taksë ka tejkaluar ndjeshëm planifikimin, duke reflektuar rritjen e numrit të mjeteve të regjistruara dhe përmirësimin e arkëtimeve.
Taksa për zënien e hapësirës publike: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 260 mijë lekë dhe është realizuar 50 mijë lekë ose 19.2% e planit. Krahasuar me vitin 2024 ka një rritje prej 212.5% ose (+) 34 mijë lekë më shumë. Megjithëse realizimi ndaj planit mbetet i ulët, të ardhurat kanë shënuar përmirësim krahasuar me vitin paraardhës.
Taksa e truallit për ndërtim: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 498 mijë lekë dhe është realizuar 303 mijë lekë ose 60.8% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një rritje prej 30.5% ose (+) 71 mijë lekë më shumë.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 4,340 mijë lekë dhe është realizuar 3,095 mijë lekë ose 71.3% e planit. Krahasuar me vitin 2024, ku realizimi ishte 1,192 mijë lekë, rezulton një rritje shumë e lartë prej 159.6% ose (+) 1,903 mijë lekë më shumë. Kjo lidhet me shtimin e investimeve dhe lejeve të ndërtimit gjatë vitit.
Taksa e fjetjes në hotel: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 40 mijë lekë dhe është realizuar 13 mijë lekë ose 32.5% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një ulje prej (-) 43.5%.
Taksa e tabelës: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 20 mijë lekë dhe është realizuar 9 mijë lekë ose 46.2% e planit. Krahasuar me vitin 2024 konstatohet ulje prej (-) 64.5%.
Taksa e parkimit: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 743 mijë lekë dhe është realizuar vetëm 3 mijë lekë ose 0.4% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një ulje shumë e ndjeshme prej (-) 80%.

III. Të ardhura nga tarifat

Të ardhurat nga tarifat paraqesin ecuri të ndryshme sipas kategorive.
Tarifa e pastrimit: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 4,825 mijë lekë dhe është realizuar 2,965 mijë lekë ose 61.4% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një ulje prej (-) 5.4%.
Të ardhura nga qiraja e trojeve: janë planifikuar 1,300 mijë lekë dhe janë realizuar 200 mijë lekë ose 15.4% e planit, me ulje prej (-) 71.9% krahasuar me vitin 2024.
Tarifa qira kullote: është planifikuar në vlerën 5,400 mijë lekë dhe është realizuar 828 mijë lekë ose 15.3% e planit. Krahasuar me vitin 2024 rezulton ulje prej (-) 69%.
Qira tokë bujqësore: është planifikuar në vlerën 1,900 mijë lekë dhe është realizuar 533 mijë lekë ose 28% e planit. Krahasuar me vitin 2024 paraqitet një ulje e lehtë prej (-) 4.6%.
Tarifa për leje dhe certifikata transporti: është planifikuar në vlerën 406 mijë lekë dhe është realizuar 1,198 mijë lekë ose 295.1% e planit. Krahasuar me vitin 2024 rezulton rritje shumë e lartë prej 672.7% ose (+) 1,043 mijë lekë më shumë.

IV. Të tjera tarifa administrative

Në kategorinë e tarifave administrative, ndikimin kryesor e kanë dhënë të ardhurat sekondare nga tarifa e vaditjes dhe mirëmbajtjes.
*Të ardhura sekondare / tarifa vaditje + mirëmbajtj***e:** për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 2,380 mijë lekë dhe janë realizuar 10,426 mijë lekë ose 438% e planit. Krahasuar me vitin 2024,

ku realizimi ishte 5,328 mijë lekë, rezulton një rritje prej 95.7% ose (+) 5,098 mijë lekë më shumë. Ky është një nga zërat me performancën më të lartë në realizimin e të ardhurave.
Grant TAP: gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 4,062 mijë lekë.
Grant nga Qarku: gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 19,959 mijë lekë, duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e totalit të të ardhurave për vitin ushtrimor.

- ***Analiza e përgjithshme e të ardhurave.***

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.
Nga SSHT-ja nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Konispol që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"* Kreu IV, pika 200.

<u>Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:</u>
Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2025 nga Bashkia Konispol miratuar me Vendimin nr. 8, datë 19.09.2025, të Kryetarit të Bashkisë me objekt "Për miratimin e rregullores "Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative", nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimore dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.

Çdo muaj miraton akt-rakordimet e paraqitura nga Agjenti tatimor sipas informacionit të dhënë nga të gjitha strukturat e Bashkisë apo subjektet e tjera që luajnë rolin e agjentit tatimor për taksat dhe tarifat vendore, sipas ligjit apo vendimeve të Këshillit Bashkiak.

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Sarandë", për llogari të Bashkisë Sarandë. Akt rakordimi me DPSHTRR realizohet vetëm nëpërmjet Degës së Thesarit Sarandë, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës "b", të pikës 2, në nenin 25 "*Të ardhurat nga taksat e ndara*" të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura si vijon:

Neni 25/2: Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë: a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë; b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare; ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. 3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës

Taksa mbi regjistrimin e automjeteve" është planifikuar në vlerën 1,800,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,243,998 lekë ose realizuar në masën 235.7%.

Të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (ASHK Sarandë për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugorë Sarandë derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Konispol dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Sarandë duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor.

Tabela Nr. 18: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga Agjentët Tatimorë paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit(Agjenti DRT)	600,000	101,406
2	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	1,800,000	4,243,998
3	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	260,000	
Totali		**2,660,000**	**4,345,404**

Burimi : Bashkia Konispol

- Për vitin 2025 ndërmjet SSHT-së Bashkisë Konispol dhe ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore.

Nga auditimi i regjistrave elektronike te AKBN nuk ka leje minerare te miratuara për Bashkinë Konispol.

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Konispol i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Sarandë por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë Bashkia Konispol duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore"*, neni 117. , ku përcaktohet që "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore*

në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, *"Për taksat kombëtare".*

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Konispol kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve disponon regjistra fizik. Në këto regjistra paraqitet informacion për pagesat e kryera dhe njëkohësisht disponohet informacion për abonentë familjarë debitorë. Për abonentët të cilët janë të përjashtuar nga taksat dhe tarifat vendore sipas paketës fiskale me. nr. 43, datë 27.11.2024, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Konispol për vitin 2025"* nuk është regjistruar statusi i tyre "pensionist", "ndihmë ekonomike" etj.

Informacioni i azhornuar për abonentët familjarë gjendet vetëm në regjistrat elektronike në formatin Excel.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar".

Abonentët familjarë:

Referuar të dhënave që disponohen, në Regjistrin Civil në territorin e Bashkisë Konispol në total janë **2,395** abonentët familjarë të cilët ndahen sipas njësive administrative si mëposhtë:

Tabela Nr. 19: Të dhënat abonentët familjarë

Nr.	Qyteti/Njësia	Nr. Abonentëve familjarë
1	Konispol	742
2	Xarrë	850
3	Markat	803
Total		**2395**

Burimi: Bashkia Konispol

- Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve:

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë. Për këtë, nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve përdoren kontratat e popullatës për furnizimin me energji elektrike sipas OSHEE me përditësimet përkatëse.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Tarifa mirëmbajtje vaditje + kullim aplikohet në qytetin e Konispolit dhe Njësitë Administrative Xarrë dhe Markat. Parashikimi bëhet në bazë të sipërfaqes së tokës brenda zonës ku ofrohet ky shërbim. për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 2,380 mijë lekë dhe është realizuar 10,426 mijë lekë ose 438% e vlerës së planifikimit, me (+) 8,046 mijë lekë më shumë.

Bashkia Konispol nuk ka lidhur kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:
Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në dy Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.
Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj., Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nëpërmjet kryepleqve dhe pleqësive të fshatrave. Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.
Referuar të dhënave të Regjistrit Civil në territorin e Bashkisë Konispol në total janë 2,395 abonentë familjarë konkretisht e ndarë kjo 742 abonentë Konispol, 850 abonentë në NjA Xarrë dhe 803 abonentë në NjA Markat.
Tabela Nr. 20: Paraqiten të dhënat detyrimet e abonentëve familjarë për taksat dhe tarifat vendore, si më poshtë:

Taksa Tokes, Tarifa dhe taksa vendore Familjare				
Njësia	**Detyrime 31.12.2024**	**Shtesa 2025**	**Pagesa total gjate 2025**	**Gjendja 31/25**
Konispol	16,676,196	3,929,287	5,582,715	15,022,768
Xarre	9,661,580	3,474,853	927,032	12,209,401
Markat	20,281,702	4,160,983	1,457,033	22,985,652
Totali	**46,619,478**	**11,565,123**	**7,966,780**	**50,217,821**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

- Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Konispol janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjithë njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave të taksapaguesve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, 132 subjekte biznesi kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, siç paraqiten në pasqyrën si më poshtë
Tabela Nr. 21: Evidenca e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore në numër.

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet + Njësitë Administrative	1	Biznesi i Madh	2025	8			8
Qytet + Njësitë Administrative	2	Biznesi i Vogël	2025	124			124
Total 3+4				**132**			**132**

Burimi: Bashkia Konispol

Për vitin 2025, kanë ushtruar aktivitet 132 subjekte *(124 subjekte të biznesit të vogël, 8 subjekte të BM)*

Sipas të dhënave të DTA, me dt 01.01.2025 numri i subjekteve që ngarkohen me taksa dhe tatime përfshin këto kategori abonentësh:

- *Abonentë familjarë :2395*
- *Biznesi juridik 132*

Gjithsej132 subjekte tatimpaguese.

Sipas Vendimit KB Konispol nr.52, datë 23/12/2024 "*Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 dhe buxhetit të Bashkisë Konispol për vitin 2025"*, plani i të ardhurave totale nga burimet e veta vendore për vitin 2025 ishte 71,640 mijë lekë dhe u realizua 63,475 mijë lekë.

Në të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshihen 1.të *ardhurat nga taksat vendore, 2.nga taksat e ndara, 3.të ardhurat nga tarifat vendore dhe 4.të ardhurat nga burime të tjera.*

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore:

Deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjekte si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **5,382,791.** Përgjatë vitit 2025 janë shtuar debitorë në vlerën **684,805 lekë** gjendja debitore më datë 31.12.2025, është në vlerën **6,067,596 lekë** .

Tabela Nr. 22: Të dhënat për situatën debitore sipas Nj.A paraqiten si më poshtë:

Detyrime Subjekte Biznese					
Njësia	**Detyrime 31/24**	**Shtesa 2025**	**Pagesa total gjate 2025**	**Gjendja 31/25**	**Nr. Biznese**
Konispol	2,647,503	59,727	.	2,707,230	20
Xarre	420,540	37,600	-	458,140	22
Markat	2,314,748	587,478		2,902,226	31
Totali	**5,382,791**	**684,805**	**.**	**6,067,596**	**73**

Burimi: Bashkia Konispol

Në lidhje me këtë situatë DTT e Bashkisë Konispol për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve"*. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.*

Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i kryer , konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, kanë paraqitur kërkesë pranë ASHK Dega Rajonale Sarandë për pajisjen me vërtetim gjithsej 7 persona detyrim i cili është likuiduar në vlerën 362,592 lekë që përfshin dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë, ndërsa në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në

infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje përpara vitit 2024 konstatohet se gjendja debitore ngelet e pa ndryshuar, konkretisht nuk kanë paguar detyrimin 11 persona në vlerën **246,548 lekë.**

Tabela Nr. 23: Të dhënat për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë						
Viti	**Persona**	**Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë**	**Nr. i personave**	**Vlera e arkëtuar**	**Nr. I perosnave**	**Vlera e detyrimit**
Deri më datë 31.12.2025 debitore	11	246,548	11		11	246,548
2025 pagesa	7	362,592	7	362,592		

Burimi: Bashkia Konispol

Për më tepër nga Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit Bashkia Konispol nuk është kryer asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d",* Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1,* dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, *"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.*

<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçensuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Konispol kanë ushtruar në total 3 subjekte me aktivitet tregtim me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj. Për vitin 2025 nga totali prej 3 subjekte, 2 subjekte janë të pajisura me autorizim për tregtimin e hidrokarburave dhe derivative të tyre dhe 1 subjekt nuk është i pajisur me autorizim.

Tabela Nr. 24: Të dhënat për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e hidrokarbureve paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

lekë

Nr.	**Subjekti**	**Nipt**	**Afati i Autorizimit**		**Detyrimi për autorizimin**	**Pagesat e kryera**	**Diferenca**
			Fillimi	**Mbarimi**			
1	L. Shpk	K048	25.06.2020	25.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
2	H. Shpk	J948	07.10.2021	07.10.2026	1,000,000	1,000,000	0
3	I.Shpk	L038	-	-	1,000,000	0	1,000,000
Totali					**3,000,000**	**2,000,000**	**1,000,000**

Burimi: Bashkia Konispol

Për sa i përket subjektit "I." ShPK i cili ushtron aktivitet i pa pajisur me autorizimin për tregtimin e hidrokarbureve dhe derivative të tyre nga Bashkia Konispol është mbajtur dosja dhe korrespodenca si më poshtë:

Me shkresën nr. 4, datë 10.05.2015, Subjekti "I" ShPK është pajisur me autorizim për tregtimin me pakicë të karburanteve nga Komuna Markat me afat vlefshmërie 5 vjet. Me shkresën me nr. Extra prot., datë 05.06.2020, Bashkia Konispol është drejtuar subjektit "I" ShPK me njoftim për pajisjen me liçensë për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, ku i bën me dije këtij të fundit që afati i autorizimit ka përfunduar dhe detyrimi për përsëritjen e liçensës është 1,000,000 lekë. Me shkresën nr. 322 prot., datë 18.03.2025, Bashkia Konispol i ka rikujtuar subjektit "I" ShPK detyrimin ligjor për pajisjen me licencë. Subjekti "I" ShPK ka kryer pagesën

në shumën 500,000 lekë me datë 21.04.2026 me qëllim pajisjen me autorizim. Ky subjekt nuk është pajisur me autorizim për shkak të moskryerjes së pagesës së plotë.
Për më tepër në lidhje me problematikën e sipërpërmendur, nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* VKM nr. 170, datë 25.04.2002*, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4,* dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar* me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, *Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15.*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. E. D., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Konispol
2. z.D. K., në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesit

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
2.3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2025;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Konispol, për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2025 Bashkia Konispol ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen vetëm aparati i Bashkisë Konispol sepse Bashkia Konispol nuk ka njësi shpenzuese të tjera. Bashkia Konispol për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Sarandë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e*

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Konispol për vitin 2025 janë të nënshkruara nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. O. E. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Elbasan në datë 28.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol për aktivitetin ekonomiko- financiar për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.
Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).
- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=1,924,878,621 lekë.
- Aktivet 2,046,503,099 lekë
- Detyrimet 121,624,478 lekë
- Aktivet Neto 1,924,878,621 lekë

Aktivet afatshkurtra:
Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **136,583,710 lekë** dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 32,830,430 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 7,327,988 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 96,425,292 lekë;

Fondi i Konsoliduar:
Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.
Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës '*Teprica*".

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	-	1,832,894,909	Çelje
Amortizim i vitit	39,772,420	103,787,828	Investime + Dhurime
		0	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	39,772,420	1,936,682,737	Shuma
Shuma		**1,896,910,317**	

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
531	Mjete Monetare në arkë	-	-	-

512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	32,830,430	22,598,025	10,232,405
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-	-
	Totali	**32,830,430**	**22,598,025**	**10,232,405**

Burimi: Bashkia Konispol

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 32,830,430 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 17,974,623 lekë gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 14,855,807 lekë.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 32,830,430 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" 466 "Mjete në ruajtje.
Fondet e papërdorura për vitin 2025 janë si më poshtë:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 12,859,228 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura 5,115,395 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 17,974,623 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:
Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës "*Gjendje inventari qarkullues*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	407,957	407,957	-
32	Inventar i imët	4,420,879	4,420,879	-
33	Prodhim në proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	2,499,152	2,499,152	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve	-	-	-
	Totali	**7,327,988**	**7,327,988**	**-**

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 7,327,988 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 407,957 lekë nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 4,420,879 lekë dhe llogaria 35 "Mallra" në vlerën 2,499,152 lekë.

Llogaria 312 "Materiale" ka vlerën 407,957 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:
Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës lëvizjet e llogarisë 312 "Materiale":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	407,957
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	35,857,184
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	35,857,184
Gjendja në 31.12.2025	**407,957**

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 4,420,879 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 327 "Inventar i imët":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	4,420,879
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	0
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	0
Gjendja në 31.12.2025	**4,420,879**

Burimi: Bashkia Konispol

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.70 datë 31.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të imët të materialeve".*

Komisioni i mësipërm nuk ka kryer procesin e inventarizimit në kundërshtim me urdhrin nr.70, datë 31.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të imët të materialeve",* dhe Urdhrin nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" pika 85 shkronja a,b,c.

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme "&"Të tjera aktive afatshkurtra":

Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të arkëtueshme*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**96,425,292**	**103,045,026**	**(6,619,734)**
411	Klientë e llogari te ngjashme	-	276,684	(276,684)
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	-	-	-
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	57,420,736	52,796,921	4,623,815
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	39,004,556	49,971,421	(10,966,865)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	-	-	
	Totali	-	-	
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-		
	Totali	**96,425,292**	**103,045,026**	**(6,619,734)**

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 52,796,921 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 57,420,736 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje neto me vlerë 4,623,815 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Nga analiza e llogarisë 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF8: Detajet e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2024	Shtesa viti 2025	Pakësim viti 2025	Detyrim datë 31.12.2025
Detyrime Biznesi	52,796,921	4,623,815	-	57,420,736
Shuma	**52,796,921**	**4,623,815**	**-**	**57,420,736**

Burimi: Bashkia Konispol

Në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:
Sektori i Tatimpaguesve me shkresën nr.357, datë 06.03.2026 ka përcjell për kontabilizim debitorët biznes dhe familjar.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 39,004,556 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është kontabilizuar për vlerën 19,347,004 lekë.
Llogaria 7206*"Financim i pritshëm nga buxheti"* është nënvlerësuar për vlerën 19,657,552 lekë e cila është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".
Llogaritë e klasës 4 sipas tabelës së mëposhtë janë kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2025 në vlerën 49,347,935 lekë.

Pasqyra PF9: Llogaritë e klasës 4

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Llogari 401-408	37,697,667	39,208,417
Paga personeli llog 42	7,972,008	7,635,700
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	986,750	550,627
Sigurime shoqërore llog.435	2,361,727	2,260,891
Sigurime shëndetësore llog.436	329,783	315,786
Totali	**49,347,935**	**49,971,421**

Burimi: Bashkia Konispol

Referuar informacionit të tabelës së mësipërm llogaria 4342 *"Operacione me shtetin"* e cila është kontabilizuar për vlerën 39,004,556 lekë sipas udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin:

- Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta):

Kjo është një llogari që në pasqyrat financiare të NJQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.

Sa më sipër llogaritë e klasë 4 të cilat janë kontabilizuar për vlerën 49,347,935 lekë, dhe duhet të kenë si llogari kundërparti llogarinë 4342 *"Operacione me shtetin".* Kjo llogari është nënvlerësuar për vlerën 10,343,379 lekë.

<u>Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)</u>

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 *"Studime dhe Kërkime"*, dhe paraqiten me kosto historike 6,348,801 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë, gjatë vitit 2025 nuk ka pasur shtesa ose pakësime kjo llogari. Kjo llogari paraqitet me tepricë neto në vlerën 240,000 lekë.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,888,893,329 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,824,877,921 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 86,623,175 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 17,164,653 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 39,772,420 lekë.

Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr. Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	24,011,454	2,921,600	-	-	26,933,054
211	Pyje, Kullota, Plantacione	-	-	-	-	-
212	Ndërtime e Konstruksione	340,235,862	659,988	17,011,793	-	323,884,057
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,417,713,126	82,041,597	14,177,131	-	1,485,577,592
214	Instalime dhe paisje	33,341,914	802,200	6,668,383	-	27,475,731
215	Mjete Transporti	6,812,989	15,414,472	1,362,598	-	20,864,863
218	Inventar Ekonomik	2,762,576	1,947,971	552,515	-	4,158,032
	Shuma	**1,825,117,921**	**103,787,828**	**39,772,420**	**-**	**1,889,133,329**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 210 ***"Toka, troje terrene"*** është paraqitur në bilanc në vlerën 24,011,454 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari ka pasur shtesa gjatë vitit në vlerën 2,921,600 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Ky veprim është në kundërshtim me SKK 5(i përditësuar),Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale pikat 8 dhe 11 dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

Nga auditimi i llogarisë 210 *"Toka, Troje, Terrene"* ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me SKK 5(i përditësuar), Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale pikat 8 dhe 11.3

Pasqyra PF11: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 210:

Nr Llog	Emërtimi	Lloji i aktivit	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2025
210	Kend lojrash Konispol	Truall	2,000,000	2,000,000
210	Kosha mbeturinash	Truall	921,600	921,600
Total			**2,921,600**	**2,921,600**

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 212 ***"Ndërtesa dhe konstruksione"***. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 340,235,862 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 323,884,057 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 659,988 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 17,011,793 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Pasqyra PF12: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione":

Nr. Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Varreza Xarrë	659,988	-	659,988

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 213 *"Rrugë,rrjete,vepra ujore"*

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,485,577,592 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* paraqitet në shumën 1,417,713,126 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 82,041,597 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 14,177,131 lekë.

Pasqyra PF13: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore":

Nr Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Rruge te brendshme Konispol	4,086,288	-	4,086,288
2	Rruga Ninat Janjar	15,977,640	-	15,977,640
3	Linja e celikut ne tokat e Markatit	13,000,000	-	13,000,000
4	Perroi i Barcit	3,660,000	-	3,660,000
5	Mbrojtje lumore në tokat e Markatit	20,145,741	-	20,145,741
6	Beton asfaltobeton	21,585,528	-	21,585,528
7	Kanali i Manastirit	3,556,400	-	3,556,400
8	Supervizion mbrojtje lumore	30,000	-	30,000
Total		**82,041,597**	**-**	**82,041,597**

Burimi: Bashkia Konispol

Sa më sipër referuar informacionit në tabelën PF13 janë kontabilizuar për vitin 2025 në llogarinë 213 "Rrugë,rrjete, vepra ujore" 8 (tetë) aktive me kosto historike 82,041,597 lekë.

1-*"Shtresa asfaltike për rrugët e brendshme Konispol*" me vlerë kontrate 4,086,288 lekë me TVSh. Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi në datën 20.06.2025, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në datën 20.06.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor. dhe situacioni përfundimtar në vlerën 4,086,288 lekë.

2-*"Rikonstruksioni i rrugës Ninat-Janhar (loti I)"* me vlerë kontrate 15,977,978 lekë me TVSh. Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është hartuar në datën 23.10.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni përfundimtar në vlerën 15,977,978 lekë.

3- "Ndërtimi i Linjës së celikut për vaditjen e tokave të Markatit" me vlerë kontrate 38,450,113 lekë me TVSh.

Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është hartuar në datën 16.14.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni përfundimtar në vlerën 5,109,975 lekë.

Referuar sa më sipër investimi i mësipërm është kontabilizuar për vlerën 13,000,000 lekë kjo vlerë i përket faturës së likuiduar me nr.4/2026, datë 06.01.2026.

Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit. Vlera e cila duhet të kontabilizohet ky investimi është në shumën 38,450,113 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",*

4-"Ndërhyrje emergjente në përroin e Barcit Shalës" me vlerë kontrate 15,680,832 lekë me TVSh.

Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është hartuar në datën 06.12.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni përfundimtar në vlerën 3,654,132 lekë.
Referuar sa më sipër investimi i mësipërm është kontabilizuar për vlerën 3,660,000 lekë kjo vlerë i përket faturës së likuiduar me nr.4/2026, datë 06.01.2026.
Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit. Vlera e cila duhet të kontabilizohet ky investimi është në shumën 15,680,832 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",*
5- *"Mbrojtje lumore në tokat e Markatit"* me vlerë kontrate 29,974,770 lekë me TVSh.
Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është hartuar në datën 16.07.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni përfundimtar në vlerën 20,466,890 lekë.
Referuar sa më sipër investimi i mësipërm është kontabilizuar për vlerën 20,145,741 lekë
Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit. Vlera e cila duhet të kontabilizohet ky investimi është në shumën 29,974,770 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",*
6- *"Rehabilitim i kanalit vaditës të Manastirit"* me vlerë kontrate 10,237,701 lekë me TVSh.
Për investimin e mësipërm është hartuar akt kolaudimi, certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve është hartuar në datën 31.10.2025 nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe situacioni përfundimtar në vlerën 10,202,636 lekë.
Referuar sa më sipër investimi i mësipërm është kontabilizuar për vlerën 3,556,400 lekë
Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit. Vlera e cila duhet të kontabilizohet ky investimi është në shumën 10,202,636 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",*
- Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" konstatohet se, ndër vite janë transferuar inventarë në vlerën kontabël (kosto historike) 502,851,347 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Konispol (aktualisht pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë) por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Konispol dhe UKK Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 35-36. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Konispol për UKK Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

lekë

Nr.	Ndërtesa e konstruksione (kosto historike) Objekte inventari	Gjendja 31.12.2025
1	Rikonstruksioni i Ujësjellësit Konispol Stacioni Pompa	270,849,049
2	Rikonstruksion Ujësjellësi Markat	11,472,539
3	Rikonstruksioni i Ujësjellësi Ninat	28,032,949
4	Rikonstruksioni i Ujësjellësi Mursi	10,155,319
5	Rikonstruksion Ujësjellësi Fshati Xarrë	58,618,703
6	Ujësjellësi Shkallë	6,435,897
7	Ujësjellësi Vrinë Shëndelli	1,000,000
8	Ujësjellësi Xarrë	6,958,108
9	Ujësjellësi i Shalës	75,569,883
10	Ujësjellës Markat	14,709,600
11	Ujësjellës Dishat	10,021,500
12	Ujësjellës Vërvë	9,027,800
Totali		**502,851,347**

Burimi i të dhënave: Bashkia Konispol.

Llogaria kontabël 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune".* Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë neto kontabël 27,475,731 lekë.

Bashkia gjatë vitit 2024 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 2,000,000 lekë.

Pasqyra PF14: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune":*

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	2,000,000	-	-	-
Total		**2,000,000**	**-**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF15: Detajet e nënrubrikës "*Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune*".

Teprica në fillim				Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
Njësitë Shpenzuese	**K.Historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**	**K.historike**	**Amortizim**	**K.Historike**	**Amortizim**	**K.historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**
Bashkia	49,314,294	15,972,380	33,341,914	2,000,000	6,6868,383	0	0	50,116,494	22,640,763	27,475,731

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

5. Llogaria 215 "Mjete transporti". Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Konispol.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të në datën 31.12.2025, Bashkia disponon 19 mjete me kosto historike 44,735,896 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 23,871,033 lekë dhe me vlerë neto kontabël 20,864,863 lekë.

Gjatë vitit 2025 Bashkisë Konispol i janë dhuruar 3 (tre) mjete.

Pasqyra PF16: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 215 "Mjete Transporti":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	-	14,216,672	-	-
Total		**-**	**14,216,672**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF17: Mjetet e kontabilizuara gjatë 2025:

Nr.	Emërtimi	Viti i regjistrimit	Kosto Historike
1	Zjarrëfikse	2025	2,448,078
2	Ambulancë	2025	7,469,396
3	Fugon ford AB15	2025	4,299,198
Totali			**14,216,672**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF18: Detajet e nënrubrikës "*Mjete Transporti*".

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**	**K.historike**	**Amortizim**	**K.Historike**	**Amortizim**	**K.historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**
29,321,424	22,508,435	6,812,989	15,414,472	1,362,598	-	-	44,735,896	23,871,033	20,864,863

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

6. Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Konispol. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 4,158,032 lekë. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 218 *"Inventari ekonomik"* është shtuar me vlerën 1,395,456 lekë.

Pasqyra PF19: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 218 "Inventar ekonomik":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	999,990	947,981	-	-
Total		**999,990**	**947,981**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF20: Detajet e nënrubrikës "*Inventar ekonomik*".

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**	**K.historike**	**Amortizim**	**K.Historike**	**Amortizim**	**K.historike**	**A.Akumuluar**	**Teprica Neto**
21,025,807	18,263,231	2,762,576	1,947,971	552,515	-	-	22,973,778	18,815,746	4,158,032

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 439,227,051 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej 39,772,420 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.

Në aneksin nr. 2/3/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ.

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Konispol, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%

- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund 2025 në vlerën 449,000 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2025 është paraqitur në vlerën 457,000 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.
-Bashkia Konispol në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 4.49 % të aksioneve të **"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë" sh.a** me **NUIS "M24828802U"** e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve".
Numri i aksioneve është 4,490 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 449,000 lekë.
Vlerat e **"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë" sh.a** sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten në aktivet afatgjata financiare të bilancit kontabël 2025, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"

Investimet:

Gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*"në datën 31.12.2025 paraqitet në vlerën 20,337,060 lekë.
Referuar udhëzimit nr. 5 , datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*".

Pasqyra PF 21: Investimet sipas kontratave të lidhura të cilat janë në proces punimesh.

Nr.	Projekti në proçes	Operatori ekonomik	Vlera e kontratës me TVSh	Vlere likujduar periudhat e meparshme	Vlere e faturuar	Vlera e likuiduar viti 2025	Vlera e Mbetur e Kontratës
1	Rritja e eficences dhe terrene sportive shkolla Konispol	2Z Konstruksion	57,385,458	0	13,137,060	9,993,681	47,391,777
2	Prroi i Barcit	Iliria D	15,681,204	0	10,860,000	3,660,000	12,021,204

Burimi: Bashkia Konispol

Investimi *"Ndërhyrje emergjente në përroin e Barcit"* me vlerë kontrate 15,681,204 lekë me TVSh është përfunduar dhe kolauduar. Ky investim është kontabilizuar në llogarinë 231 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* për vlerën 3,660,000 lekë vlerë kjo e faturuar dhe e paguar, ndërsa për vlerën 7,200,000 lekë sipas situacionit nr.2 dhe faturës nr.137/2025 të papaguar është kontabilizuar në llogarinë 231 "Investime" duke mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 7,200,000 lekë në në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Konispol më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të

muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF22: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të pagueshme*".

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	37,697,667	39,208,417
42	Detyrime ndaj personelit	7,972,008	7,635,700
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	986,750	550,627
435	Sigurime shoqërore	2,361,727	2,260,891
436	Sigurime shëndetsore	329,783	315,786

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2025 është në vlerën 37,697,667 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Konispol sëbashku me njësitë shpenzuese më 31.12.2025.

-Fatura të muaj nëntor dhe dhjetor të cilat nuk ju ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën **7,104,920 lekë** dhe përbëhen nga 30 fatura tatimore.

-Fatura të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën **20,249,368 lekë** dhe përbëhen nga 54 fatura tatimore.

-Fatura të cilat i përkasin granteve të kushtëzuara janë në vlerën **10,343,379 lekë** dhe përbëhen nga 2 fatura tatimore.

Faturat të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor me vlerë 20,249,368 lekë janë të klasifikuara si mëposhtë:

- Mallra dhe Shërbime në vlerën 13,515,545 lekë.
- Energji Elektrike në vlerën 3,732,511 lekë.
- Investime në vlerën 3,001,312 lekë.

Pasqyra PF23: Klasifikimi i detyrimeve të prapambetura sipas periudhës kohore

Nr	Periudha Kohore	Vlera e detyrimit
1	Para vitit 2023	1,086,218
2	Viti 2023	2,058,247
3	Viti 2024	4,544,228
4	Viti 2025	12,560,675
Total		**20,249,368**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Në aneksin nr 2/3/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur lëvizja e llogarisë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to".*

Pasqyra PF24: Detajet e nënrubrikës "*Furnitorë e llogari të lidhura me to", detyrimet e prapambetura me fonde të kushtëzuara.*

Nr.	Operatori Ekonomik	Dt fature	Nr.fature	Shuma e faturës	Likuiduar	Shuma e mbetur
1	Iliria/D	03.11.2025	137/2025	7,200,000	-	7,200,000
2	2Z Konstruksion	24.11.2025	48/2025	13,137,060	9,993,681	3,143,379
Total						**10,343,379**

Burimi: Bashkia Konispol

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Konispol, paraqitet në vlerën 7,972,008 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit

dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2026 ne shumen 7,972,008 lekë.

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 986,750 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne janar 2026.

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 2,361,727 lekë.

Llogaria 436, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 329,783 lekë.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 14,855,807 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Pasqyra PF25: Detajet llogarisë "*Kreditorë për mjete në ruajtje".*

Nr.	Objekti	Viti	Operatori Ekonomik	Gjendja 31.12.2024	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Vlera 31.12.2025
1	Zgjerimi i varrezave Mursi	2022	I./D	204,222	-	-	204,222
2	Linja e celikut Markat	2024	M./S	450,000	650,000	-	1,100,000
3	Mbrojtja lumore ne tokat e Markatit	2024	Il./D	475,394	1,007,287	-	1,482,681
4	Kanali I Manastirit	2024	M./S	332,311	177,820	-	510,131
5	Rruga hyrese Shales	2024	K.	328,986	-	-	328,986
6	Rruga hyrese Markat	2024	**J. C.**	361,036	-	-	361,036
7	Perroi I Barcit	2025	I./D	-	183,000	-	183,000
8	Shkolla Bido Sejko	2025	2. K.	-	499,684	-	499,684
9	Rruga Ninat Janjar	2025	M./S	-	798,882	-	798,882
Total				**2,151,949**	**3,316,673**	**-**	**5,468,622**

Burimi: Bashkia Konispol

Për vlerën në shumën 9,387,185 lekë, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion analitik dhe rakordim me Degën e Thesarit Sarandë.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30:"*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet*",

Pika 50: "*Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)*".

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: "*Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe*

zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve."

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 315,927,367 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 13,671,773 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 9,683,134 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 3,887,193 lekë.
Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 21,539,265 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 1,560,762 lekë, e cila përfshin, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 19,978,503 lekë, e cila përfshin etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 266,464,514 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 118,256,215 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 118,256,215 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 18,983,136 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 18,983,136 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 84,206,611 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 84,206,611 lekë.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***604 "Transferime korente të brendshme"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 1,928,721 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 1,928,721 lekë.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 43,089,831 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 43,089,831 lekë.

Për vitin 2025 totali i te ardhurave ne vlere është 315,927,367 lekë dhe totali shpenzimeve është 266,464,514 lekë.

Në aneksin nr. 2/3/3 në anekset e projekt raportit të auditimit paraqitet analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 *"Pasqyra e performancën financiare"* të PF të vitit 2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. O. E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 322/7 prot. datë 20.10.2025 i ka dërguar Bashkisë Konispol, "Raportin përfundimtar", për përmirësimin e gjendjes, si dhe ka rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Konispol *ka respektuar* këtë afat, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.1543/1 prot., datë 14.11.2025, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
Nga Bashkia Konispol nuk rezultoi të jetë dërguar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të KLSH-së, për afatin 6-mujor, sepse pika e zbatimit të rekomandimeve është pjesë e programit të auditimit financiar me nr.382/1, datë 09.04.2026. Bashkia Konispol është njoftuar për kryerjen e programit të auditiimit financiar përpara afatit të plotësimit të 6 mujorit.
Raporti Përfundimtar i Auditimit si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, është protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë Konispol, me nr. 322/7 prot., datë 20.10.2025, në përputhje me nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

III. Rekomandimet e KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 322/7 prot., datë 20.10.2025, janë rekomanduar gjithsej:
a. Janë rekomanduar **44 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,325,000 lekë;**
c. Janë rekomanduar **5 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;**
d. Janë rekomanduar **1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet;**
e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Konispol që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 13 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 322/7 Prot., datë 20.10.2025, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Konispol)	Pa pranuar
1	Organizative	44 masa	44 masa	-
2	Shpërblim dëmi	4 masa	4 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	5 masa	5 masa	-
4	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	1 masë	1 masë	
5	Masa Disiplinore	13 masa	13 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	44 masa	4 masa	1 masë	6 masë	33 masa
2	Shpërblim dëmi	4 masa	-	4 masa	-	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	5 masa	-		5 masa	
4	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	1 masë	-	-	1 masë	-
5	Masa Disiplinore	13 masa	-	-	-	13 masë

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **44 (dyzet e katër)** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 4 (katër) janë zbatuar, 6 (gjashtë) janë në proces zbatimi, 1 (një) është zbatuar pjesërisht, 33 (tridhjetë e tre) pa zbatuar nga të cilat 12 janë rikërkuar në auditimin aktual dhe 18 janë masa organizative të cilat do të auditohen kur të kryhet auditim përputhshmërie në Bashkinë Konispol.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë **4 (katër) rekomandime** për 4 subjekte në vlerën 1,325,600 lekë dhe janë pranuar plotësisht, të cilat janë zbatuar pjesërisht.

-Për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike është lënë 1 **(një) rekomandime** i cili është në proces.

-Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë lënë **5 (pesë) rekomandime** të cilat janë në process zbatimi.

-Për masa disiplinore janë lënë **13(trembëdhjetë) rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 13 nuk janë zbatuar.

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Konispol, u konstatua se komponentët e MFK-së, janë të implementuar në shkallë të ulët nga njësia, konkretisht:

-Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Konispol, rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe përgjegjësitë, sipas strukturave organizative të miratuara.
-Nuk janë hartuar dhe miratuar politika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit;
-Strukturat e bashkisë nuk raportojnë periodikisht, në mënyrë sistematike, risqet e identifikuara dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve, për rrjedhojë bashkia gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit, nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare apo realizimin e objektivave në nivelin e dëshiruar.
- Për periudhën objekt auditimi nuk ka urdhër/përditësim të GMS-së, vendime për ngritje/përditësim të EMP-së dhe nuk disponohen procesverbale për takimet e GMS-së.
Mungesa e funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, ka sjellë mangësi lidhur me hartimin dhe miratimin e planit të zhvillimi strategjik me afat jo më pak se 5 vjet, planeve dhe raporteve vjetore, mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT,
- Dosjet e personelit kanë mangësi në plotësinë me dokumentacion mbështetës, si dhe mungojnë vlerësimet e punës për punonjësit e bashkisë. Gjithashtu për vitin 2024 nuk janë hartuar dhe nënshkruar sipas hierarkisë "Përshkrimet e punës" për të gjithë punonjësit e Bashkisë Konispol, ndërsa rekrutimet në punë, bëhen me urdhër të Titullarit dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, sipas kërkesave të shërbimit civil.
-Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta dhe për pasojë aktivitetet e kontrollit janë të pamjaftueshme
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 8 pika 8/b, neni 11 pika 2, neni 16, neni 20, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27, me Udhëzimin nr.16 datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*", pika 5.2.7, me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 108/2016, Kapitulli III, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm dhe Integrimit Europian, të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të koordinatorit të MFK-së dhe koordinatorit të riskut, si dhe njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës. Gjithashtu të përditësojë Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit të proceseve dhe aktivitetit të strukturave përkatëse të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pikës 1 *"Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar dhe publik"* të programit nr.382/1 prot, datë 09.04.2026 u konstatua se nuk është hartuar gjurma e auditimit, Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me urdhrin nr.2, datë 05.01.2025.

Statusi: Në process zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol nuk ka parashikuar në strukturën organizative shërbimin e Auditit të Brendshëm, si dhe nuk kanë marrë asnjë masë dhe nuk ka bërë asnjë marrëveshje me bashki të tjera, për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në Bashkinë Konispol. Veprime në mospërputhje me nenin 10, nenin 12/a të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" të ndryshuar dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik*" të ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me një nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, për të bërë të mundur auditimin e strukturave të vlerësuara me risk të lartë.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i strukturës së miratuar me urdhër nr.01, datë 06.01.2025 *"Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Konispol për vitin 2025"* u konstatua se në këtë strukturë të miratuar nuk është parashikuar auditi i brendshëm. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA-së për vitet 2024-2026, u konstatua se:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave, i cili miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2023.
2. Nuk janë hartuar tavanet përgatitore të PBA-së 2024-2026 për çdo program, i cili miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 15 mars.
3. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të Tavaneve Përgatitore të PBA 2024-2026 për çdo program, nga Titullari i institucionit nuk është miratuar Udhëzimi i Brendshëm për PBA-së dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit *(DEMP).*
4. Nga drejtuesit e EMP-së nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit prill 2023.
5. Nga Drejtoritë e Bashkisë Konispol nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.
6. Nga Kryetari i Bashkisë Konispol nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2023, pranë MFE-së, Projekti dokumenti i PBA-së 2024-2026 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
7. Nga Kryetari i Bashkisë Konsipol nuk është paraqitur deri më datë 31 janar për miratim në Këshill raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

a) dy vitet para vitit buxhetor;
b) vitin buxhetor;
c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

Veprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 5, gërma "ç", neni 34, pika 1, pika 6, Udhëzimin e MFE-së nr. 6, datë 28.02.2023, "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendore 2024-2026*", Kapitulli I dhe Udhëzimin i MFE-së nr. 23, datë 22.11.2016, "*Për proçedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*" pika 6, 10, 29, 33-34, dhe pika 40, gërmat "a-h". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1-2.2.5, faqe 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të marren masa për realizimin e të gjithë fazave dhe respektimin e afateve për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i hartimit të PBA 2025-2027 për Bashkinë Konispol u konstatua se:

-Bashkia Konispol nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak ***"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"*** .

-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 02 datë 05/01/2025.

-**Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak

-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2025-2027 nuk janë paraqitur në Këshillin Bashkiak.

-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.

- PBA 2025-2027 **faza e parë** nuk është dërguar në MF.

Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë.

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 nuk janë miratuar me VKB.

-Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Rekomandimi i mësipërm do të kërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është në vlerën 216,830,000 lekë, i miratuar me VKB-në nr. 36, datë 29.12.2023, *"Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 të Bashkisë Konispol"*, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë me shkresën nr. 44/1 prot., datë 15.01.2024, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 41.

Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në relacionin e datës 26.12.2023, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Ky dokumentacion është dërguar pranë KB-së jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 41, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.2.1-2.2.5, faqe 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të merren masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetitn vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Buxheti i vitit 2025 të Bashkisë Konispol është miratuar me VKB nr.52, datë 23.12.2024 brenda afateve ligjore.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2024 u konstatua diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në

llogaritë e mësipërme janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor.
Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.
Për vitin 2024 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 312,862 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 278,475 mijë lekë në masën 89%, ose me një mosrelizim në vlerën 34,387 mijë lekë, që përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 53,485 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 83,199 mijë lekë, nga tranferta e kushtëzuar specifike në vlerën 112,923 lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 3,395 lekë, nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 25,477 mijë lekë.
- Artikulli 600 "Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli" është planifikuar në vlerën 94,242 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 91,121 mijë lekë ose në masën 96.7% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 17,462 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 45,489 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 25,275 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 2,895 mijë lekë. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë e vendeve vakant në strukturë si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë.
- Artikulli 601 "Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" është planifikuar në vlerën 15,928 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 15,906 mijë lekë ose në masën 99.9% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 3,403 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 7,261 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 4,757 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 485 mijë lekë.
- Artikulli 602 "Mallra dhe shërbime të tjera", Fondi Rezervë është planifikuar në vlerën 62,682 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 60,826 mijë lekë ose në masën 97% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 13,323 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar në vlerën 27,875 mijë lekë + nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 19,628 mijë lekë.
- Artikulli 604 "Transferime korrente të brendshme" është planifikuar në vlerën 9,927 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,859 mijë lekë ose në masën 18.7% nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 1,859 mijë lekë.
- Artikulli 606 "Transferime për buxhete familjare dhe individë" është planifikuar në vlerën 52,790 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 47,993 mijë lekë ose në masën 90.9% e përbërë nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 47,978 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 15 mijë lekë.
- Artikulli 230-231 "Investime" është planifikuar në vlerën 77,923 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 60,774 mijë lekë ose në masën 77.9% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 19,297 mijë lekë + nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 2,574 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 13,426 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 25,477 mijë lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 9 pika 1.3 gërma *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të*

vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"* dhe VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.2.1-2.2.5, faqe 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të institucionit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i realizimit të buxhetit të vitit 2025 u konstatua se totali i buxhetit i ndryshuar është në vlerën 283,700 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 254,194 mijë lekë. Llogaria e cila ka ndikimin më të ulët në realizmin e buxheti është llogaria 231 "Investime" e cila është planifikuar në vlerën 60,332 lekë dhe realizuar në vlerën 46,227 mijë lekë. Rekomandimi i mësipërm do të ri kërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të dërguara nga Bashkia Konsipol pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura u konstatua se, detyrimi në fillim viti i mbartur nga viti 2023 është në vlerën 25,040,153 lekë si rrjedhojë e detyrimeve të prapambetura, detyrimi i krijuar për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, është në vlerën 13,825,713 lekë ndërsa gjendja e detyrimeve më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 38,865,866 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë marrë masa për të mbuluar më parë detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe më pas fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 153-162, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 52, UMF nr. 5, datë 27.12.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"*, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.2.1-2.2.5, faqe 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Konispol të cilat janë paraqitur në Ministrinë e Financave me shkresën nr.286 prot, datë 23.02.2026 janë në vlerën 20,249,368 lekë. Referuar detyrimeve të prapambetura të datës 31.12.2024 të cilat kanë qënë në vlerën 38,865,866 lekë kemi ulje të detyrimeve të prapambetura me 52%.Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve çdo fillim viti krijon një regjistër

të ri elektronik në format Excel për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Nga auditimi i procesit të mbajtjes së taksave dhe tarifa vendore janë konstatuar problematikat si më poshtë:
- SSHT-ja për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit elektronik të ri vjetor.
- Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit.
- Auditimi i "Regjistrin Elektronik" për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky regjistër administron të dhëna për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", në nivel lokal.
- SSHT-ja nuk ka një rregullore të brendshme të miratuar apo përshkrim të proceseve të punës së personelit që operon në "Regjistrin elektronik", ku të përcaktohen detyrat, përgjegjësitë sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën organizative të miratuar. Bashkia Konispol organizimin e veprimtarisë së SSHT-së e bën duke u mbështetur vetëm në "Regjistrin Elektronik" (veçmas për çdo njësi administrative).
- Struktura e kategorizimit të regjistrit për bizneset dhe popullatën është e ndërtuar bazuar në paketën fiskale të miratuar. SSHT-ja çdo fillim viti krijon një regjistër të ri për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në SSHT dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues.
- Nuk administron një regjistër për të gjitha taksat/tarifat vendore sipas strukturës së paketës fiskale dhe për gjithë territorin që ka nën administrim qoftë dhe në formatin Excel për të parandaluar për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikime të paautorizuara të të dhënave.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të ndryshimeve sipas natyrës së veprimit).
- Nuk administrohen në dosjet e subjekteve procesv-verbale sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat/pagesat e detyrimeve mbi taksat dhe tarifat vendore (Credit Note).
- Nuk ka bashkëveprim me burimet njerëzore për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë punësuar rishtaz, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave përsonale për regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim.
- Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit.
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore, për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për manaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron (Sipas strukturës së Paketës Fiskale).

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "*Për bazat e të dhënave shtetërore*" nenin 3, Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "*Për sigurinë kibernetike*" neni 4, Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "*Për bazat e të dhënave shtetërore*" Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave, Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" të ndryshuar" nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27,28, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "*Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit*

Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për ndërtimin dhe zbatimin e një programi të plotë të sigurisë së informacionit, duke përfshirë të gjithë elementët përbërës të tij, si: krijimi i një mjedisi të sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, hartimi i politikave të sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pikës 2 të programit të auditimit me nr.382/1 prot, datë 09.04.2026 u konstatua se Bashkia Konsipol nuk disponon një sistem për regjistrimin, administrimin dhe kontabilizimin e abonentëve familjar dhe biznes për taksat dhe tarifat lokale. Referuar rekomandimit të mësipërm Bashkia Konispol nuk ka ndërmarrë asnjë masë për përmirësimin e situatës. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 68,067,000 lekë dhe realizimi në vlerën 35,130,000 lekë ose në masën 51.6% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 32,937,000 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pika 1, 2 dhe 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" Kreu IV, pika 200. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

8.2. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i realizimit dhe parashikimit të të ardhurave për vitin 2025 u konstatua së parashikimi është në vlerën 63,026 mijë lekë dhe realizmi është në vlerën 63,475 mijë lekë ose në masën 101 %.

Të ardhurat e prapambetura nuk janë planifikuar më vetë si zë në planifikimin e të ardhurave por janë përfshirë të zëri i të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë vendore.

Statusi: Në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Konispol për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, është miratuar me Vendimin nr. 24, datë 30.11.2023, të Këshillit Bashkiak. Në këtë dokument nuk janë përcaktuar afatet për pagesën e të gjitha taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës duhet të jetë pjesë integrale e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Nga SSHT-ja shpjegohet se këto afate përcaktohen me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, gjë që tregon se afati i përcaktimit të pagesës së detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore mbetet të përcaktohet nga ky sektor dhe jo nga Këshilli Bashkiak. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 5, gërma *"c". (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa që, gjatë hartimit të paketës fiskale të përfshijë afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar, duke garantuar mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar, me qëllim sigurimin e financimit të shpenzimeve të miratuara në planin vjetor të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Paketa fiskale e Bashkisë Konispol është miratuar me VKB nr.43, datë 27.11.2025 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë me nr.1102/1, datë 20.12.2024. Në këtë paketë fiskale nuk janë përcaktuar afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (ASHK Sarandë për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugorë Sarandë) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Konispol dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Sarandë, duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor. Bashkia Konispol ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitin 2024 me agjentin tatimorë ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 26, datë 04.09.2008, "*Për taksat kombëtare*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në Bashkinë Konispol të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat, apo taksat e të cilëve mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të

evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 117.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit 10.1: Nga auditimi i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në Bashkinë Konispol u konstatua së nuk është ndërmarrë asnjë masë për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet të cilat arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

Qëndrimi i grupit të auditimit 10.2: Referuar rekomandimit të mësipërm nuk është ndërmarrë asnjë masë për zbatimin e tij.

Statusi: Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçensuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB u konstatua se, përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Konispol kanë ushtruar në total 3 subjekte me aktivitet tregtim me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj. Nga totali prej 3 subjekte, 2 subjekte janë të pajisura me autorizim për tregtimin e hidrokarburave dhe derivative të tyre dhe 1 subjekt nuk është i pajisur me autorizim. Në lidhje me këtë situatë me shkresën me nr. Extra prot., datë 05.06.2020, Bashkia Konispol është drejtuar subjektit **"I" ShPK** me njoftim për pajisjen me liçensë për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, ku i bën me dije këtij të fundit që afati i autorizimit ka përfunduar dhe detyrimi për përsëritjen e liçensës është 1,000,000 lekë. Me shkresën nr. 322 prot., datë 18.03.2025, Bashkia Konispol i ka rikujtuar subjektit **"I" ShPK** detyrimin ligjor për pajisjen me liçensë.

Për më tepër në lidhje me problematikën e sipërpërmendur, nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e ISHTI-it për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", VKM-në nr. 170, datë 25.04.2002, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*" i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektioriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/liçencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit : Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri sepse Bashkia Konispol nuk ka ndërmarrë asnjë masë për paisjen me autorizim ose bllokimin e aktivitetit të subjekteve të cilët veprojnë në fushën e hidrokarbureve pa autorizim.

Statusi: Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Konispol nr. 72, datë 12.12.2024, "*Për ngritjen e komisioneve që do të bëjnë inventarizimin vjetor të vlerave materiale të pasurisë së Bashkisë Konispol*", me përbërje nga tre punonjës. Nga auditimi i procedurave të inventarizimit nuk u paraqitën dokumente për kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, hartimi i pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.70 datë 31.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të imët të materialeve".*

Komisioni i mësipërm nuk ka kryer procesin e inventarizimit në kundërshtim me urdhrin nr.70, datë 31.12.2025 *"Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme inventarit të imët të materialeve",* dhe Urdhrin nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" pika 85 shkronja a,b,c. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për pasqyrat financiare të vititi 2024, rezultoi:

1. Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 7,327,988 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 407,957 lekë, 32 "Inventar i imët" në vlerën 4,420,879 lekë dhe 35 "Mallra" në vlerën 2,499,152 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,499,152 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" e cila paraqitet në vlerën 2,499,152 lekë. Vlen të theksohet se Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka marrë masat e nevojshme për sistemimin e vlerës prej 25,194,903 lekë, që i përket blerjeve të mallrave gjatë vitit 2023. Këto blerje janë regjistruar si hyrje në magazinë përmes fletë-hyrjeve përkatëse, por nuk është kryer kontabilizimi i tyre në gjendjen e llogarisë së Klasës 3 "Gjendje e inventarit qarkullues". Kjo problematikë është konstatuar në auditimin e mëparshëm të ushtruar nga KLSH, por ende nuk është kryer kontabilizimi në pasqyrat financiare të vitit 2024.

2. Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" dhe llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", shtesë e kryer për vitin 2024 është në vlerën 63,272,910 lekë (60,773,758 lekë + 2,499,152 lekë), ndërkohë që referuar ditarit të bankës konkretisht shpenzimeve të kryera me pagesë për mallra, shërbimeve dhe investimeve janë në

vlerën 69,578,233 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në pasqyrat financiare në vlerën 6,305,323 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 3.8.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llogaritë e klasës 3 të Aktivit me qëllim paraqitjen e një pamje reale dhe raportimin e saktë të kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 7,327,988 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 407,957 lekë nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 4,420,879 lekë dhe llogaria 35 "Mallra" në vlerën 2,499,152 lekë.

Llogaria 312 "Materiale" ka vlerën 407,957 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF: Detajet e nënrubrikës lëvizjet e llogarisë 312 "Materiale":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	407,957
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	35,857,184
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	35,857,184
Gjendja në 31.12.2025	**407,957**

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 4,420,879 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 327 "Inventar i imët":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	4,420,879
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	0
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	0
Gjendja në 31.12.2025	**4,420,879**

Statusi: Zbatuar Plotësisht

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 40,099,995 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 52,796,921 lekë me një rritje në vlerën 12,482,949 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë të përfshirë debitorët nga dhënia me qira e sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për vendosjen e antenave telefonike në vlerën 2,250,000 lekë, sipas kërkesës për likuidim me shkresën nr. 243 prot., datë 28.02.2023, drejtuar OE "V" Sh.a. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën e datës 08.01.2025, që Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 52,796,921 lekë pa përfshirë detyrimin në vlerën 2,250,000 lekë nga qiradhënia e aseteve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 5 dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 14.1 për analizimin, rakordimin dhe saktësimin e vlerës së detyrimeve të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe arkëtimin e tyre rezulton se, ky rekomandim është pranuar. Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të bashkisë të vitit 2024 rezulton se, tek llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 52,796,921 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 57,420,736 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje neto me vlerë 4,623,815 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët.
Në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:
Drejtoria e Taksave me shkresën nr.357, datë 06.03.2026 ka përcjell për kontabilizim debitorët biznes dhe familjar.
Kontabilizimi i llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" ka si kundërparti llogarinë 4341 "Operacione me shtetin" në vlerën 57,420,736 lekë.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vititi 2024, rezultoi se, llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2023 dhe vitit 2024 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, llogaria 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këto vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu nuk janë përfshirë në llogari vlera e aseteve: toka, troje dhe terreneve që janë transferuar me VKM përkatëse, Bashkisë Konispol dhe ish-Komunave sot Njësitë Administrative "Xarrë" dhe "Markat". Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Kreu II, pika 5, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe 211 "Pyje, Plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra ndër vite, për të saktësuar dhe analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar rekomandimit 15.1, Bashkia Konispol nuk ka ngritur komision me specialistë të fushës për vlerësimin e aktiveve në llogaritë 210 "Toka, Troje, Terrene"

dhe 211 “Pyje, Plantacione”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për pasqyrat financiare, rezultoi se, Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,696,277,830 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 50,375,739 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 171,375,966 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,417,713,126 lekë. Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, ndër vite janë transferuar inventarë në vlerën kontabël (kosto historike) 502,851,347 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Konispol (aktualisht pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë) por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Konispol dhe UKK Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vlerën kontabël 502,851,347 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar rekomandimit 16.1, Bashkia Konispol nuk ka ndërmarrë asnjë masë për transferimin e aseteve të cilat duhet të transferohen tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për pasqyrat financiare rezultoi se, Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 26,598,247 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 8,073,579 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 15,972,380 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 33,341,914 lekë. Referuar të dhënave analitike përbërëse të llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” u konstatua se, në këtë llogari është përfshirë zëri “Blerje skrep bujqësi (Volvo)” në vlerën kontabël (kosto historike) në vlerën 16,347,131 lekë, e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 215 “Mjete transporti”, në zbatim të përcaktimeve në Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi 2, Artikulli 21, Llogaria 215 “Mjete transporti”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Bashkinë Konispol, të marrë masa për sistemimin e vlerës 16,347,131 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” duke i kontabilizuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar rekomandimit 17.1, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në në Bashkinë Konispol nuk ka kryer transferimin e aktivit "Blerje skrep bujqësi (Volvo)" nga llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në llogarinë 215 "Mjete transporti".

Statusi: Pa zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi vjetor në vlerën 690,644 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Amortizimi për këtë llogari nuk paraqitet i saktë për arsye se është kryer në total për vlerën e çeljes së gjendjes së llogarisë më datë 01.01.2023, duke marrë në konsideratë faktin që kjo llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime përgjatë vitit 2023, ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%.

Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 240,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 240,000 lekë. Nga auditimi u konstatua se, për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime" nuk është përllogaritur normë amortizimi. Amortizimi i akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë i përket gjendjes së mbylljes së datës 31.12.2023, dhe jo asaj të vitit ushtrimor 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimim e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar pika 2, klasa 2, gërma "d", pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol, të marrë masa lidhur me gjendjen e llogarisë 218 "Inventar ekonomik", për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv. Si dhe të aplikojë normë amortizimi për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime", duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol nuk ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime"

Statusi: Pa zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogaria 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën 23,896,411 lekë, që i përkasin llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" objekti (Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit" në vlerën 10,237,701 lekë; Mbrojtje lumore ne tokat e "Markatit" në vlerën 29,976,912 lekë dhe Ndërtim i linjes së çelikut për vaditjen e tokave të "Markatit" në vlerën 38,462,997 lekë). Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 23,896,411 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*",

i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol, të marrë masa që për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar për vlerën 7,200,000 lekë në në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*
Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Konispol në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 11,503,134 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për sa trajtuar më sipër nga vlera totale e trashëguar prej 14,724,479 lekë është likuiduar vlera prej 5,446,094 lekë, si dhe kanë mbetur fonde të ngurtësuar në vlerën 9,278,385 lekë. Për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Konispol janë ngurtësuar fonde në vlerën 9,278,385 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Sarandë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 9,278,385 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2025 llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në vlerën 14,855,807 lekë. Shtesat e llogarisë gjatë periudhës 2024-2025 janë në vlerën 5,468,622 lekë.
Për vlerën në shumën 9,387,185 lekë, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion analitik dhe rakordim me Degën e Thesarit Sarandë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" më datë 01.01.2024, është në vlerën 40,099,995 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën

53,073,605 lekë me një rritje në vlerën 12,973,610 lekë. Në këtë llogari janë kontabilzuar si kundraparti debitorët nga taksat dhe tarifat vendore, ndërkohë që kundraparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" është llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë". Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërparti llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol të marrë masa për sistemimin e vlerës 53,073,605 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" duke i kontabilizuar në llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" e cila shërben si kundërparti e 468 "Kreditorë të ndryshëm".

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar për vitin 2025 rezulton se llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" është kontabilizuar për vlerën 57,420,736 lekë, llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" është kontabilizuar për vlerën 0 lekë dhe llogaria 468 "Kreditorë të ndryshëm" është kontabilizuar për vlerën 57,420,736 lekë. Sa më sipër nuk është zbatuar rekomandimi.

Statusi: Pa zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,804,505,735 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 60,773,758 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 2,499,152 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 35,332,735 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 448,999 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar" me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar për vitin 2025 rezulton situata si mëposhtë.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	-	1,832,894,909	Çelje
Amortizim i vitit	39,772,420	103,787,828	Investime + Dhurime
		0	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	39,772,420	1,936,682,737	Shuma

Shuma		**1,896,910,317**	

Llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

Statusi: Zbatuar plotësisht

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë janë konstatuar parregullsitë e mëposhtme:

1. Në 51 (pesëdhjetë e një) raste, janë kryer likujdime në vlerën totale prej 26,655,138 lekë për punë publike dhe shërbime, të cilat përbëjnë shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik duke i përjashtuar këto procedura. Për më tepër procesi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit ka mbetur në fazën e nxjerrjes së urdhrin e prokurimit dhe marrjes së tre ofertave për përllogaritjen e fondit limit por nuk janë ndjekur proceset për zhvillimin në Sistemin e Prokurimit Publik të APP-së. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, "*Për artin dhe Kulturën*", neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

2. Në 2 (dy) raste janë kryer likujdime në vlerën totale prej 1,340,000 lekë për punë publike për të cilat nuk disponohet dokumentacioni justifikues mbi vërtetësinë e realizimit të punimeve konkretisht, kontrata ndërmjet palëve, situacioni i punimeve, libreza masash dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve. Dokumentacioni i cili ndodhet bashkëlidhur pjesë e praktikës së bankës për rastet e trajtuara, është urdhër prokurimi, procesverbal mbi përllogaritjen e fondit limit, fatura tatimore dhe urdhër shpenzimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreun II, pika 8, nënpikat 8.1, 8.2, dhe 8.4, Kreun II, pika 4, nënpikat 4.1, 4.2 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, pika 3, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Nga Strukturat drejtuese të Bashkisë Konispol të analizohet vlera prej 26,655,138 lekë që i përket shpenzimeve për punë publike dhe shërbime për të cilat janë shmangur rregullat e prokurimit publik, duke mos i prokuruar ato. Të nxirren shkaqet dhe përgjegjësit përkatëse për mos përfshirjen në regjistrin e prokurimeve si shpenzimeve, me qëllim mos përësitjen e rasteve të tilla në të ardhmen. Të kërkohet informacion në Degën e Thesarit Sarandë mbi mënyrën se si janë aprovuar fondet për realizimin e këtyre shpenzimeve për të cilat nuk janë realizuar procedura prokurimi. Për rastet që nuk disponohet dokumentacioni justifikues për realizimin e punëve publike, të ngrihet një grup pune për verifikimin dhe dokumentimin në qoftë se këto punimeve janë realizuar, në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndëmjet udhër shpenzimit dhe gjendjes faktike, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2025 janë audituar disa urdhër shpenzime për investimet.

-USH nr.106, datë 22.04.2025 me vlerë 11,614,080 lekë, faturë tatimore me nr.483, datë 16.04.2025 me vlerë fature 11,614,080 lekë, situacion punimesh nr.3 dhe kontratë me nr.872, datë 11.06.2024.
-USH nr.261, datë 17.11.2025 me vlerë 4,597,248 lekë, faturë tatimore me nr.1549, datë 03.11.2025 me vlerë fature 4,597,245 lekë, situacion punimesh përfundimtar dhe kontratë me nr.872, datë 11.06.2024.
-USH nr.278, datë 03.12.2025 me vlerë 9,493,997 lekë, faturë tatimore me nr.48, datë 24.11.2025 me vlerë fature 13,137,060 lekë, situacion punimesh nr.1 me vlerë 13,137,060 lekë dhe kontratë me nr.1119 prot, datë 15.08.2025.
-USH nr.147, datë 17.06.2025 me vlerë 12,350,000 lekë, faturë tatimore me nr.3, datë 05.04.2025 me vlerë fature 24,268,139 lekë, situacion punimesh nr.2 me vlerë 24,268,139 lekë dhe kontratë me nr.1412 prot, datë 07.11.2024.
-USH nr.263, datë 20.11.2025 me vlerë 15,178,758 lekë, faturë tatimore me nr.12, datë 31.10.2025 me vlerë fature 15,977,640 lekë, situacion punimesh përfundimtar me vlerë 15,977,640 lekë dhe kontratë me nr.734 prot, datë 30.05.2025.
-USH nr.213, datë 17.09.2025 me vlerë 19,443,546 lekë, faturë tatimore me nr.109, datë 06.08.2025 me vlerë fature 20,466,890 lekë, situacion punimesh përfundimtar me vlerë 20,466,890 lekë dhe kontratë me nr.1366 prot, datë 30.10.2024.

Statusi: Zbatuar plotësisht

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 6 raste u konstatuan mangësi lidhur me përcaktimin e kritereve të kualifikimit, konkretisht:
- Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 22024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2023, me fond limit 16,548,754 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2023.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant (Diezel) (Për nevoja të Bashkisë Konispol)" zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
Rezultoi se këto procedura prokurimi janë kryer me parregullsi**,** duke mos argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht:
- Aplikimi në mënyrë të gabuar i kufirit të vlerës, për paraqitjen e vërtetimit të lëshuar nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet e fundit, problematkë e konstatuar në të gjitha rastet;
- Aplikimi në mënyrë të gabuar i kufirit të vlerës, për punë të ngjashme, që duhet të paraqesë OE, problematkë e konstatuar në të gjitha rastet;
- Në 4 raste aplikimi i kritereve "Kapaciteti teknik"(kategoritë e licencave, stafi teknik, mjek i përgjithshëm), të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve;
- Mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar, si dhe vendosja si kriter e distancave, në të gjitha rastet;

Veprime këto në kundërshtim me nenin 2, nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", me nenin 2, nenin 39, pika 4, pika 5 neni 43 dhe nenin 78, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

24.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 24.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të auditimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 5 raste u konstatuan mangësi lidhur me vlerësimin e ofertave dhe kualifikimin e OE, konkretisht:

- Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 22024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" viti 2023, me fond limit 16,548,754 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2023.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant (Diezel) (Për nevoja të Bashkisë Konispol)" zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.

Rezultoi se në këto procedura prokurimi, KVO ka shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kritereve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit.

Veprime këto në mospërputhje me kërkesat e nenit 92 pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe me pikën 2 neni 82, të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e mangësive të konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe përgjegjësitë në zhvillimin e këtij procesi. Gjithashtu KVO të marrë masa, që të shmangen parregullsi të tilla, për të përmbushur realizimin e këtij procesi në mënyrë objektive dhe transparente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 25.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për

parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurave të prokurimit dhe dosjeve të zbatimit të punimeve për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2024, rezultoi se dokumentet gjendje në dosjet fizike nuk janë të numëruara, të inventarizuara, nuk ka dorëzues dhe marrës në dorëzim dhe arkivimin e tyre në përfundim të procesit. Veprime në kundërshtim nenin 36, Kreun V të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Strukturat dhe personat përgjegjës në Bashkinë Konispol, të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të dokumentacionit pjesë e dosjeve dhe arkivimin e dosjeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse, duke nënshkruar dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Për të shmangur risqet e tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, dokumentacioni duhet të administrohet, sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 26.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, për *"Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024 dhe "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2023,* rezultoi se se procedurat e prokurimit, janë kryer me parregullsi, pasi:

- Procesi i përcaktimit të nevojave për materiale ndërtimi: beton, asfaltobeton, etj, nuk mbështetet në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar, lidhur me nevojat për ndërhyrje për rikonstruksion të rrugëve brenda territorit të bashkisë. Nuk janë përcaktuar rrugët më problematike, që kërkojnë ndërhyrje për riparimin e tyre, si dhe nuk janë përcaktuar elmentët e rrugëve bazuar në përmasa, për të cilat kërkohet ndërhyrje. Për rrjedhojë volumet e përcaktuara në preventiv, nuk janë të argumentuara teknikisht
- Specifikimet teknike nuk janë të plota, kryesisht përshkruhen për disa artikuj, ndërsa disa nga artikujt nuk përfshihen fare në specifikimet teknike(zgara metalike), duke mos përshkruar kërkesat që duhet të plotësojnë nga ana cilësore.
- Lidhur me zbatimin e kontratës së vitit 2023, u konstatua se në dosjen e prokurimit nuk dokumentohet mënyra e kërkesës nga ana e AK drejtuar kontraktuesit (OE i shpallur fitues) për këtë procedurë prokurimi, për furnizimin me mallra objekt i kësaj marrëveshje kuadër. Përsa i përket kryerjes së mirëmbajtjes së përgjithshme të rrugëve rurale, punimet e kryera janë pasqyruar në skica(planimetritë e rrugëve), sipas sipërfaqeve përkatëse, por mungon dokumentacioni i plotë(librezë masash, procesverbale të punimeve të maskuara, etj). Mungon mbikëqyrja e gjithë procesit nga momenti marrjes në dorëzim të materialeve, deri në kryerjen e punimeve të ndërtimit me materialet e furnizuara.

Veprime këto në mospërputhje me nenin 1.2 të Draftit të marrëveshjes kuadër me nr. prot., datë 23.02.2022 dhe Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" neni 52, pika 5, i ndryshuar dhe VKM

nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 2, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet dhe të marrë masa konkrete, për të përmirësuar procesin e përcaktimit të nevojave për materiale mirëmbajtje dhe ndërtimi, proces i cili duhet të mbështetet në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar. Gjithashtu nga personat përgjegjës të caktuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrë masa për dokumentimin e gjithë procesit, në të gjitha fazat e zbatimit të kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 27.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave lidhur me zbatimin e kontratës për furnizimin me gazoil për vitin 2024, rezultoi se nga grupi i punës është mbajtur procesverbali datë 27.12.2023, për miratimin e normativave mbi konsumin e karburantit për mjetet e flotës së Bashkisë Konispol (i vetmi dokumentacion i cili disponohet nga institucioni për miratimin e normativave). Nga grupi i punës, u konstatua se, nuk është kryer analizë mbi konsumin e karburantit, për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin, apo orët/volumet e punës, konkretisht nuk janë kryer testime në rrugë nacionale dhe urbane, apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit), duke evidentuar kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km), si dhe nuk janë kryer testime duke u ndërthurur orët e punës me volumet e punës, në proceset e punës: gërmime, pastrime, shtrim rruge, etj,(në varësi të përdorimit të mjetit/makinerive) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit. Gjithashtu u konstatua se nga Bashkia Konispol nuk është paraqitur në formë shkresore pranë OE të kontraktuar, lista e mjeteve së bashku me limitin mujor të miratuar, që do të furnizohen me karburant. Veprime këto në kundërshtim me kontratën nr. 874 prot., datë 20.06.2024, "Blerje karburant (Diezel) viti 2024", neni 8, pika 8.3, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 5, 10, 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe strukturat përkatëse, të merrin masa në të ardhmen, që përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës, për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive, me qëllim caktimin e normativave sa më reale. Gjithashtu të paraqitet lista e mjeteve së bashku me limitin mujor të miratuar, që do të furnizohen me karburant pranë OE të kontraktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 28.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 3 raste u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar zëra punimi për "infrastrukturë ndihmëse", dhe në disa raste vendosja e çmimemeve të zërave të punës, nuk është në përputhje me manualet e ndërtimit, duke rritur në mënyrë joreale fondin limit, në vlerën totale prej 2,955,500 lekë, ndonëse nuk ka krijuar efekte financiare, kjo e konstatuar për procedurat si më poshtë:
- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën 246,740 lekë;
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën 460,850 lekë;
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën totale 2,247,995 lekë;
Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 34, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për strukturën e kostos*", kreu II seksioni B "Shpenzime të përgjithshme", pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
29.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol të analizojë arsyet, të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsi të tilla. Njësia e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrë masa, të analizojë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 29.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, për kontratat me objekt: *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", "Rikostruksion i Rrugës Fabrika e Vajit-Fillimi i kthesave, Markat" dhe "Rikostruksion i Rrugës Shalsit" Bashkia Konispol*, u konstatuaa mungesë dokumentacioni teknik në dosjet e zbatimit. Konkretisht: mungojnë provat laboratorike dhe raportet e testimit për strukturat e betonit dhe hekurin e përdorur për betonet, për materialet e përdorura për ndërtimin e rrugëve (çakull, stabilizant, binder, asfaltobeton, etj). Gjithashtu në dosjen e zbatimit për objektin *"Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor",* u konstatua mungesë dokumentacioni si: Ditari i punimeve, mungojnë certifikatat e cilësisë për materialet: shtylla elektrike, krahë shtylle, ndriçues, kabllo elektrik, aksesorë të tjerë, si dhe mungon ditari i punimeve.
Rezultoi se AK nuk ka marrë masa, lidhur me vënien në dispozicion të kontraktorit të sheshit të ndërtimit, duke krijuar vonesa të pa justifikuara në fillimin e punimeve të zbatimit të kontratës.

Veprime në mospërputhje me Specifikimet Teknike, kushtet e kontratës dhe pikën 3 kreu II, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*.

30.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me strukturat e saj të marrë masa, për të plotësuar dosjet e zbatimit me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë, si dhe në vijimësi të verifikojë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë dokumentacioni të konstatuar, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

30.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa në vijimësi, për të angazhuar të gjithë kapacitetet dhe strukturat e bashkisë, për vënien në dispozicion të kontraktorëve, sheshet përkatëse të ndërtimeve, pa krijuar vonesa, për të mundësuar fillimin e zbatimit të kontratave dhe përfundimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 30.1 dhe 30.2, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë në dokumentacionin e dosjeve të zbatimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

31. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me administrimin dhe regjistrimin e pronave, u konstatua se Bashkia Konispol disponon 936 pasuri, të cilat janë transferuar me VKM nr. 113, datë 13.02.2013 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Konispol, të Qarkut të Vlorës*", Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë,gjithsej 811 prona, kryesisht me funksione: arsim, shëndetësi, social-kulturore e sportive, troje, hapësira publike, etj; - VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, "*Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë*", në faqen 66, i kanë kaluar në pronësi 4 pasuri; . - VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive*" i ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike*", i transferohen në pronësi 125 (njëqind e njëzetë e pesë). Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:

- Bashkia Konispol nuk ka një strukturë të mirfilltë(drejtori, sektor), për Menaxhimin dhe Administrimin e Aseteve, aktualisht detyrat i kryen Sektori i Pyjeve e Kullotave dhe Emergjencave Civile.
- Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.
- Bashkia Konispol nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie, për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

- Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.
- Bashkia Konispol në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor kullosor, nuk ka kryer verifikime dhe saktësimet përkatëse në terren, për të ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor kullosor, brenda juridiksionit të saj administrativ. Gjithashtu nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, si dhe nuk ka proceduar për regjistrimin e tyre në regjistrat kadastral.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore",* me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*" dhe me VKM nr. 28, date 27.01.2023 "*Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave, të marrë masa, për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, duke kryer evidentimet përkatëse në terren dhe të rakordojë me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Sarandë, për të vijuar me procesin e regjistrimit të pasurive që kanë kaluar në pronësi dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Gjithashtu të procedohet me krijimin e një regjistri kontabël të integruar të inventarit të aseteve, që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Konispol.

Menjëherë dhe në vijimësi

31.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa për të ngritur një strukturë të veçantë për administrimin e aseteve, duke përcaktuar misionin dhe detyrat e saj, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre, me ndikim në rritjen e nivelit të ardhurave të bashkisë.

Menjëherë

31.3.Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa, për të verifikuar dhe saktësuar në terren të gjitha ngastrat pyje dhe kullota, brenda juridiksionit të saj administrativ, për të bërë të mundur ngritjen dhe përditësimin e regjistrit për fondin pyjor kullosor. Gjithashtu të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit, si dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në regjistrat kadastral të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 31.1, 31.2 dhe 31.3 grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e administrimit të pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e dhënies me qira, rezultoi se me VKB-në nr. 18, datë 29.09.2023, me objekt "*Për miratimin e dhënieve me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Konispol*", është miratuar dhënia me qira në total e 138 ngastrave, me sipërfaqe prej ha 9,940.16 ha dhe me VKB-në nr. 30, datë 30.09.2024, është miratuar dhënia me qira në total e 146 ngastrave me sipërfaqe prej ha 11,494.37 ha. Lidhur me

procedurat e ndjekura për dhënien me qira sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, u konstatua si më poshtë vijon:
- Për dhënien me qira të kullotave dimërore nga Bashkia Konispol nuk disponohet dokumentacioni për njoftimin, lidhur me paraqitjen e kërkesave, për marrjen me qira të ngastrave të fondit pyjor dhe kullosor, nga fermerët e territorit të bashkisë. Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "*Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari*", Kreu II "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari", pika 3.
- Nga auditimi me zgjedhje i 9 kontratave për dhënien me qira të kullotave dimërore rezultoi se, nuk disponohen kërkesat e paraqiura nga fermerët me qëllim evidentimin në qoftë se është dhënë përparësi banorëve të këtij qyteti pra është dhënë apo jo përparësi banorëve të kësaj zone sipas njësive administrative përkatëse. Gjithashtu nuk disponohet vërtetimi nga njësia administrative apo Bashkia Konispol për vendbanimin e fermerit. Mos plotësimi me të gjithë dokumentacionin përkatës ligjor i procedurës për dhënien me qira të kullotave është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "*Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari*", Kreu II, pika 5, " dhe Kreu II, pika 6, gërma "a". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të dhënies me qira të kullotave, apo tokave bujqësore, në mënyrë sa më transperente, duke bërë njoftime sa më informuese, me qëllim rritjen e interesit nga subjektet e interesuara për qiramarrje të aseteve, duke i dhënë përparësi kërkesave të paraqitura nga banorët vendas.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 32.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e administrimit të pronës publike (aseteve dhe pyje kullotave) grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në tre raste të audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ***"Objekt shërbimesh dhe hotelerie (2kat+podrum)"***, me zhvillues z. A. G.dhe z. **Sh. G.**, miratuar në 16/08/2023.
- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 71 ditësh pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, si dhe nenin 44 të ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2;
- Mungon çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit mbrojtjes ndaj zjarrit dhe gjeologjik, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).

2. Leje ndërtimi për ***"Magazinë grumbullimi dhe përpunimi produktesh bujqësore 1 kat"***, me zhvillues "K" ShPK, miratuar në 14/05/2024;

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);
- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Referuar ligjit nr.111/2018 *"Për kadastrën"*, neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, Vendimit nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara 3 muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartela është rifreskuar në datë 14.07.2023, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 25.03.2024;
- Objekti nuk respekton lartësinë maksimale, sipas përcaktimeve të paragrafit II.b të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave..."*, pika 2, nënpika b)*/*

3. Çertifikata përdorimi për ***"Magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh bujqësore"***, me zhvillues "L.D." ShPK, miratuar në 04/12/2023;

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se të gjithë aktet e kontrollit nuk është përcaktuar data e përpilimit të këtyre akteve;
- Akt kolaudimi i hartuar nga kolaudatori i licencuar nuk është përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, nuk ka datë, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika c);
- Mungon akti përkatës per menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon planvendosja e objektit, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika f);
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika gj). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 98-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe çertifikata përdorimi:

- të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* me: praninë, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha projekteve ndërtimore; të kërkojnë përfshirjen në aplikim të vërtetimeve

të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore; projektin arkitektonik në formatin DËG; të kërkojnë ngarkimin në sistemin e-lejet të dokumentave të rifreskuar të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 33.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Konispol nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Referuar këtyre përcaktimeve nënligjore të sipërcituara, DR ASHK, në çdo rast, informacioni i dërguar, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezultoi se:

1. Për lejen e ndërtimit ***"Objekt shërbimesh dhe hotelerie (2kat+podrum)"***, me zhvillues z. A.G. dhe z. Sh. G**.**, miratuar në 16/08/2023,

- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Objekti i cituar në mendim-dhënien e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) nuk është i njëjti me objektin e miratuar në lejen e ndërtimit;

2. Për lejen e ndërtimit ***"Magazinë grumbullimi dhe përpunimi produktesh bujqësore 1 kat"***, me zhvillues "K" ShPK, miratuar në 14/05/2024;

- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve;
- Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Trasmetimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.+6 faqe 98-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masa, për të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është rikërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje);

Menjëherë dhe në vijimësi

34.2. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Konispol të merren të gjitha masat për të bashkëpunuar institucionalisht me Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim mundësimin e dhënies së mendimit për çdo aplikim që vjen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 34.1 dhe 34.2, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të IMTV Bashkia Konispol u konstatua se:
- Njësia e IMT Bashkia Konispol, nuk ka funsionuar me numrin e nevojshëm të personelit (inspektorëve), pasi nga 3 inspektorë(1 K/inspektor dhe 2 inspektorë), ka munguar K/inspektori si pjesë e strukturës, që nga muaji korrik 2023.
- Për periudhën objekt auditimi konstatohet se *IMTV Bashkia Konispol, është në kushtet e mosfunksionimit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit*, duke mos i përmbushur detyrimet e përcaktuara ligjore, pasi nuk janë hartuar plane pune dhe nuk janë kryer inspektime të vazhdueshme në territorin e bashkisë, ndërsa në rastet e inspektimeve nuk janë mbajtur akte kontrolli, procesverbale, foto, etj, nuk janë evidentuar në asnjë rast ndërtime pa leje, pra ka mungesë të plotë të praktikave dokumentare, duke krijuar mungesë informacioni të qenësishëm lidhur me situatën e konstatuar gjatë kontrolleve,
- IMTV Bashkia Konispol, nuk ka hartuar regjistër elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të mbajtura, ku të pasqyrohen të gjitha inspektimet e kryera nga inspektorët e IMTV dhe masat përkatëse të marra. Gjithashtu u konstatua keqadministrim i dokumentacionit, që ka në përdorim kjo strukturë, pasi nuk ka një evidencë të saktë dhe të qartë lidhur me personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, inventarin dhe dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Nga Bashkia Konispol nuk ka një angazhim konkret, lidhur me mbështetjen e strukturës së IMTV, pasi krahas mungesës së personelit, u konstatua mungesë logjistike(mjete transporti, pajisje, etj), duke ndikuar në performancën e aktivitetit të kësaj strukture.
-Ka mungesë bashkëpunimi ndërmjet IMTV-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, u konstatua mungesë e bashkëpunimit të strukturuar ndërmjet IMTV-së dhe IKMT-së. Informacioni periodik tremujor, i cili duhet të dërgohet rregullisht pranë IKMT-së sipas përcaktimeve ligjore, është dërguar vetëm në rastet kur është kërkuar specifikisht nga IKMT.
Veprime në mospërputhje me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" i ndryshuar, nenin 50, nenin 5, të ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*", Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 10-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për të krijuar një strukturë të plotë IMT-së, me numër inspektorësh/Kryeinspektor, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, për të rritur numrin dhe cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit. Gjithashtu të bëhen ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, lidhur me organizimin dhe funksionimin e IMTV-së, mbi detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe mënyrën e raportimit dhe komunikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

35.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe strukturat e tjera të bashkisë, të marrin masa për inplementimin e një sistemi elektronik, për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMT-së; për pajisjen e IMT-së me mjet transporti për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së saj në terren si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme, për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Menjëherë dhe në vijimësi

35.3. Rekomandimi: Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore konkrete mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit; të mbajnë akte kontrolli me të gjithë elementët e nevojshëm teknik, për të gjitha inspektimet që kryejnë, si tek objektet e ndërtuara pa leje dhe tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë. Gjithashtu dokumentacioni që administrohet për kryerjen e proceseve të punës, të dokumentohet me marrës në dorëzim, që nga tërheqja nga magazina, deri në procesin përfundimtar të përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 35.1, 35.2 dhe 35.3, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

36. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit, me shkresën nr. 434/6 prot., datë 03.07.2024, është përcjellë Raporti Përfundimtar i Auditimit me rekomandimet e lëna. Rezulton se Bashkia Konispol nuk ka respektuar afatin 20 ditor për informimin e KLSH-së, lidhur me planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Gjithashtu nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna. Veprime në mospërputhje me nenin 15, germa "j" dhe nenin 30 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit".* Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

a. Për përmirësimin e gjëndjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 2 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar 8 masa. Nga 10 masa të zbatuara pjesërisht ose pa zbatuar nuk rikërkohen 3 masa (4.1, 5.1 dhe 9.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe janë pjesë e këtij projektraporti auditimi, për rrjedhojë *rikërkohen për tu zbatuar 7 masa organizative: 2 masa me status "pjesërisht zbatua"r dhe 5 masa me status të "pa zbatuara";*

b. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar 1 masë në vlerën 246,548 lekë, e cila është pranuar dhe rezulton e pa zbatuar, për rrjedhojë *rikërkohet për tu zbatuar 1 masë e "pa zbatuar";*

*c. Për të ardhura të munguara janë rekomanduar 3 masa***,** në vlerën totale 43,124,996 lekë, janë pranuar 3 masa, nga këto është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 2 masa rezultojnë të pa zbatuara, **për rrjedhojë** *rikërkohet për tu zbatuar 1 masë me status e "zbatuar pjesërisht" dhe 2 masa me staus "të pa zbatuara";*

d. Janë rekomanduar 3 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet 'pa zbatuar'**, për rrjedhojë** *rikërkohet zbatimi për 3 masat me status të "pa zbatuara"; (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 10-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

36.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, rikërkojmë marrjen e masave nga Bashkia Konispol, për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masat për rritjen e të ardhurave, duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që këshilli bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës financiare të Bashkisë. Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi për rritjen e të ardhurave të vitit është rikërkuar përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

6.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.
- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar auditimit të nën pikës 2.5 të programit të auditimit me nr.382/1, datë 09.04.2026 u konstatua se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar dhe do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llogaritë e klasës 3 të Aktivit me qëllim paraqitjen e një pamje reale dhe raportimin e saktë të kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar auditimit të pasqyrës së pozicionit financiar llogaritë e klasës 3 të aktivit paraqesin gjendjen reale të materialeve në vlerën 7,327,988 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Konispol të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 "*Debitorë të ndryshëm*" me kundërparti llogarinë nr. 470 "*Të ardhura për t'u marrë*".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar auditimit të pikës 3 të programit të auditimit me nr.382/1, datë 09.04.2026 u konstatua se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar dhe do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Konispol, në fund të vitit 2025 llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në vlerën 14,855,807 lekë. Shtesat e llogarisë gjatë periudhës 2024-2025 janë në vlerën 5,468,622 lekë.

Për vlerën në shumën 9,387,185 lekë, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion analitik dhe rakordim me Degën e Thesarit Sarandë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

13.1. Rekomandim: Bashkia Konispol duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar edhe në auditimin e përputhshmërisë dhe financiar të dërguar në Bashkinë Konispol me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

14.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Nga masat e kërkuara në auditimin e mëparshëm:

A. Masa organizative.

4.1. Rekomandimi: Drejtorisë Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. *32* "*Inventari i imët"* për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar auditimit të pasqyrës së pozicionit financiar llogaritë e klasës 3 të aktivit paraqesin gjendjen reale të materialeve në vlerën 7,327,988 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" u konstatua se vlera e masave për shpërblim dëmi janë kontabilizuar në këtë llogari.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7.1. Rekomandimi: Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. *212 "Ndërtesa Konstruksione"* për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për rekomandimin e mësipërm Bashkia Konispol nuk ka ngritur grupe pune. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

9.1. Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek "**Ujësjellës Kanalizime Konispol**

Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Rekomandimi i mësipërm nuk mund të realizohet sepse **Ujësjellës Kanalizime Konispol Sh.a** është shoqëri që është përthithur nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizme Sarandë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

C. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.

3.1.Rekomandimi:Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria "Vodafon Albania" në vlerën **1,475,000 lekë.**

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga audtimi i rekomandimit të mësipërm rezulton se toka për të cilën ka lindur detyrimi sipas kontratës së qirasë nuk është në pronësi të Bashkisë Konispol. Kjo pjesë është marrë në pronësi nga Komiteti Mysliman i cili e posedon me certifikatë pronësie.

Statusi: Zbatuar plotësisht

D. Masa për uljen e detyrimit tatimor.

1.1. Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë**.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 debitorët familjarë janë në vlerën 50,217,821 lekë debitorët biznes janë në vlerën 6,067,596 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

B. MASA PÉR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NÉ MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve mbi subjektet debitorë për "*Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale*", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **246,548 lekë.**

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga auditimi i kryer , konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, kanë paraqitur kërkesë pranë ASHK Dega Rajonale Sarandë për pajisjen me vërtetim gjithësej 7 persona detyrim i cili është likuiduar në vlerën 362,592 lekë që përfshin dhe taksën e ndikimit në infrastukturë, ndërsa në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje përpara vitit 2024 konstatohet se gjendja debitore ngelet e pa ndryshuar, konkretisht nuk kanë paguar detyrimin 11 persona në vlerën **246,548 lekë.**

Statusi: Në proces zbatimi

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,000,000 lekë** nga subjekti **"I" ShPK.**

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Subjekti **"I" shpk** ka kryer pagesën në shumën 500,000 lekë me datë 21.04.2026 me qëllim paisjen me autorizim. Ky subjekt nuk është pajisur me autorizim për shkak të moskryerjes së pagesës së plotë. Ky rekomandim do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

2.1.Rekomandimi; Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduar në vlerën **2,025,000** lekë, nga 2 subjektet respektivisht;

- **vlera 1,875,000 lekë** nga subjekti "V. A"
- **vlera 150,000 lekë** nga subjekti " (T. A) sh.a.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga audtimi i rekomandimit të mësipërm rezulton se toka për të cilën ka lindur detyrimi sipas kontratës së qirasë nuk është në pronësi të Bashkisë Konispol. Kjo pjesë është marrë në pronësi nga **K. M.** i cili e posedon me certifikatë pronësie.

Detyrimi për subjektin (**T. A.**) sh.a. vazhdon i palikuiduar. Rekomandimi i mësipërm është kërkuar përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Konispol, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për një numër debitorësh prej 3,948 debitorë në vlerën **40,099,996** lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 debitorët familjarë janë në vlerën 50,217,821 lekë debitorët biznes janë në vlerën 6,067,596 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në Nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore - **"Vërejtje"**, si më poshtë:

1. Z. D. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit te Shërbimit ndaj taksapaguesve, për mangësitë konstatuar sa i takon, mungesës së marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e Taksave dhe Tarifave Vendore. Këto veprime janë në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

2. Z. J. H. me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimit ndaj taksapaguesve, për mangësitë konstatuar sa i takon, mungesës së marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e Taksave dhe Tarifave Vendore. Këto veprime janë në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

3. Znj. O. E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, për mos kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023, moskuadrimet e llogarive të klasës 3 midis gjendjes së inventarit fizik dhe gjendjes së kontabilizuar gjatë vitit 2023. Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" e paraqitur në pasqyrat financiare nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" dhe udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se për rekomandimin e mësipërm nuk është marrë asnjë masë. Për punonjësit e mësipërm është propozuar masë disiplinore edhe në auditimin e përputhshmërisë dhe financiar të dërguar në Bashkinë Konispol me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana eTitullarit të Njësisë Publike(Bashkia Konispol), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë **1,325,600 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit"*, sipas kontratës për punë publike me nr. 1105 prot., datë 10.09.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "M/S" ShPK, me Lic. Nr. NZ.0440/26, me vlerë të kontratës 10,237,701 lekë me TVSH, për 6 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë *dëm ekonomik* në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 712,700 lekë pa TVSH.

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 712,700 lekë (pa TVSH) nga OE "M/S" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1105 prot., datë 10.09.2024, me objekt *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit"*, vlerë që përfaqëson dëm

ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara..

Brenda datës 30.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 1.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar. Bashkia Konispol i ka dërguar OE shkresën me nr.1543/2 *"Njoftim OE M/S për arkëtimin e vlerës 712,700 lekë"*. Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryera pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *"Rikostruksion i Rrugës fabrika e vajit-fillimi i kthesave, Markat",* sipas kontratës për punë publike nr. 834 Prot., datë 10.06.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "J. C." ShPK, me vlerë të kontratës 5,488,600 lekë me TVSH, për 2 zëra punimi, volumet rezultuan të llogaritura më tepër se përmasat e projektit të zbatimit të miratuar, si dhe të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 324,400 lekë pa TVSH. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 324,400 lekë(pa TVSH) nga OE "J.C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 834 prot., datë 10.06.2024, me objekt *""Rikostruksion i Rrugës fabrika e vajit-fillimi i kthesave, Markat",* vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve jo në përputhje me projektin e miratuar.

Brenda datës 30.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 2.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar. Bashkia Konispol i ka dërguar OE shkresën me nr.1543/3 *"Njoftim OE J. C. për arkëtimin e vlerës 324,400 lekë*". Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryera pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor" Bashkia Konispol,,* sipas kontratës për punë publike nr. 1092 Prot., datë 11.10.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "M/S" ShPK, me vlerë të kontratës 9, 213,333 lekë me TVSH, për 2 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 92,700 lekë pa TVSH.

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 92,700 lekë(pa

TVSH) nga OE "M/S" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1092 prot., datë 11.10.2022, me objekt "*Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor",* vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 3.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar. Bashkia Konispol i ka dërguar OE shkresën me nr.1543/4 *"Njoftim OE Mane/S për arkëtimin e vlerës 92,700 lekë"*. Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryer pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes kuadër me objekt "Për blerje materaile ndërtimi dhe asfaltimi rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Konispol", sipas kontratës nr.302 Prot., datë 15.03.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "K" sh.p.k, me vlerë të kontratës 15,886,050 lekë pa TVSH, për 2 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 195,800 lekë pa TVSH. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 195,800 lekë(pa TVSH) nga OE "K" sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 302 prot., datë 15.03.2023, me objekt "Blerje materaile ndërtimi dhe asfaltimi rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Konispol", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 4.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar. Bashkia Konispol i ka dërguar OE shkresën me nr.1543/4 *"Njoftim OE K për arkëtimin e vlerës 195,800 lekë*". Përveç njoftimit nuk janë marrë masa të tjera nuk është kryera pagesa.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit. Për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024, lidhur kontrata nr. 1412, datë 07.11.2024 me vlerë 32,052,498, rezulton se në preventivin e fondit limit në seksionin C "Infrastrukturë ndihmëse", në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar, janë përfshirë *4 zëra punimi me vlerë totale 3,478,000 lekë***.** Gjithashtu për zërin "F.v. tub çeliku me diametër 250 mm/7.0 mm", nga llogaritja e jo e saktë e peshës totale të tubit të çelikut, është përcaktuar më tepër në preventiv sasia prej 1.7 ton, duke

krijuar rritje të fondit limit në *vlerën takuese 299,200 lekë.* Për rrjedhojë fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar, në vlerën totale prej 3,777,200 lekë dhe në referencë të ofertës fituese, për të cilën është lidhur kontrata nr. 1412, datë 07.11.2024, me vlerë 32,052,498 lekë, është krijuar një diferencë në vlerën prej 2,415,871 lekë[32,052,498(vlera e kontratës)-29,634,619(vlera e korigjuar e fondit limit)], e cila përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve publike. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për strukturën e kostos*", kreu II seksioni B pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet e anomalive në përllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë, për të bërë të mudur përdorimin e fondeve publike me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 1.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri më datën 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë, biznesi i madh dhe i vogël, në vlerën 40,099,996 lekë**.** Përgjatë vitit 2024 janë shtuar debitorë në vlerën 12,984,138 lekë nga e cila është arkëtuar vlera 707,676 lekë, ku gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën *52,002,269 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Konispol.*

1. Vlera *19,804,890 lekë për 1680 familje* e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
2. Vlera *20,553,791 lekë për 1520 familje* e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin Bashkisë Konispol nga mos arkëtimi i taksave të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe vaditjes;
3. Vlera *6,260,897 lekë për 1154 familje* e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
4. Vlera *4,803,691 lekë* e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël;
5. Vlera *579,000 lekë e* cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i madh;

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, dhe Ligjin nr.

68/2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 35. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa, për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve, për taksat dhe tarifat vendore për periudhën deri më datë 31.12.2024, në *vlerën totale 52,002,269 lekë, e cila përbëhet nga:*

- 19,804,890 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore;
- 20,553,791 lekë detyrime për taksat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe vaditjes;
- 6,260,897 lekë detyrime për taksës së ndërtese;
- 4,803,691 lekë detyrime nga biznesi i vogël;
- 579,000 lekë detyrime nga biznesi i madh;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të Ardhurave vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Konispol, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv, ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 debitorët familjarë janë në vlerën 50,217,821 lekë debitorët biznes janë në vlerën 6,067,596 lekë. Referuar situatës debitorë për vitin 2025 rezulton se kemi rritjes të gjendjes debitorë me vlerën 4,283,148 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të Regjistrit Civil në territorin e Bashkisë Konispol në total janë **2,395** abonentë familjarë konkretisht e ndarë kjo 742 abonentë Konispol, 850 abonentë në NjA Xarrë dhe 803 abonentë në NjA Markat. Nga auditimi i strukturës së paketës fiskale për vitin 2024 dhe evidencës së realizimit të të ardhurave u konstatua se nuk janë përllogaritur detyrime tatimore për të kategorinë "Abonentë familjarë" në vlerën totale prej *14,915,956 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Konispol* konkretisht për:

- "Taksën e tokës bujqësore" nuk janë përllogaritur detyrimet në vlerën 586,549 lekë për 185 ha;
- "Tarifën e pastrimit dhe përpunimit të mbeturinave" nuk janë përllogaritur detyrimet në vlerën 526,000 lekë për 526 abonentë familjarë;
- "Tarifën e ndriçimit publik" nuk janë përllogaritur detyrimet në vlerën 511,500 lekë për 341 abonentë familjarë;
- "Tarifën e mirëmbajtjes së vorrezave publike" nuk janë përllogaritur detyrimet në vlerën 259,000 lekë për 259 abonentë familjarë;
- "Tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve, vaditje dhe kulluese" nuk janë përllogaritur detyrimet në

vlerën 13,032,907 lekë për 3,723.7 ha;
Këto veprime janë kundërshtim me Paketën Fiskale për vitin 2024, të miratuar me VKB nr. 24, datë 30.11.2023, Kapitulli "Taksat Vendore" dhe "Tarifat Vendore". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrej grup pune me specialistë të fushës, për të koordinuar procesin për evidentimin e familjeve, për të cilat nuk janë përllogaritur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, duke rakorduar njëkohësisht informacionin mbi familjet e regjistruara sipas regjistrit të gjendjes civile me situatën faktike në terren, me qëllim arkëtimin e të ardhurave *në vlerën 14,915,956 lekë.*

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i nënpikës 2.5 të programit të auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar. Ky rekomandim do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje si dhe referuar dokumentacionin shkresor të dërguar pranë ASHK Dega Rajonale Sarandë u konstatua se, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, ka paraqitur kërkesë për pajisjen me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithësej 1 person për vlerën e taksës së përllogaritur në vlerën 291,770 lekë, detyrim i cili është likuiduar. Ndërkohë që përpara vitit 2024 u konstatua se, gjendja debitore ngelet e pa ndryshuar, konkretisht nuk kanë paguar detyrimin 11 persona në vlerën *246,548 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol.* Për më tepër nga nga Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit Bashkia Konispol nuk është kryer asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë *për 11 debitorë në vlerën 246,548 lekë,* si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Konispol të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i kryer , konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, kanë paraqitur kërkesë pranë ASHK Dega Rajonale Sarandë për pajisjen me vërtetim gjithësej 7 persona detyrim i cili është likuiduar në vlerën 362,592 lekë që përfshin dhe taksën e ndikimit në infrastukturë, ndërsa në lidhje me realizimin e të ardhurave të

bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje përpara vitit 2024 konstatohet se gjendja debitore ngelet e pa ndryshuar, konkretisht nuk kanë paguar detyrimin 11 persona në vlerën **246,548 lekë.**

Statusi: Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Konispol kanë ushtruar aktivitet 4 subjekte në fushën e ndërtimit, të cilat nuk janë të pajisur me Nipt Sekondar në zbatim të përcaktimeve të nenit 22 dhe neneve 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, ku këto subjekte duhet të shlyejnë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj institucionit referuar kontratave si më poshtë:
1. Kontrata e datës 30.10.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Konispol dhe OE "I" ShPK me objekt "Mbrojtje lumore ne tokat e Markatit", me vlerë kontrate 24,980,760 lekë pa TVSH me afat përfundimi të punimeve deri më datë 15.12.2024, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 12,120 lekë.
2. Kontrata e datës 07.11.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Konispol dhe OE "M" ShPK me objekt "Ndërtim i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me vlerë kontrate 32,052,498 lekë pa TVSH me afat përfundimi të punimeve deri më datë 12.12.2024.
Kontrata e datës 10.09.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Konispol dhe OE "M" ShPK me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me vlerë kontrate 8,531,418 lekë pa TVSH me afat përfundimi të punimeve deri më datë 10.10.2024, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 12,120 lekë.
3. Kontrata e datës 10.06.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Konispol dhe OE "J.K." ShPK me objekt "Rikostruksioni i rrugës (Fabrika e vajit-fillimi i kthesave malore) Markat", me vlerë kontrate 6,018,720 lekë pa TVSH me afat përfundimi të punimeve deri më datë 22.06.2024, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 12,120 lekë.
- Kontrata e datës 10.06.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Konispol dhe OE "K" ShPK me objekt "Rikostruksioni i rrugës së Shalësit", me vlerë kontrate 5,488,600 lekë pa TVSH me afat përfundimi të punimeve deri më datë 01.07.2024, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 12,120 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në bashkëpunim me Sektoin Juridik të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Konispol të pa pajisur me Nipt sekondar ***në vlerën 48,480 lekë.***

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i nënpikës 2.5 të programit të auditimit nr.382/1, datë 09.04.2026 rezulton se gjatë vitit 2025 kanë fituar kontrata publike 3 OE.
"I" me detyrime sipas paketës fiskale 13,120 lekë rezuton papaguar.
"M" me detyrime sipas paketës fiskale 13,120 lekë rezuton papaguar.
"K" me detyrime sipas paketës fiskale 13,120 lekë rezuton papaguar.

Statusi: Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e dhënies me qira të aseteve, rezultoi se:

- Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024, Bashkia Konispol ka nënshkruar në total 123 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore, ku evidentohen 35 debitorë në fund të vitit 2024, në vlerën *513,124 lekë* si pasojë e mos likudimit të detyrimeve kontraktuale, sipas Pasqyrës nr. 4, Pika 7(bashkëlidhur).

- Bashkia Konispol me datë 27.03.2019, ka kryer amendimin e kontratës të lidhur me kompaninë **"V. A." Sh.a**, duke shtyrë afatin me 3 vjet, rezulton se nga kjo periudhë deri me datë 31.12.2024, Kompania **"V. A." Sh.a** është debitore ndaj Bashkisë Konispol *në vlerën 2,250,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me* nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore dhe me kontratat përkatëse të lidhura me qiramarrësit debitorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit debitorë, konkretisht: Për vlerën 513,124 lekë, nga personat qiramarrës të tokës bujqësore, sipas Pasqyrës nr. 4, Pika 7(bashkëlidhur) dhe për vlerën 2,250,000 lekë nga Kompania **"V. A." Sh.a**, si detyrim kontraktual i pa likujduar.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i detyrimeve për kontratat e tokave bujqësore detyrimi në datën 31.12.2025 rezulton si mëposhtë:

Konispol janë 4 (katër) kontrata debitorë me vlerë detyrimi 102,796 lekë.

Nj.A Markat janë 36 (tridhjetë e gjashtë) kontrata debitorë me vlerë detyrimi 738,303 lekë.

Për detyrimin e "V. A." Sh.a rezulton se toka për të cilën ka lindur detyrimi sipas kontratës së qirasë nuk është në pronësi të Bashkisë Konispol. Kjo pjesë është marrë në pronësi nga K.M**.** i cili e posedon me certifikatë pronësie.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 15 germat (b,c,ç); nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol**, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore, si mëposhtë:

***"Vërejtje"*, në zbatim të germës "a" të nenit 58, për**:

1. Znj. O. E., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, si dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së, *për shkeljet e konstatuara:*

- Për llogarinë 202 *"Studime dhe kërkime"* nuk është përllogaritur normë amortizimi. Amortizimi i akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë i përket gjendjes së mbylljes së datës 31.12.2023, dhe jo atë të vitit ushtrimor 2024;

- Llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* e pasqyruar në bilanc për vlerën 24,011,454 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Referuar të dhënave analitike përbërëse të llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"* konstatohet se, në këtë llogari është përfshirë zëri *"Blerje skrep bujqësi (Volvo)"* në vlerën kontabël *(kosto historike)* në vlerën 16,347,131 lekë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 215 *"Mjete transporti"*, në zbatim të përcaktimeve në Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi 2, Artikulli 21, Llogaria 215 *"Mjete transporti"*;
- Llogaria 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* është nënvlerësuar në vlerën 23,896,411 lekë;
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është mbivlerësuar në vlerën 448,999 lekë;
- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* dhe llogaritë e Klasës 3 *"Gjendje inventari qarkullues"*, shtesë e kryer për vitin 2024 është në vlerën 63,272,910 lekë *(60,773,758 lekë + 2,499,152 lekë)*, ndërkohë që referuar ditarit të bankës konkretisht shpenzimeve të kryera me pagesë për mallra, shërbimeve dhe investimeve janë në vlerën 69,578,233 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në pasqyrat financiare në vlerën 6,305,323 lekë;
- Në 51 raste janë kryer likujdime në vlerën totale prej 26,655,138 lekë për punë publike publike dhe shërbime të cilat përbëjnë shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik duke i përjashtuar këto procedura.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", nenet 7-9 dhe nenet 65-70, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

- Në 6 procedura prokurimi, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- Nuk ka marrë masa për monitorimin e inventarit dhe për dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Veprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e; Ligjit Nr. 10 296, Datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin*" të ndryshuar, neni 4/26 dhe neni 9/4/ë, neni 12/3; Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", pika 2, 5, 12, 36, 37, 38, 72 73, 74; Rregulloren e brendshme të Bashkisë Konispol neni 44.

2. Z. D. K. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve,
për shkeljet e konstatuara:

- Për ushtrimin e aktivitetit përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Konispol të katër subjekteve në fushën e ndërtimit të cilat nuk janë të pajisur me Nipt Sekondar në zbatim të përcaktimeve të nenit 22 dhe neneve 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, *"Për regjistrimin e biznesit"* i ndryshuar;
- Për mos përllogaritjen e detyrimeve tatimore për kategorinë *"Abonentë familjarë"* në vlerën 14,915,956 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol. *(Trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Z. A. B., më detyrë Drejtor në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

4. Z. L. B**.,** me detyrë specialist në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 5 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

5. E. H. më detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 5 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit përfundimtar të auditimit).*
- Për administrim jo korrekt të dosjeve të punonjësve, me mangësi mangësi dokumentacioni si, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë; fletën e inventarit të dosjes; përshkrimin e punës; certifikatën familjare të përditësuar; raportin mjekësor të përditësuar
- Për largimet nga puna, nuk ka zbatuar VKM 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku të dokumentohej dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse dhe dokumentacioni për shkak të detyrës.
- Nuk ka marrë masa për të zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur për rekrutimet e reja, për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil.

Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neni 62 dhe VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë*", VKM-së nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*".

- Në lidhje me administrimin e pronave dhe asteve të bashkisë, nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.
Veprime në mospërputhje me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore",* me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. D. Ll., më detyrë specialist në Zyrën e Financës,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7. A. A., më detyrë specialist në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8. M. B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë,
për shkeljet e konstatuara:
- Në lidhje me administrimin e pronave dhe asteve të bashkisë, nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.
- Në lidhje me administrimin dhe hënien me qira të kullotave, nuk disponohet dokumentacioni për njoftimin, lidhur me paraqitjen e kërkesave, për marrjen me qira të ngastrave të fondit pyjor dhe kullosor, nga fermerët e territorit të bashkisë.
Veprime në mospërputhje me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit

nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore"*, me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9. E. Z., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol,

10. D. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, periudha 17.07.2023 deri 31.12.2024,

për shkeljet e konstatuara:

- Gjatë kryerjes së inspektimeve në terren nuk kanë dokumentuar proceset e inspektimit e kryera, nuk kanë mbajtur akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, si dhe nuk kanë hartuar një regjistër për pasqyrimin e akteve të mbajtura. Veprime në mospërputhje me; nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".

11. A. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, për periudhën 01.01.2023- 17.07.2023 dhe magazinierit për periudhën 18.07.2024- 31.12.2024, *për shkeljet e konstatuara:*

- Gjatë kryerjes së inspektimeve në terren nuk ka dokumentuar proceset e inspektimit e kryera, nuk ka mbajtur akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, si dhe nuk ka hartuar një regjistër për pasqyrimin e akteve të mbajtura. Për periudhën që ka kryer detyrën e magazinierit, nuk ka mbajtur një evidencë të saktë dhe të qartë lidhur me personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, inventarin dhe dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Veprime në mospërputhje me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, nenin 51, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".

E.2. Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:

1. Z. J. Y., në cilësinë e e ish Drejtorit të Administrimit të Përgjithshëm dhe Integrimit Evropian deri në datën 30.06.2023

2. Znj. M. H., në cilësinë e ish specialiste juriste

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se për rekomandimin e mësipërm nuk është marrë asnjë masë.

Statusi: Pa zbatuar

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Konispol pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e realizuar nga Bashkia Konispol në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të dërguara me shkresën Nr. 322/7 Prot., datë 20.10.2025, për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre. Po ashtu, për masat që nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht, KLSH rikërkon realizimin e plotë të rekomandimeve, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

10. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (ASHK Sarandë për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugorë Sarandë) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Konispol dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Sarandë, duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor. Bashkia Konispol ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitin 2024 me agjentin tatimorë ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 26, datë 04.09.2008, "*Për taksat kombëtare*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 117.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 40,099,995 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 52,796,921 lekë me një rritje në vlerën 12,482,949 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë të përfshirë debitorët nga dhënia me qira e sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për vendosjen e antenave telefonike në vlerën 2,250,000 lekë, sipas kërkesës për likuidim me shkresën nr. 243 prot., datë 28.02.2023, drejtuar OE **"V" Sh.a.** Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në shkresën e datës 08.01.2025, që Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 52,796,921 lekë pa përfshirë detyrimin në vlerën 2,250,000 lekë nga qiradhënia e aseteve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për*

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, pika 5 dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".

Deri më datë 31.12.2025

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për pasqyrat financiare rezultoi se, Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 26,598,247 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 8,073,579 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 15,972,380 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 33,341,914 lekë. Referuar të dhënave analitike përbërëse të llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" u konstatua se, në këtë llogari është përfshirë zëri "Blerje skrep bujqësi (Volvo)" në vlerën kontabël (kosto historike) në vlerën 16,347,131 lekë, e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 215 "Mjete transporti", në zbatim të përcaktimeve në Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi 2, Artikulli 21, Llogaria 215 "Mjete transporti". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Bashkinë Konispol, të marrë masa për sistemimin e vlerës 16,347,131 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" duke i kontabilizuar në llogarinë 215 "Mjete transporti".

Deri më datë 31.12.2025

18. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi vjetor në vlerën 690,644 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Amortizimi për këtë llogari nuk paraqitet i saktë për arsye se është kryer në total për vlerën e çeljes së gjendjes së llogarisë më datë 01.01.2023, duke marrë në konsideratë faktin që kjo llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime përgjatë vitit 2023, ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%.

2. Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 240,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 240,000 lekë. Nga auditimi u konstatua se, për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime" nuk është përllogaritur normë amortizimi. Amortizimi i akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë i përket gjendjes së mbylljes së datës 31.12.2023, dhe jo asaj të vitit ushtrimor 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimim e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar pika 2, klasa 2, gërma "d", pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol, të marrë masa lidhur me gjendjen e llogarisë 218 "Inventar ekonomik", për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për

çdo aktiv. Si dhe të aplikojë normë amortizimi për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime", duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.12.2025

21. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" më datë 01.01.2024, është në vlerën 40,099,995 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 53,073,605 lekë me një rritje në vlerën 12,973,610 lekë. Në këtë llogari janë kontabilzuar si kundraparti debitorët nga taksat dhe tarifat vendore, ndërkohë që kundraparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" është llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë". Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërparti llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol të marrë masa për sistemimin e vlerës 53,073,605 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" duke i kontabilizuar në llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" e cila shërben si kundërparti e 468 "Kreditorë të ndryshëm".

Deri më datë 31.12.2025

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 6 raste u konstatuan mangësi lidhur me përcaktimin e kritereve të kualifikimit, konkretisht:

- Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 22024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2023, me fond limit 16,548,754 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2023.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant (Diezel) (Për nevoja të Bashkisë Konispol)" zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.

Rezultoi se këto procedura prokurimi janë kryer me parregullsi**,** duke mos argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht:

- Aplikimi në mënyrë të gabuar i kufirit të vlerës, për paraqitjen e vërtetimit të lëshuar nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet e fundit, problematkë e konstatuar në të gjitha rastet;
- Aplikimi në mënyrë të gabuar i kufirit të vlerës, për punë të ngjashme, që duhet të paraqesë OE, problematkë e konstatuar në të gjitha rastet;
- Në 4 raste aplikimi i kritereve "Kapaciteti teknik"(kategoritë e licencave, stafi teknik, mjek i përgjithshëm), të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve;
- Mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar, si dhe vendosja si kriter e distancave, në të gjitha rastet;

Veprime këto në kundërshtim me nenin 2, nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", me nenin 2, nenin 39, pika 4, pika 5 neni 43 dhe nenin 78, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

24.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 5 raste u konstatuan mangësi lidhur me vlerësimin e ofertave dhe kualifikimin e OE, konkretisht:

- Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 22024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" viti 2023, me fond limit 16,548,754 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2023.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant (Diezel) (Për nevoja të Bashkisë Konispol)" zhvilluar në vitin 2024.
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024.

Rezultoi se në këto procedura prokurimi, KVO ka shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kritereve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit.

Veprime këto në mospërputhje me kërkesat e nenit 92 pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe me pikën 2 neni 82, të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e mangësive të konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe përgjegjësitë në zhvillimin e këtij procesi. Gjithashtu KVO të marrë masa, që të shmangen parregullsi të tilla, për të përmbushur realizimin e këtij procesi në mënyrë objektive dhe transparente.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurave të prokurimit dhe dosjeve të zbatimit të punimeve për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2024, rezultoi se dokumentet gjendje në dosjet fizike nuk janë të numëruara, të inventarizuara, nuk ka dorëzues dhe marrës në dorëzim dhe arkivimin e tyre në përfundim të procesit. Veprime në kundërshtim nenin 36, Kreun V të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Strukturat dhe personat përgjegjës në Bashkinë Konispol, të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të dokumentacionit pjesë e dosjeve dhe arkivimin e dosjeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse, duke nënshkruar dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim.

Për të shmangur risqet e tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, dokumentacioni duhet të administrohet, sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, për *"Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024 dhe "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2023,* rezultoi se se procedurat e prokurimit, janë kryer me parregullsi, pasi:

- Procesi i përcaktimit të nevojave për materiale ndërtimi: beton, asfaltobeton, etj, nuk mbështetet në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar, lidhur me nevojat për ndërhyrje për rikonstruksion të rrugëve brenda territorit të bashkisë. Nuk janë përcaktuar rrugët më problematike, që kërkojnë ndërhyrje për riparimin e tyre, si dhe nuk janë përcaktuar elmentët e rrugëve bazuar në përmasa, për të cilat kërkohet ndërhyrje. Për rrjedhojë volumet e përcaktuara në preventiv, nuk janë të argumentuara teknikisht.
- Specifikimet teknike nuk janë të plota, kryesisht përshkruhen për disa artikuj, ndërsa disa nga artikujt nuk përfshihen fare në specifikimet teknike(zgara metalike), duke mos përshkruar kërkesat që duhet të plotësojnë nga ana cilësore.
- Lidhur me zbatimin e kontratës së vitit 2023, u konstatua se në dosjen e prokurimit nuk dokumentohet mënyra e kërkesës nga ana e AK drejtuar kontraktuesit (OE i shpallur fitues) për këtë procedurë prokurimi, për furnizimin me mallra objekt i kësaj marrëveshje kuadër. Përsa i përket kryerjes së mirëmbajtjes së përgjithshme të rrugëve rurale, punimet e kryera janë pasqyruar në skica(planimetritë e rrugëve), sipas sipërfaqeve përkatëse, por mungon dokumentacioni i plotë(librezë masash, procesverbale të punimeve të maskuara, etj). Mungon mbikëqyrja e gjithë procesit nga momenti marrjes në dorëzim të materialeve, deri në kryerjen e punimeve të ndërtimit me materialet e furnizuara.

Veprime këto në mospërputhje me nenin 1.2 të Draftit të marrëveshjes kuadër me nr. prot., datë 23.02.2022 dhe Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" neni 52, pika 5, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 2, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet dhe të marrë masa konkrete, për të përmirësuar procesin e përcaktimit të nevojave për materiale mirëmbajtje dhe ndërtimi, proces i cili duhet të mbështetet në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar. Gjithashtu nga personat përgjegjës të caktuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrë masa për dokumentimin e gjithë procesit, në të gjitha fazat e zbatimit të kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave lidhur me zbatimin e kontratës për furnizimin me gazoil për vitin 2024, rezultoi se nga grupi i punës është mbajtur procesverbali datë 27.12.2023, për miratimin e normativave mbi konsumin e karburantit për mjetet e flotës së Bashkisë Konispol (i vetmi dokumentacion i cili disponohet nga institucioni për miratimin e normativave). Nga grupi i punës, u konstatua se, nuk është kryer analizë mbi konsumin e karburantit, për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin, apo orët/volumet e punës, konkretisht nuk janë kryer testime në rrugë nacionale dhe urbane, apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit), duke evidentuar kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km), si dhe nuk janë kryer testime duke u ndërthurur orët e punës me volumet e punës, në proceset e punës: gërmime, pastrime, shtrim rruge, etj,(në varësi të përdorimit të mjetit/makinerive) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

Gjithashtu u konstatua se nga Bashkia Konispol nuk është paraqitur në formë shkresore pranë OE të kontraktuar, lista e mjeteve së bashku me limitin mujor të miratuar, që do të furnizohen me karburant. Veprime këto në kundërshtim me kontratën nr. 874 prot., datë 20.06.2024, "Blerje karburant (Diezel) viti 2024", neni 8, pika 8.3, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 5, 10, 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe strukturat përkatëse, të merrin masa në të ardhmen, që përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës, për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive, me qëllim caktimin e normativave sa më reale. Gjithashtu të paraqitet lista e mjeteve së bashku me limitin mujor të miratuar, që do të furnizohen me karburant pranë OE të kontraktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 3 raste u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar zëra punimi për "infrastrukturë ndihmëse", dhe në disa raste vendosja e çmimemeve të zërave të punës, nuk është në përputhje me manualet e ndërtimit, duke rritur në mënyrë joreale fondin limit, në vlerën totale prej 2,955,500 lekë, ndonëse nuk ka krijuar efekte financiare, kjo e konstatuar për procedurat si më poshtë:

- Procedura e prokurimit me objekt "Mbrojtje Lumore në tokat e Markatit", me fond limit 27,165,373 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën 246,740 lekë;
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale ndërtimi`" Viti 2024, me fond limit 25,019,357 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën 460,850 lekë;
- Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", me fond limit 11,375,129 lekë pa TVSH, është rritur fondi limit në vlerën totale 2,247,995 lekë;

Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 34, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për strukturën e kostos*", kreu II seksioni B "Shpenzime të përgjithshme", pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol të analizojë arsyet, të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsi të tilla. Njësia e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrë masa, të analizojë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, për kontratat me objekt: *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit", "Rikostruksion i Rrugës Fabrika e Vajit-Fillimi i kthesave, Markat" dhe "Rikostruksion i Rrugës Shalsit" Bashkia Konispol*, u konstatuaa mungesë dokumentacioni teknik në dosjet e zbatimit. Konkretisht: mungojnë provat laboratorike dhe raportet e testimit për strukturat e betonit dhe hekurin e përdorur për betonet, për materialet e përdorura për ndërtimin e rrugëve (çakull, stabilizant, binder, asfaltobeton, etj). Gjithashtu në dosjen e zbatimit për objektin *"Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor",* u konstatua mungesë dokumentacioni si: Ditari i punimeve, mungojnë certifikatat e cilësisë për

materialet: shtylla elektrike, krahë shtylle, ndriçues, kabllo elektrik, aksesorë të tjerë, si dhe mungon ditari i punimeve.
Rezultoi se AK nuk ka marrë masa, lidhur me vënien në dispozicion të kontraktorit të sheshit të ndërtimit, duke krijuar vonesa të pa justifikuara në fillimin e punimeve të zbatimit të kontratës.
Veprime në mospërputhje me Specifikimet Teknike, kushtet e kontratës dhe pikën 3 kreu II, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*.

30.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me strukturat e saj të marrë masa, për të plotësuar dosjet e zbatimit me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë, si dhe në vijimësi të verifikojë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë dokumentacioni të konstatuar, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

30.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa në vijimësi, për të angazhuar të gjithë kapacitetet dhe strukturat e bashkisë, për vënien në dispozicion të kontraktorëve, sheshet përkatëse të ndërtimeve, pa krijuar vonesa, për të mundësuar fillimin e zbatimit të kontratave dhe përfundimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me administrimin dhe regjistrimin e pronave, u konstatua se Bashkia Konispol disponon 936 pasuri, të cilat janë transferuar me VKM nr. 113, datë 13.02.2013 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Konispol, të Qarkut të Vlorës*", Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë,gjithsej 811 prona, kryesisht me funksione: arsim, shëndetësi, social-kulturore e sportive, troje, hapësira publike, etj; - VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, "*Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë*", në faqen 66, i kanë kaluar në pronësi 4 pasuri; . - VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive*" i ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike*", i transferohen në pronësi 125 (njëqind e njëzetë e pesë). Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:
- Bashkia Konispol nuk ka një strukturë të mirfilltë(drejtori, sektor), për Menaxhimin dhe Administrimin e Aseteve, aktualisht detyrat i kryen Sektori i Pyjeve e Kullotave dhe Emergjencave Civile.
- Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.
- Bashkia Konispol nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie, për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

- Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.
- Bashkia Konispol në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor kullosor, nuk ka kryer verifikime dhe saktësimet përkatëse në terren, për të ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor kullosor, brenda juridiksionit të saj administrativ. Gjithashtu nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, si dhe nuk ka proceduar për regjistrimin e tyre në regjistrat kadastral.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore",* me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*" dhe me VKM nr. 28, date 27.01.2023 "*Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave, të marrë masa, për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, duke kryer evidentimet përkatëse në terren dhe të rakordojë me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Sarandë, për të vijuar me procesin e regjistrimit të pasurive që kanë kaluar në pronësi dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Gjithashtu të procedohet me krijimin e një regjistri kontabël të integruar të inventarit të aseteve, që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Konispol.

Menjëherë dhe në vijimësi

31.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa për të ngritur një strukturë të veçantë për administrimin e aseteve, duke përcaktuar misionin dhe detyrat e saj, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre, me ndikim në rritjen e nivelit të ardhurave të bashkisë.

Menjëherë

31.3.Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa, për të verifikuar dhe saktësuar në terren të gjitha ngastrat pyje dhe kullota, brenda juridiksionit të saj administrativ, për të bërë të mundur ngritjen dhe përditësimin e regjistrit për fondin pyjor kullosor. Gjithashtu të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit, si dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në regjistrat kadastral të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e dhënies me qira, rezultoi se me VKB-në nr. 18, datë 29.09.2023, me objekt "*Për miratimin e dhënieve me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Konispol*", është miratuar dhënia me qira në total e 138 ngastrave, me sipërfaqe prej ha 9,940.16 ha dhe me VKB-në nr. 30, datë 30.09.2024, është miratuar dhënia me qira në total e 146 ngastrave me sipërfaqe prej ha 11,494.37 ha. Lidhur me procedurat e ndjekura për dhënien me qira sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, u konstatua si më poshtë vijon:
- Për dhënien me qira të kullotave dimërore nga Bashkia Konispol nuk disponohet dokumentacioni për njoftimin, lidhur me paraqitjen e kërkesave, për marrjen me qira të ngastrave të fondit pyjor dhe kullosor, nga fermerët e territorit të bashkisë. Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "*Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari*", Kreu II "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari", pika 3.

- Nga auditimi me zgjedhje i 9 kontratave për dhënien me qira të kullotave dimërore rezultoi se, nuk disponohen kërkesat e paraqiura nga fermerët me qëllim evidentimin në qoftë se është dhënë përparësi banorëve të këtij qyteti pra është dhënë apo jo përparësi banorëve të kësaj zone sipas njësive administrative përkatëse. Gjithashtu nuk disponohet vërtetimi nga njësia administrative apo Bashkia Konispol për vendbanimin e fermerit. Mos plotësimi me të gjithë dokumentacionin përkatës ligjor i procedurës për dhënien me qira të kullotave është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, "*Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari*", Kreu II, pika 5, " dhe Kreu II, pika 6, gërma "a". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të dhënies me qira të kullotave, apo tokave bujqësore, në mënyrë sa më transperente, duke bërë njoftime sa më informuese, me qëllim rritjen e interesit nga subjektet e interesuara për qiramarrje të aseteve, duke i dhënë përparësi kërkesave të paraqitura nga banorët vendas.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në tre raste të audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ***"Objekt shërbimesh dhe hotelerie (2kat+podrum)"***, me zhvillues z. A. G. dhe z. Sh. G., miratuar në 16/08/2023.

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 71 ditësh pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, si dhe nenin 44 të ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2;
- Mungon çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit mbrojtjes ndaj zjarrit dhe gjeologjik, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).

2. Leje ndërtimi për ***"Magazinë grumbullimi dhe përpunimi produktesh bujqësore 1 kat"***, me zhvillues "K" ShPK, miratuar në 14/05/2024;

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);
- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Referuar ligjit nr.111/2018 *"Për kadastrën"*, neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, Vendimit nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara 3 muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartela është rifreskuar në datë 14.07.2023, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 25.03.2024;
- Objekti nuk respekton lartësinë maksimale, sipas përcaktimeve të paragrafit II.b të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave..."*, pika 2, nënpika b)*/*

3. Çertifikata përdorimi për ***"Magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh bujqësore"***, me zhvillues "L" ShPK, miratuar në 04/12/2023;
- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se të gjithë aktet e kontrollit nuk është përcaktuar data e përpilimit të këtyre akteve;
- Akt kolaudimi i hartuar nga kolaudatori i licencuar nuk është përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, nuk ka datë, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika c);
- Mungon akti përkatës per menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon planvendosja e objektit, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika f);
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika gj). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 98-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe çertifikata përdorimi:
- të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* me: praninë, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha projekteve ndërtimore; të kërkojnë përfshirjen në aplikim të vërtetimeve të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore; projektin arkitektonik në formatin DËG; të kërkojnë ngarkimin në sistemin e-lejet të dokumentave të rifreskuar të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Konispol nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Referuar këtyre përcaktimeve nënligjore të sipërcituara, DR ASHK, në çdo rast, informacioni i dërguar, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezultoi se:
1. Për lejen e ndërtimit ***"Objekt shërbimesh dhe hotelerie (2kat+podrum)"***, me zhvillues z. A. G. dhe z. Sh. G., miratuar në 16/08/2023,
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;

- Objekti i cituar në mendim-dhënien e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) nuk është i njëjti me objektin e miratuar në lejen e ndërtimit;

2. Për lejen e ndërtimit ***"Magazinë grumbullimi dhe përpunimi produktesh bujqësore 1 kat"***, me zhvillues **"**K" ShPK, miratuar në 14/05/2024;

- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve;
- Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Trasmetimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.+6 faqe 98-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masa, për të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është rikërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje);

Menjëherë dhe në vijimësi

34.2. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Konispol të merren të gjitha masat për të bashkëpunuar institucionalisht me Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim mundësimin e dhënies së mendimit për çdo aplikim që vjen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Menjëherë

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të IMTV Bashkia Konispol u konstatua se:

- Njësia e IMT Bashkia Konispol, nuk ka funsionuar me numrin e nevojshëm të personelit (inspektorëve), pasi nga 3 inspektorë(1 K/inspektor dhe 2 inspektorë), ka munguar K/inspektori si pjesë e strukturës, që nga muaji korrik 2023.
- Për periudhën objekt auditimi konstatohet se *IMTV Bashkia Konispol, është në kushtet e mosfunksionimit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit*, duke mos i përmbushur detyrimet e përcaktuara ligjore, pasi nuk janë hartuar plane pune dhe nuk janë kryer inspektime të vazhdueshme në territorin e bashkisë, ndërsa në rastet e inspektimeve nuk janë mbajtur akte kontrolli, procesverbale, foto, etj, nuk janë evidentuar në asnjë rast ndërtime pa leje, pra ka mungesë të plotë të praktikave dokumentare, duke krijuar mungesë informacioni të qenësishëm lidhur me situatën e konstatuar gjatë kontrolleve,
- IMTV Bashkia Konispol, nuk ka hartuar regjistër elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të mbajtura, ku të pasqyrohen të gjitha inspektimet e kryera nga inspektorët e IMTV dhe masat përkatëse të marra. Gjithashtu u konstatua keqadministrim i dokumentacionit, që ka në përdorim kjo strukturë, pasi nuk ka një evidencë të saktë dhe të qartë lidhur me personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, inventarin dhe dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Nga Bashkia Konispol nuk ka një angazhim konkret, lidhur me mbështetjen e strukturës së IMTV, pasi krahas mungesës së personelit, u konstatua mungesë logjistike(mjete transporti, pajisje, etj), duke ndikuar në performancën e aktivitetit të kësaj strukture.
-Ka mungesë bashkëpunimi ndërmjet IMTV-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, u konstatua mungesë e bashkëpunimit të strukturuar ndërmjet IMTV-së dhe IKMT-së. Informacioni periodik tremujor, i cili duhet të dërgohet rregullisht pranë IKMT-së sipas përcaktimeve ligjore, është dërguar vetëm në rastet kur është kërkuar specifikisht nga IKMT.

Veprime në mospërputhje me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" i ndryshuar, nenin 50, nenin 5, të ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*", Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 10-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për të krijuar një strukturë të plotë IMT-së, me numër inspektorësh/Kryeinspektor, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, për të rritur numrin dhe cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit. Gjithashtu të bëhen ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, lidhur me organizimin dhe funksionimin e IMTV-së, mbi detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe mënyrën e raportimit dhe komunikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

35.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe strukturat e tjera të bashkisë, të marrin masa për inplementimin e një sistemi elektronik, për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMT-së; për pajisjen e IMT-së me mjet transporti për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së saj në terren si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme, për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Menjëherë dhe në vijimësi

35.3. Rekomandimi: Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore konkrete mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit; të mbajnë akte kontrolli me të gjithë elementët e nevojshëm teknik, për të gjitha inspektimet që kryejnë, si tek objektet e ndërtuara pa leje dhe tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë. Gjithashtu dokumentacioni që administrohet për kryerjen e proceseve të punës, të dokumentohet me marrës në dorëzim, që nga tërheqja nga magazina, deri në procesin përfundimtar të përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana eTitullarit të Njësisë Publike(Bashkia Konispol), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë **1,325,600 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit"",* sipas kontratës për punë publike me nr. 1105 prot., datë 10.09.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues

"M" ShPK, me Lic. Nr. NZ.04, me vlerë të kontratës 10,237,701 lekë me TVSH, për 6 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë *dëm ekonomik* në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 712,700 lekë pa TVSH.
Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 712,700 lekë (pa TVSH) nga OE "M" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1105 prot., datë 10.09.2024, me objekt *"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit""*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara..

Brenda datës 30.12.2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *"Rikostruksion i Rrugës fabrika e vajit-fillimi i kthesave, Markat",* sipas kontratës për punë publike nr. 834 Prot., datë 10.06.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "J.C." ShPK, me vlerë të kontratës 5,488,600 lekë me TVSH, për 2 zëra punimi, volumet rezultuan të llogaritura më tepër se përmasat e projektit të zbatimit të miratuar, si dhe të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 324,400 lekë pa TVSH. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 324,400 lekë(pa TVSH) nga OE "J. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 834 prot., datë 10.06.2024, me objekt *""Rikostruksion i Rrugës fabrika e vajit-fillimi i kthesave, Markat"*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve jo në përputhje me projektin e miratuar.

Brenda datës 30.12.2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt *Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor" Bashkia Konispol,,* sipas kontratës për punë publike nr. 1092 Prot., datë 11.10.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "M" ShPK, me vlerë të kontratës 9, 213,333 lekë me TVSH, për 2 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 92,700 lekë pa TVSH.
Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 92,700 lekë(pa TVSH) nga OE "M" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1092 prot., datë

11.10.2022, me objekt "*Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor",* vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes kuadër me objekt "Për blerje materaile ndërtimi dhe asfaltimi rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Konispol", sipas kontratës nr. 302 Prot., datë 15.03.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe OE fitues "K" ShPK, me vlerë të kontratës 15,886,050 lekë pa TVSH, për 2 zëra punimi rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, por të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Konispol, në vlerën 195,800 lekë pa TVSH. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 84-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 195,800 lekë(pa TVSH) nga OE "K" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 302 prot. , datë 15.03.2023, me objekt "Blerje materaile ndërtimi dhe asfaltimi rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Konispol", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

Brenda datës 30.12.2025

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatuan parregullsi, lidhur me hartimin e preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit. Për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës së çelikut për vaditjen e tokave të Markatit", me fond limit 33,413,819 lekë pa TVSH, të zhvilluar në vitin 2024, lidhur kontrata nr. 1412, datë 07.11.2024 me vlerë 32,052,498, rezulton se në preventivin e fondit limit në seksionin C "Infrastrukturë ndihmëse", në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar, janë përfshirë *4 zëra punimi me vlerë totale 3,478,000 lekë*. Gjithashtu për zërin "F.v. tub çeliku me diametër 250 mm/7.0 mm", nga llogaritja e jo e saktë e peshës totale të tubit të çelikut, është përcaktuar më tepër në preventiv sasia prej 1.7 ton, duke krijuar rritje të fondit limit në *vlerën takuese 299,200 lekë.* Për rrjedhojë fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar, në vlerën totale prej 3,777,200 lekë dhe në referencë të ofertës fituese, për të cilën është lidhur kontrata nr. 1412, datë 07.11.2024, me vlerë 32,052,498 lekë, është krijuar një diferencë në vlerën prej 2,415,871 lekë[32,052,498(vlera e kontratës)-29,634,619(vlera e korigjuar e fondit limit)], e cila përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve publike. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për strukturën e kostos*", kreu II seksioni B pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 58-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet e anomalive në përllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit,

të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë, për të bërë të mudur përdorimin e fondeve publike me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e dhënies me qira të aseteve, rezultoi se:

- Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024, Bashkia Konispol ka nënshkruar në total 123 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore, ku evidentohen 35 debitorë në fund të vitit 2024, në vlerën *513,124 lekë* si pasojë e mos likudimit të detyrimeve kontraktuale, sipas Pasqyrës nr. 4, Pika 7(bashkëlidhur).

- Bashkia Konispol me datë 27.03.2019, ka kryer amendimin e kontratës të lidhur me kompaninë "Vodafone Albania" Sh.a, duke shtyrë afatin me 3 vjet, rezulton se nga kjo periudhë deri me datë 31.12.2024, Kompania "V. A" Sh.a është debitore ndaj Bashkisë Konispol *në vlerën 2,250,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me* nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore dhe me kontratat përkatëse të lidhura me qiramarrësit debitorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 91-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit debitorë, konkretisht: Për vlerën 513,124 lekë, nga personat qiramarrës të tokës bujqësore, sipas Pasqyrës nr. 4, Pika 7(bashkëlidhur) dhe për vlerën 2,250,000 lekë nga Kompania "V. A" Sh.a, si detyrim kontraktual i pa likujduar.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 15 germat (b,c,ç); nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore, si mëposhtë:

***"Vërejtje",* në zbatim të germës "a" të nenit 58, për**:

1. Znj. O. E., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, si dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së, *për shkeljet e konstatuara:*

- Për llogarinë 202 *"Studime dhe kërkime"* nuk është përllogaritur normë amortizimi. Amortizimi i akumuluar në vlerën 6,108,601 lekë i përket gjendjes së mbylljes së datës 31.12.2023, dhe jo atë të vitit ushtrimor 2024;
- Llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"* e pasqyruar në bilanc për vlerën 24,011,454 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Referuar të dhënave analitike përbërëse të llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"* konstatohet se, në këtë llogari është përfshirë zëri *"Blerje skrep bujqësi (Volvo)"* në vlerën kontabël *(kosto historike)* në vlerën 16,347,131 lekë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 215 *"Mjete transporti"*, në zbatim të përcaktimeve në Nomeklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Kodi 2, Artikulli 21, Llogaria 215 *"Mjete transporti"*;
- Llogaria 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* është nënvlerësuar në vlerën 23,896,411 lekë;
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është mbivlerësuar në vlerën 448,999 lekë;
- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* dhe llogaritë e Klasës 3 *"Gjendje inventari qarkullues"*, shtesë e kryer për vitin 2024 është në vlerën 63,272,910 lekë *(60,773,758 lekë + 2,499,152 lekë)*, ndërkohë që referuar ditarit të bankës konkretisht shpenzimeve të kryera me pagesë për mallra, shërbimeve dhe investimeve janë në vlerën 69,578,233 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në pasqyrat financiare në vlerën 6,305,323 lekë;
- Në 51 raste janë kryer likujdime në vlerën totale prej 26,655,138 lekë për punë publike publike dhe shërbime të cilat përbëjnë shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik duke i përjashtuar këto procedura.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", nenet 7-9 dhe nenet 65-70, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".

- Në 6 procedura prokurimi, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- Nuk ka marrë masa për monitorimin e inventarit dhe për dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Veprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e; Ligjit Nr. 10 296, Datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin*" të ndryshuar, neni 4/26 dhe neni 9/4/ë, neni 12/3; Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", pika 2, 5, 12, 36, 37, 38, 72 73, 74; Rregulloren e brendshme të Bashkisë Konispol neni 44.

2. Z. D. K. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve,

për shkeljet e konstatuara:

- Për ushtrimin e aktivitetit përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Konispol të katër subjekteve në fushën e ndërtimit të cilat nuk janë të pajisur me Nipt Sekondar në zbatim të përcaktimeve të nenit 22 dhe neneve 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, *"Për regjistrimin*

e biznesit" i ndryshuar;
- Për mos përllogaritjen e detyrimeve tatimore për kategorinë *"Abonentë familjarë"* në vlerën 14,915,956 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol. *(Trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Z. A. B., më detyrë Drejtor në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

4. Z. L. B., me detyrë specialist në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 5 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 të raportin përfundimtar të auditimit).*

5. E. H. më detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore,
për shkeljet e konstatuara:
- Në 5 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarve të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe Kreut V, Seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit përfundimtar të auditimit).*
- Për administrim jo korrekt të Dosjeve të punonjësve, me mangësi mangësi dokumentacioni si, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë; fletën e inventarit të dosjes; përshkrimin e punës; certifikatën familjare të përditësuar; raportin mjekësor të përditësuar
- Për largimet nga puna, nuk ka zbatuar VKM 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku të dokumentohej dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse dhe dokumentacioni për shkak të detyrës.
- Nuk ka marrë masa për të zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur për rekrutimet e reja, për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil.

Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neni 62 dhe VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë*", VKM-së nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*".

- Në lidhje me administrimin e pronave dhe asteve të bashkisë, nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.

Veprime në mospërputhje me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore",* me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. D. Ll., më detyrë specialist në Zyrën e Financës,
për shkeljet e konstatuara:

- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7. A. A., më detyrë specialist në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit,
për shkeljet e konstatuara:

- Në 6 procedura prokurimi, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin dhe shpallje fitues të OE, jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht, me nenin 76, nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 67, nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar *(Trajtuar në pikën 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8. M. B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë,
për shkeljet e konstatuara:

- Në lidhje me administrimin e pronave dhe asteve të bashkisë, nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, nuk janë kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki, nuk janë inventarizuar totalisht, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nga 936 prona që disponon, Bashkia Konispol nuk ka regjistruar në regjistrat pronësorë dhe nuk ka pajisur me çertifikatë pronësie asnjë pronë, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Sarandë.

- Në lidhje me administrimin dhe hënien me qira të kullotave, nuk disponohet dokumentacioni për njoftimin, lidhur me paraqitjen e kërkesave, për marrjen me qira të ngastrave të fondit pyjor dhe kullosor, nga fermerët e territorit të bashkisë.
Veprime në mospërputhje me nenet 27-28 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", me nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", me nenin 18 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore",* me pikat 37, 42, 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9. E. Z., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol,
10. D. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, periudha 17.07.2023 deri 31.12.2024,
për shkeljet e konstatuara:
- Gjatë kryerjes së inspektimeve në terren nuk kanë dokumentuar proceset e inspektimit e kryera, nuk kanë mbajtur akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, si dhe nuk kanë hartuar një regjistër për pasqyrimin e akteve të mbajtura. Veprime në mospërputhje me; nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".

11. A. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, për periudhën 01.01.2023-17.07.2023 dhe magazinierit për periudhën 18.07.2024- 31.12.2024, *për shkeljet e konstatuara:*
- Gjatë kryerjes së inspektimeve në terren nuk ka dokumentuar proceset e inspektimit e kryera, nuk ka mbajtur akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, si dhe nuk ka hartuar një regjistër për pasqyrimin e akteve të mbajtura. Për periudhën që ka kryer detyrën e magazinierit, nuk ka mbajtur një evidencë të saktë dhe të qartë lidhur me personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, inventarin dhe dokumentimin e lëvizjes së blloqeve të IMTV-së. Veprime në mospërputhje me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar, nenin 51, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".

E.2. Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:
1. Z. J. Y., në cilësinë e e ish Drejtorit të Administrimit të Përgjithshëm dhe Integrimit Evropian deri në datën 30.06.2023
2. Znj. M. H., në cilësinë e ish specialiste juriste

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Konispol pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Konispol funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke bërë që sistemet e kontrollit mos të funksionojnë plotësisht në këto drejtime:
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan veprimi për adresimin dhe korrigjimin e mangësive të evidentuara në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Nuk ka rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Konispol në kundërshtim me Ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar.*
- Nuk është hartuar Plani i Veprimit për KB për vitin 2025.
- Nuk janë hartuar dhe miratuar politika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit;
- Nuk ka urdhër/përditësim të GMS-së, vendime për ngritje/përditësim të EMP-së dhe nuk disponohen procesverbale për takimet e GMS-së.
- Nuk ka hartuar regjistrin e riskut, në kundërshtim me Ligjin nr .10296, datë 08.07.2010 për *"Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 11 dhe neni 12.*
- Nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.
- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut.
-Bashkia Konispol nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.
- Në Bashkinë Konispol aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 8 pika 8/b, neni 11 pika 2, neni 16, neni 20, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27,* me Udhëzimin nr.16 datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7,* Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 108/2016, Kapitulli III, pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm dhe Integrimit Europian, të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të koordinatorit të MFK-së dhe koordinatorit të riskut. Gjithashtu të përditësojë Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit të proceseve dhe aktivitetit të strukturave përkatëse të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol nuk ka parashikuar në strukturën organizative shërbimin e Auditit të Brendshëm, si dhe nuk kanë marrë asnjë masë dhe nuk ka bërë asnjë marrëveshje me bashki të tjera, për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në Bashkinë Konispol. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 10, nenin 12/a të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"* të ndryshuar dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik"* të ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me një nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi, për të bërë të mundur auditimin e strukturave të vlerësuara me risk të lartë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura, rezultoi se:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak *"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*".
- Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak.
-Tavanet Buxhetore për PBA 2024-2026, nuk janë paraqitur dhe miratuar në Këshillin Bashkiak.
- Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.
- Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027, nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë.
- PBA 2025-2027 faza e parë nuk është dërguar në MF.
- Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027, nuk janë miratuar me VKB.
- Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Veprimet dhe mosveprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pikat 17, 58, 63, 64, 79, 83 dhe 84 dhe Ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 "*Për financat*

e vetëqeverisjes vendore".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor, duke i miratuar ato brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Konispol së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, u konstatuan devijime me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën ka vlerën 283,700 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 254,194 mijë lekë ose në masën 89.5%.

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 71,640 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 63,475 mijë lekë ose në masën 89%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve.

Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 60,332 mijë lekë dhe realizuar 46,227 mijë lekë ose në masën 76%. Mosrealizimit i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Konispol në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 39, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, gema "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3*, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1 , faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Konispol, të marrin masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga ato të arkëtuara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 38,865 mijë lekë, nga të cilat për investime janë në vlerën 1,638 mijë lekë, për mallra dhe shërbime janë në vlerën 37,227 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë

likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 18,616 mijë lekë dhe në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura janë në vlerën 20,249 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura përbëhet nga 54 fatura nga të cilat para vitit 2023 i përkasin 5 fatura me vlerë detyrimi 1,086 mijë lekë, vitit 2023 i përkasin 8 fatura me vlerë detyrimi 2,058 mijë lekë, vitit 2024 i përkasin 6 fatura me vlerë detyrimi 4,544 mijë lekë dhe vitit 2025 i përkasin 35 fatura me vlerë detyrimi 12,560 mijë lekë. Pavarësisht uljes së stokut të detyrimeve gjatë vitit 2025, njësia nuk ka siguruar planifikimin dhe administrimin e fondeve në mënyrë që të garantojë shlyerjen në afat të detyrimeve të krijuara, duke sjellë mbartjen e tyre nga një vit buxhetor në tjetrin dhe rrezik për menaxhimin efektiv të fondeve publike.

Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura",* pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të inventarizimit, rezultoi se për vitin 2025, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Konispol nr.70, datë 31.12.2025, "*Për ngritjen e komisioneve që do të bëjnë inventarizimin vjetor të vlerave materiale të pasurisë së Bashkisë Konispol"*. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi kryerjen e inventarëve fizikë për aktivet e institucionit, për rrjedhojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2025, janë mbyllur për gjendjen kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, hartimi i pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve, është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre aseteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* në fund të vitit 2025 në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet në vlerën 39,004 mijë lekë dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila është kontabilizuar për vlerën 19,347 mijë lekë.

Referuar informacionit të pasqyrës së pozicionit financiar llogaritë e klasës 4 janë kontabilizuar si mëposhtë:

Llogaria 401-408 *"Furnitorë dhe llogari të lidhura me to",* është kontabilizuar për vlerën 37,697 mijë lekë.

Llogaria 42 *"Detyrime ndaj personelit",* është kontabilizuar për vlerën 7,972 mijë lekë.

Llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",* është kontabilizuar për vlerën 986 mijë lekë.
Llogaria 435 *"Sigurime shoqërore",* është kontabilizuar për vlerën 2,361 mijë lekë.
Llogaria 436 *"Sigurime shëndetsore",* është kontabilizuar për vlerën 329 mijë lekë.
Sa më sipër llogaritë e klasës 4 janë kontabilizuar për vlerën 49,347 mijë lekë, llogaria 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 10,343 mijë lekë.
Llogaria 7206*"Financim i pritshëm nga buxheti"* është nënvlerësuar për vlerën 30,000 mijë lekë.
Llogaritë e mësipërme janë kontabilizuar në kundërshtim me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* dhe llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2025, rezultoi se:
Llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene" është paraqitur në pasqyrat financiare në vlerën 20,011 mijë lekë në fund të vitit 2024. Gjatë vitit 2025, kjo llogari ka pësuar shtesa në vlerën 2,921 mijë lekë, të cilat janë kontabilizuar në datën 31.12.2025, duke rezultuar me një vlerë totale prej 26,933 mijë lekë në fund të vitit 2025. Nga auditimi rezultoi se për këtë llogari nuk disponohej inventar kontabël i detajuar dhe as inventar fizik i pasurive të regjistruara, duke mos garantuar gjurmueshmërinë dhe verifikimin e plotë të ekzistencës, plotësisë dhe saktësisë së vlerës së paraqitur në pasqyrat financiare
- Llogaria 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2025 nuk disponon një regjistër të përditësuar në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 26 dhe 27. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë, 210 *"Toka, Troje, Terrene"*, dhe 212 *'Ndërtesa dhe Konstruksione"*.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

8.2.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në zbatim të procedurave të inventarizimit, të marrë masa për analizimin e dokumentacionit financiar dhe ligjor të aktiveve, me qëllim evidentimin e plotë të hyrjeve dhe lëvizjeve të tyre ndër vite, verifikimin dhe saktësimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare. Në rast konstatimi të pasaktësive, të kryhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik të aktiveve.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konstatohet se, ndër vite janë transferuar inventarë në vlerën kontabël (kosto historike) 502,851,347 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Konispol (aktualisht pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Konispol dhe UKK Sh.A**.** Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8,

datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të hartojë procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vlerën kontabël 502,851,347 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 82,041 mijë lekë për 8 investime për aktive afatgjata materiale.

Nga auditimi i dokumentacionit për kontabilizimin e investimeve në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* u konstatua se për 4 (katër) investime për Aktive Afatgjata Materiale të kolauduara dhe të marra në dorëzim janë kontabilizuar me vlerë të likuiduar në shumën 40,302 mijë lekë dhe jo vlerë të faturuar të kontratës në shumën 94,293 mijë lekë.

Sa më sipër aktivet të cilat merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktiveve në shumën 53,991 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-64 të Projekt Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për kryerjen e një analize të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor për aktivet e regjistruara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore",* me qëllim verifikimin e saktësisë së vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare. Aktivet të kontabilizohen me vlerën e plotë të kontratës së realizuar dhe të marrë në dorëzim, dhe jo vetëm me vlerën e likuiduar të kontratës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

11. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Konispol gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" në datën 31.12.2025 paraqitet në vlerën 20,337 mijë lekë.

Investimi *"Ndërhyrje emergjente në përroin e Barcit"* me vlerë kontrate 15,681 mijë lekë me TVSh është përfunduar dhe kolauduar. Ky investim është kontabilizuar në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* për vlerën 3,660 mijë lekë vlerë kjo e faturuar dhe e paguar, ndërsa për vlerën 7,200 mijë lekë sipas situacionit nr.2 dhe faturës nr.137/2025 të papaguar është kontabilizuar në llogarinë 231 "Investime" duke mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 7,200 mijë lekë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 *"Investime në*

proces" dhe pas realizimit dhe marrjes në dorëzim të investimit t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 14,855 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Ngurtësime të cilat i përkasin periudhës 2024-2025 janë në vlerën 5,468 mijë lekë, për të cilat nuk ka përfunduar periudha e garancisë. Për vlerën 9,387 mijë lekë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk disponohet informacion analitik dhe rakordim me Degën e Thesarit Sarandë. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 9,387 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për rakordimin me Degën e Thesarit Sarandë të vlerave të ngurtësuara të kontabilizuara në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje".* Për investimet për të cilat ka përfunduar periudha e garancisë dhe nuk ka pretendime të evidentuara lidhur me cilësinë e realizimit të tyre, të procedohet me lirimin dhe kalimin e fondeve përkatëse në favor të kontraktorëve.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit**,** administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë, në Bashkinë Konispol kryhet në programin Excel. Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve kryen regjistrimin manual të të dhënave të administruara, ndërkohë që nuk disponon regjistra fizikë për evidentimin dhe gjurmueshmërinë e informacionit të mbledhur. Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Konispol i administron në excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu procesi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore duhet të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale të përcaktuara në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.6 , faqe 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Bashkia Konispol, të marrë masa për hartimin e regjistrit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Konispol për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin nr. 43, datë 27.11.2024, të Këshillit

Bashkiak. Në këtë dokument nuk janë përcaktuar afatet për pagesën e të gjitha taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës duhet të jetë pjesë integrale e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit), me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Nga SSHT-ja shpjegohet se këto afate përcaktohen me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, gjë që tregon se afati i përcaktimit të pagesës së detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore mbetet të përcaktohet nga ky sektor dhe jo nga Këshilli Bashkiak. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"*Për sistemin e taksave vendore*"* i ndryshuar, neni 5, gërma *"c".(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 33-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa që, gjatë hartimit të paketës fiskale të përfshijë afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar, duke garantuar mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar, me qëllim sigurimin e financimit të shpenzimeve të miratuara në planin vjetor të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçensuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit, si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB u konstatua se, përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Konispol kanë ushtruar në total 3 subjekte me aktivitet tregtim me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj. Nga totali prej 3 subjekte, 2 subjekte janë të pajisura me autorizim për tregtimin e hidrokarburave dhe derivative të tyre dhe 1 subjekt nuk është i pajisur me autorizim. Me shkresën nr. 322 prot., datë 18.03.2025, Bashkia Konispol i ka rikujtuar subjektit "I" ShPK detyrimin ligjor për pajisjen me liçensë. Subjekti "I" ShPK ka kryer pagesën në shumën 500,000 lekë me datë 21.04.2026 me qëllim paisjen me autorizim. Ky subjekt nuk është pajisur me autorizim për shkak të moskryerjes së pagesës së plotë.

Për më tepër në lidhje me problematikën e sipërpërmendur, nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e ISHTI-it për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* VKM-në nr. 170, datë 25.04.2002, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*" i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj",* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 33-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjektit "I" Shpk, i cili ushtron aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/liçencë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **44 (dyzet e katër)** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 4 (katër) janë zbatuar, 6 (gjashtë) janë në proces zbatimi, 1 (një) është zbatuar pjesërisht, 33 (tridhjetë e tre) pa zbatuar nga të cilat 12 janë rikërkuar në auditimin aktual dhe 18 janë masa organizative të cilat do të auditohen kur të kryhet auditim përputhshmërie në Bashkinë Konispol.
-Për shpërblimin e dëmit janë lënë **4 (katër) rekomandime** për 4 subjekte në vlerën 1,325,600 lekë dhe janë pranuar plotësisht, të cilat janë zbatuar pjesërisht.
-Për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike është lënë 1 **(një) rekomandime** i cili është në proces.
-Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë lënë **5 (pesë) rekomandime** të cilat janë në process zbatimi.
-Për masa disiplinore janë lënë **13 (trembëdhjetë) rekomandime** të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 13 nuk janë zbatuar.
Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe (62-128) të Projekt Raportit të Auditimit).*
16.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative *(të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025).*

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 117.
14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".
17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Bashkinë Konispol, të marrë masa për sistemimin e vlerës 16,347,131 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" duke i kontabilizuar në llogarinë 215 "Mjete transporti".
18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol, të marrë masa lidhur me gjendjen e llogarisë 218 "Inventar ekonomik", për të klasifikuar veçmas llogarinë 218/6 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv. Si dhe të aplikojë normë amortizimi për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime", duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.
21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bashkia Konispol të marrë masa për sistemimin e vlerës 53,073,605 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"

duke i kontabilizuar në llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" e cila shërben si kundërparti e 468 "Kreditorë të ndryshëm".

24.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Gjithashtu Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet, për të mos ndikuar në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

25.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e mangësive të konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe përgjegjësitë në zhvillimin e këtij procesi. Gjithashtu KVO të marrë masa, që të shmangen parregullsi të tilla, për të përmbushur realizimin e këtij procesi në mënyrë objektive dhe transparente.

26.1. Rekomandimi: Strukturat dhe personat përgjegjës në Bashkinë Konispol, të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të dokumentacionit pjesë e dosjeve dhe arkivimin e dosjeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse, duke nënshkruar dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Për të shmangur risqet e tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, dokumentacioni duhet të administrohet, sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

27.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet dhe të marrë masa konkrete, për të përmirësuar procesin e përcaktimit të nevojave për materiale mirëmbajtje dhe ndërtimi, proces i cili duhet të mbështetet në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar. Gjithashtu nga personat përgjegjës të caktuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrë masa për dokumentimin e gjithë procesit, në të gjitha fazat e zbatimit të kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol dhe strukturat përkatëse, të merrin masa në të ardhmen, që përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës, për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive, me qëllim caktimin e normativave sa më reale. Gjithashtu të paraqitet lista e mjeteve së bashku me limitin mujor të miratuar, që do të furnizohen me karburant pranë OE të kontraktuar.

29.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol të analizojë arsyet, të nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsi të tilla. Njësia e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrë masa, të analizojë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve.

30.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me strukturat e saj të marrë masa, për të plotësuar dosjet e zbatimit me dokumentacionin përkatës të konstatuar në mungesë, si dhe në vijimësi të verifikojë me përgjegjësi dokumentacionin e dosjeve të zbatimit që do të paraqesin operatorët kontraktues dhe për çdo mungesë dokumentacioni të konstatuar, të pezullohet dorëzimi i dosjes përkatëse, deri në plotësimin e saj, duke nxjerrë përgjegjësitë për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit.

30.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa në vijimësi, për të angazhuar të gjithë kapacitetet dhe strukturat e bashkisë, për vënien në dispozicion të kontraktorëve, sheshet përkatëse të ndërtimeve, pa krijuar vonesa, për të mundësuar fillimin e zbatimit të kontratave dhe përfundimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara.

31.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave, të marrë masa, për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, duke kryer evidentimet përkatëse në terren dhe të rakordojë me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Sarandë, për të vijuar me procesin e regjistrimit të pasurive që kanë kaluar në pronësi dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Gjithashtu të procedohet me krijimin e një regjistri kontabël të integruar të inventarit të aseteve, që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Konispol.

31.2.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol të marrë masa për të ngritur një strukturë të veçantë për administrimin e aseteve, duke përcaktuar misionin dhe detyrat e saj, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre, me ndikim në rritjen e nivelit të ardhurave të bashkisë.

31.3.Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa, për të verifikuar dhe saktësuar në terren të gjitha ngastrat pyje dhe kullota, brenda juridiksionit të saj administrativ, për të bërë të mundur ngritjen dhe përditësimin e regjistrit për fondin pyjor kullosor. Gjithashtu të marrë masa për të planifikuar fonde për

hartimin e planeve të mbarështimit, si dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në regjistrat kadastral të pronësisë.

32.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të dhënies me qira të kullotave, apo tokave bujqësore, në mënyrë sa më transperente, duke bërë njoftime sa më informuese, me qëllim rritjen e interesit nga subjektet e interesuara për qiramarrje të aseteve, duke i dhënë përparësi kërkesave të paraqitura nga banorët vendas.

33.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe çertifikata përdorimi:

- të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* me: praninë, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha projekteve ndërtimore; të kërkojnë përfshirjen në aplikim të vërtetimeve të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore; projektin arkitektonik në formatin DËG; të kërkojnë ngarkimin në sistemin e-lejet të dokumentave të rifreskuar të pronësisë.

34.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Konispol, të merren të gjitha masa, për të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është rikërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje);

34.2. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Konispol të merren të gjitha masat për të bashkëpunuar institucionalisht me Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim mundësimin e dhënies së mendimit për çdo aplikim që vjen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

35.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për të krijuar një strukturë të plotë IMT-së, me numër inspektorësh/Kryeinspektor, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, për të rritur numrin dhe cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit. Gjithashtu të bëhen ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, lidhur me organizimin dhe funksionimin e IMTV-së, mbi detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe mënyrën e raportimit dhe komunikimit.

35.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe strukturat e tjera të bashkisë, të marrin masa për inplementimin e një sistemi elektronik, për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMT-së; për pajisjen e IMT-së me mjet transporti për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së saj në terren si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme, për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

35.3. Rekomandimi: Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore konkrete mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit; të mbajnë akte kontrolli me të gjithë elementët e nevojshëm teknik, për të gjitha inspektimet që kryejnë, si tek objektet e ndërtuara pa leje dhe tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë. Gjithashtu dokumentacioni që administrohet për kryerjen e proceseve të punës, të dokumentohet me marrës në dorëzim, që nga tërheqja nga magazina, deri në procesin përfundimtar të përdorimit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI *(të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 712,700 lekë (pa TVSH) nga OE "M" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1105 prot., datë 10.09.2024, me objekt

"Rehabilitim i kanalit vaditës të "Manastirit"", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara..

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 324,400 lekë(pa TVSH) nga OE "J. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 834 prot., datë 10.06.2024, me objekt *"Rikostruksion i Rrugës fabrika e vajit-fillimi i kthesave, Markat"*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve jo në përputhje me projektin e miratuar.

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 92,700 lekë(pa TVSH) nga OE "M" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1092 prot., datë 11.10.2022, me objekt "*Rikostruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor",* vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

4.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Konispol, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 195,800 lekë(pa TVSH) nga OE "K" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 302 prot. , datë 15.03.2023, me objekt "Blerje materaile ndërtimi dhe asfaltimi rrugësh rurale në fshatrat e Bashkisë Konispol", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të parealizuara.

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE*, (të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Konispol, të analizojë arsyet e anomalive në përllogaritjen e fondit limit, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen parregullsitë e konstatuara. Njësitë e prokurimit, gjatë përllogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë preventivët e ofertuar dhe çmimin/njësi të punëve/shërbimeve që prokurojnë, për të bërë të mudur përdorimin e fondeve publike me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)*, (të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit debitorë, konkretisht: Për vlerën 513,124 lekë, nga personat qiramarrës të tokës bujqësore, sipas Pasqyrës nr. 4, Pika 7(bashkëlidhur) dhe për vlerën 2,250,000 lekë nga Kompania "Vodafone Albania" Sh.a, si detyrim kontraktual i pa likujduar.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE *(të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.322/7, datë 20.10.2025)*.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:
***"Vërejtje"*, në zbatim të germës "a" të nenit 58, për**:

1. Znj. O. E., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, si dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO-së,
2. Z. D. K. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve,
3. Z. A. B., më detyrë Drejtor në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
4. Z. L. B., me detyrë specialist në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit,
5. E. H. më detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore,
6. D. Ll., më detyrë specialist në Zyrën e Financës,
7. A. A., më detyrë specialist në Drejtorinë e Zhvillimit të Territorit,
8. M. B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë,
9. E. Z., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol,
10. D. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, periudha 17.07.2023 deri 31.12.2024,
11. A. K., në cilësinë e Inspektorit të IMTV Bashkia Konispol, për periudhën 01.01.2023- 17.07.2023 dhe magazinierit për periudhën 18.07.2024- 31.12.2024,

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADNHNISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve familjarë që kanë ndaj Bashkisë Konispol konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 46,916 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët familjarë detyrime të prapambetura në vlerën 7,966 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 11,565 mijë lekë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **50,217 mijë lekë**.
Detyrimet e tatimpaguesve privatë ndaj Bashkisë Konispol, të akumuluara deri më datë 31.12.2024, rezultojnë në vlerën 5,382 mijë lekë. Gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 31.12.2025 është krijuar detyrim tatimor shtesë në vlerën 684 mijë lekë. Si rezultat, detyrimi tatimor progresiv i tatimpaguesve privatë deri më datë 31.12.2025 rezulton në vlerën **6,067 mijë lekë** dhe i përket 73 subjekteve biznesi.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 ", pika 1.3,* dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.6 , faqe 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 56,284 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Sarandë, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Gjendja debitorë në datën 31.12.2024 është në vlerën 246 mijë lekë. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 362 mijë lekë për 7 persona i cili është arkëtuar brenda vitit 2025. Më datë 31.12.2025 gjendja debitorë totale është 246 mijë lekë për 7 persona, shumë e cila përfaqëson të ardhura të pa

arkëtuara për Bashkinë Konispol. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Konispol për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gjirokastër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" i ndryshuar, pika 5.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, të marrë masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore ndaj subjekteve debitore për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në vlerën 246 mijë lekë për objektet e legalizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT